

Bashkim Hoxha

8JH-32

H 92

NJË
LOLO
DHE NJË
MBRET

tregime
novelë

814-32

H92

BASHKIM HOXHA

NJË LOLO
DHE
NJË MBRET

tregime
e novelë



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Prolog

Ra gongu i parë.

Në skenë ishte errësirë. Aktori mbylli sytë fort që të mësohej me të. I mbajti kështu për pak çaste dhe i hapi. Mundi ta dallonte siluetën e dekorit bufatorik tur-bull, si përmes një nate pa hënë. Me hamendje gjeti fronin e tij në anë të skenës dhe u ul. E ndjeu veten krejt të mpirë nga emocionet.

— Šuksese, mjeshtër! — i pëshpëriti një zë aty pranë.

— Faleminderit, — ia ktheu pa vënë re se kush i foli dhe u zhyt edhe më tepër në fronin e drunjë e të gjerë. Pasi u mësua me errësirën, mundi të shihte dy kollegë të tij, që bënин ecejake të shkurtra, në pritje të hapjes së perdes.

Aktori mbylli sytë, mbështeti kokën mbi duar dhe u përpoq të përfytyronte pamjen që do të zbulohej pas hapjes së perdes. Këtë e bëri thjesht për t'u larguar nga emocionet, që i krijonin një angushti të madhe, njësoj sikur dikush i shtrëngonte zemrën në grusht.

Njeriu i parë që pa, qe e shoqja. Me bluzën e bardhë me dallgëzime dantellash, ajo dallohej menjëherë në sallën gjysmë të errët, si një flamur paqeje midis ankthit, dëshpërimit, emocionit dhe fjalëve të ngarkuara me mendime të rënda. Sido që të ishte, shfaqje tragjike apo komike apo thjesht dramatike, e shoqja do të qëndronte atje deri në fund, e buzëqeshur dhe e përlotur, me një tufë lule të stinës në dorë.

Atij i erdhi për të qeshur kur kujtoi lulet.

Në fillim të shfaqjeve ato ishin të freskëta, të zgjedhura tërë përkujdesje dhe nuk merrej vesh se si në fund ato kthehen në një grumbull petalesh të sak-

tuara, të përgjysmuara dhe gjethesh të gërricura nga gishterinj nervozë.

«Kështu gërricet edhe zemra e njeriut që ka ankth, — mendoi ai, — dhe nuk e merr vesh sesi.»

Nuk e kuptonte përse atë mbrëmje gjithçkaje donte t'i jepte një domethënë të veçantë, duke e ngarkuar përfytyrimin me mendime. Mendimi përsëri i shkoi te publiku në sallë. Kishte disa njerëz që donte të ishin patjetër aty.

«O zot, më shpëto nga baronesha!» — psherëtiu ai, sepse iu kujtua që me siguri përballë gruas së tij do të ishte ulur baronesha D., ajo vajzë dyzetetrevjeçare e budallaqe, që cicërinte tërë kohën si kanarinë e kurdisur.

«Dhe t'i mendosh ato përballë njëratjetrës!»

Ra gongu i dytë.

Ai u përpoq të përqendrohej te roli. Pas pak do të jetonte, do të bariste, do të vuante, do të vritej dhe në fund do të ringjallej për të përshëndetur sallën.

«A mundem, vallë, të numëroj sa herë jam vrarë e jam ringjallur? — mendoi aktori: — Sa herë kam qenë mbret, barí, i çmendur, filozof, fatkeq, i dashuruar, intrigant, naiv, lolo, një kalimtar i thjeshtë... Askush nuk e kundron dot botën nga kaq shumë kënde shikimi sa një aktor. Askush!

Por ishte e pamundur ta largonte mendjen nga salla. Për të ajo gjithmonë kishte qenë një pasqyrë, ku kishte parë veten. Diku në fund të platesë me siguri edhe atë natë do të ishin mbledhur gazetarët. Nësër ata do të shkruanin. Çfarë do të thoshin vallë? Gazetat qenë tepër të rënduara me lajme. Bile edhe me lajme lufte.

«Po unë, si do të hyj mes këtyre lajmeve? — mendoi aktori. — A do të hyj dot natyrshëm, apo kam për të qenë vetëm një relik i pluhurosur i një lufte që ka shekuj që është harruar? Po të ndodhë kjo, ka për të qenë e tmerrshme!»

Aktori ndjeu një pikëllim brenda vetes. Pastaj solli ndër mend një mikun e tij gazetar. «Ai me siguri ka ardhur në shfaqje, por nuk përzihet me turmën lara-gane të gazetarëve të tjerë.» Për njëzet e e tetë vjet rresht ai nuk kishte munguar asnjëherë. Gazetarë të shumtë, fillestarë të apasionuar, të modës, apo që sa po kishin përfunduar një kontratë të përkohshme, kishin ardhur dhe kishin ikur sërisht. Ndognëri ishte kënaqur dhe me një autograf, një tjetër me përgjigjen e një pyetjeje të bërë thjesht për kureshtje, të tjerë vetëm kishin mbushur radhët që përfaqësonin në gazetë apo revistë, kurse ai...

«Ai më bën ta ndiej veten ngushtë», mendoi aktori.

Ra gongu i tretë.

Aktori ngriti sytë. Errësirë. Diku në thellësi filloi të dëgjohej uvertura. Simfoni e Fatit. Bethoven.

Perdja qëndronte ende e ngrirë, e palëvizshme, si me një rëndesë pluhuri. Ai i nguli sytë atje dhe u përpoq të depërtonte me përfytyrim në lozhën përballë. Ishte lozha e autoritetevë zyrtare. Atje njerëzit kishin qenë më të përkohshëm se kudo, bile më të përkohshëm edhe se gazetarët.

Aktori kujtoi se si qenë shfaqur aty ndonjëherë fytyra serioze dhe të vrenjtura, që përpinqeshin t'i jepnin rëndësi çdo fjale a gjesti. që ndiqnin shfaqjen me sytë ngulur thellë në skenë. Kishte midis tyre nga ata që këtë gjë e bënin në mënyrë sa më të dukshme dhe të kapshme nga të tierët, sikur të qenë ata që jepnin shfaqje. Herë të tjera aty qenë shfaqur njerëz të lehtë, që e krahasonin artin me nië gotë birrë të pirë kalimthi në interval të dy punëve që kërkonin mundim dhe vrarje mendieje. Dhe më e tmerrshmja qe kur përballë shfaqeshin disa fytyra të ngurosura, që sëndronin të akullta dhe nuk merrnin vesh asgië. Shumë prej tvre në teatër mendonin të tjera gjëra, që kishin të bënin me jetën e tyre, me familjen, karrierën, shtimin e të ardhurave, pushimin e së dielës e kushedi çfarë tjetër.

Pikërisht ato çaste aktorit i regëtiu në kökë:

«Në cilën anë të perdes zhvillohen vallë dramat më të forta, në këtë apo në atë anë të skenës?»

Ai e ndjeu se, kur hapej perdja rëndë-rëndë, zbulonte njëherësh dy drama. Njëra ndodhë në kuadratin pak metër katrë të skenës, kurse tjetra përtej, në jetën e secilit që qëndronte i ulur në sallë, madje akoma më përtej, edhe në sheshin para teatrit, edhe më tutje, në rrugët që zgjateshin në thellësi të qytetit, edhe më tutje, në hapësirat përtej qytetit, në pafundësi.

Perdja e rëndë filloj të lëvizte ngadalë.

Nën tingujt e muzikës solemne dhe madhështore po zbulohet salla pa butafori dhe pa drita ngjyra-ngjyra.

AKTI I PARË

Dekori: Një qytet i Gjermanisë në vitin 1933.

Nazistët, që kanë marrë pushtetin, organizojnë nëpër rrugë manifestime të shumta, ku demonstrojnë forcë e mobilizim. Në rrugë ecin shumë njerëz, entuziastë, të hutuar, kureshtarë e shpërfillës.

Hamleti

...dhe ja, numëro
të gjitha ngjarjet, të mëdha, të vogla
q'e shkaktuan. Të tjerat janë heshtje.

Them fjalët e fundit dhe vdes. Ashtu siç lëshohen muskujt nga tendosja, që ka zgjatur gjithë jetën për të qëndruar në këmbë trupi, unë lëshoj veten nga tendosja e tmerrshme e emocioneve. E ndiej se si dalëngadalë, nga ky çast e deri në fund, kur do të bien boritë, ankthi, angushtia, dhembja dalin nga zemra drejt sipërfaqes

së lëkurës, si një tufë zogjsh që braktisin folenë dhe ikin, treten me ajrin e skenës, të ndotur nga dritat e shumëngjyrshme, duke lënë trupin tim pa jetë, të shurdhët, të qetë.

Më kapin nga këmbët, nga krahët e supët dhe ngnë trupin tim të vdekur në duar. Njëri prej tyre ka një unazë me një kokë të mprehtë, që gjithmonë më gërvisht pulpën e djathëtë. Gjithmonë këto çaste pyes se çfarë ka në kokë ajo unazë, ndonjë kokë gjarpri, ndonjë zemër të buhavitur apo ndonjë inicial dashurie (eh, edhe nga një inicial mund të të gërvishtet mishi). Herën tjetër nuk do të harroj t'i them që ta heqë patjetër atë unazë.

Ja edhe marshi funebër mbaron dhe perdja mbyllët. Më lëshojnë në skenën e errësuar. Dikush më përqafon, një tjetër më bie pa dashje, në kalim e sipër, me bërryl. Hapet perdja. Sytë më mbyllen nga ndriçimi i projektorëve. Duartrokitjet më kërkojnë mua. Unë orientohem për pak çaste, ngjallem, dhe kjo do të thotë se sërisht në trupin tim është rikthyer shqetësimi, bëj disa hapa drejt paraskenës dhe përshtëndes duke përkulur lehtë kokën, siç i ka hije një princi të vërtetë. Më sjellin pastaj pranë Ofelinë dhe, të zënë për dore, marrim një breshëri duartrokitjesh. E tërësalla më duket një humbëtirë e madhe, e

zezë, ku nuk duket asnjë pamje, vetëm tek-tuk feksin disa reflekse ngjyrash të zbar-dhura. Duartrokkitjet vazhdojnë gjatë, aq gjatë, sa unë e mbledh veten dhe filloj të shquaj njerëzit. Më sjellin një tufë tulipanë të freskët. Domethënë suksesi është i plotë. Ndihem i lumtur, i qetë. Kam harruar atë letër të mallkuar, që më bëri ta nisja rolin me nerva të prishur. Kujtoja se nervozizmi do të vërtitej, si një mjegull e keqe, plot lagështi, mbi fjalët, veprimet e vuajtjet emia për babanë e vrarë, incestin e nënës dhe fronin e grabitur. Por askush nuk paska vënë re asgjë. Aq më mirë. Kjo më bën të ndihem vërtet i lumtur.

Kthehem në studio, ku gjej një pusullë nga gruaja, që më thotë se ka ikur në shtëpi ngaqë vajza e vogël paska temperaturë. Heq makiazhin dhe nisem të takoj Karlin.

Karli, si gjithmonë, më pret në klubin përballë teatrit. Në rrugë ka rënë nata. Kalimtarët janë të shumtë dhe tramvajet i bien kryq e tërthor sheshit. Nga xhamat e tyre të pasme duken njerëzit e shumtë, ngjeshur me njëri-tjetrin. Brenda grisë metalike, tramvajet të kujtojnë konservat. Më mbeten sytë në hundën e shtypur të një fëmije ngjeshur pas xhamit. E ndjek derisa tramvaji zhdukjet. Nuk di përse, kur u zhduk ajo fytyrë e ëmbël fëmije, me

hundën e shtypur në xham, me vështrimin e butë si kadife, m'u duk sikur porsa m'u largua një njeri i dashur dhe i afërt. Ndoshta ngaqë më kujtoi vajzën. Po grua-ja më thoshte se ajo nuk kish ndonjë gjë të madhe dhe kështu duhet të jetë. Si mund të sëmuret ajo qenie e mrekullueshme, ngjyrë trëndafili, me ato bukle të verdha si vite rrushi!

— Kafeneja nuk është larg. Shtyj derën e saj rrotulluese, që tringëllin nga zilkat për të njoftuar ardhjen time. Këto zilka janë një shpikje e mrekullueshme. Ato kanë një efekt gati-gati teatral për ata që presin.

Karli nuk është vetëm. Me të është Alfredi dhe një djalosh i ri i panjohur. Duhet të jetë ndonjë artist i ri, që Karli, si zakonisht, ka dëshirë ta bëjë të njojur. Nuk më lënë të shkoj drejt tyre, sepse më futin në mes gazetarët. Drita e një blici më verbon më shumë se drita e një projektori. Bile, të them të vërtetën, gjithmonë më është dukur se ka diçka tinëzare në të. Gazetarët flasin të gjithë njëherësh, fjalët e tyre përplasen me njëra-tjetrën dhe nuk i lëshojnë udhë asnje mendimi të plotë. Përpigem t'i qetësoj me një gjest të duarve, në të vërtetë mbledh veten. Vendoset njëfarë rregulli.

— A është aktuale figura juaj? — më

pyet njëri. Ka mustaqe të dendura të thinjura dhe mban në gojë një çibuk, gjë, thonë, e modës tek intelektualët e sotëm.

— Hamleti është gjithmonë aktual, — përgjigjem unë. E kam të lehtë këtë përgjigje, — siç është aktuale lufta për drejtësi.

— Mund të na thoni diçka për inspirimin fetar në krijimin e figurës? — më pyet një tjetër. Nuk ka pamje prifti, por ndoshta është ndonjë gazetar hallexhi që vetëm në ndonjë revistë fetare ka gjetur punë.

Unë i ngul vështrimin dhe ngre supet.

— A ka karakter mistik interpretimi juaj? A ka në të gjëra të pashpjegueshme? — vazhdon ai me një këmbëngulje të kuptueshme. Dhjetë radhë paguhen njëzet marka.

— Gjiithçka e bëj me ndërgjegje dhe pasion, — i them, megjithëse më dhimbset. — Nuk njoh skuta të errëta. Këtu, natyrisht, nuk përjashtoj qëndrimin tim emociunal.

— Ju ka lavdëruar ndonjëherë ndonjë personalitet? — Ai që më pyet, i ka sytë të buhavitur. Rrathët poshtë tyre kanë ngjyrën e lapsit kopjativ.

— Regjisori më vlerëson aq shumë, sa i mbetem borxhli, — i përgjigjem.

— E kisha fjalën për ndonjë personalitet të shoqërisë së lartë...

— Ah, po, — bëj sikur kujtohem unë.
— Më ka lavdëruar një herë mbreti Lir, kur në rolin e lolos i thashë disa të vërteta që nuk donte t'i besonte.

— Shfaqja e fantazmës, a nuk mund të quhet si një angazhim i zotit për të zbuluar të vërtetën? — më pyet përsëri ai, halle-xhiu i kronikës fetare.

— Është më tepër një konvencion, — i përgjigjsem.

— Dhe tani mjaft! — ngre zërin Karli pas shpinës së tyre dhe, çuditërisht, të gjitha zhurmat platinët. Karli më duket shumë i implakur këto çaste, por, në të njëjtën kohë, edhe i gjithëpushtetshëm.

— Këq mjafton, apo jo? — thotë ai me zë të butë, kjo përgënjeshtron ashpërsinë e figurës së tij, që prej flokëve të bardhë, të kujton një statujë.

Gazetarët e pranojnë në heshtje vendimën e tij. Fotoreporteri mbledh blicet, përshtendetet i pari me të tjerët dhe del pothuajse duke vrapuar. Ndoshta ka ndonjë detyrë tjetër për këtë mbrëmje. Ka mundësi të jetë në ceremoninë e martesës së argjendtë të baronit Shtybler. Menjëherë pas fotoreporterit ikën dhe ai gazetari i ngratë i kronikës fetare, ndërsa të tjerët shpërndahen nëpër tryeza.

Unë shkoj i qetë të takoj miqtë e mi.

Zilkat e derës pushojnë dhe sjellin ndjesinë e prehjes.

Karli qëndron i menduar. Ai ndez një cigare dhe nis dalëngadalë ta thithë, duke nxjerrë rrathë të kaltër tymi. Unë e ndiej vështrimin e tij të shqetësuar, por nuk e bëj veten. Shkëmbej dy-tri fjalë me Alfredin, ashtu kot, sepse vështrimi i Karlit nuk më lë të qetë. Ul sytë, gërvisht kot suprinën e tryezës me gisht, bëj dy-tri herë firmën time, pastaj nuk duroj dot më.

— Karl! — i kthehem atij. — Më thuaj, c'ke?

Karli përsëri qëndron i menduar. Duket se edhe ai përpilitet të zgjedhë fjalën.

— Më kuptove drejt, — thotë, — kam diçka.

— A s'do të ishte më mirë të ma thoshe? Heshtja jote sot po më torturon!

Karli merr frymë thellë! Tani kujtohem që me të ishte dhe një djalosh.

— Unë nuk e kisha vënë re që Karli kishte diçka, — thotë Alfredi dhe mbështet fort bërrylat në tryezë, në pritje për të dëgjuar ndonjë gjë të rëndë e serioze.

— Ndoshta e kam gabim, — thotë Karli, — po pati caste kur e kalove masën. Unë e kuptoj tendencën që ke ti për ta nxjerrë Hamletin një njeri që proteston, por, herë-herë, shpërtheje në një nervozizëm të pakuptueshëm. Ndoshta ngarkesa emocion



SO237

nale, ndoshta... Më kupto drejt! Po kaq hapur tendenca...

Kardi hesht. Mua më vjen keq që ai e paska kuptuar. Më kthehet trishtimi. Pastaj dalëngadalë më vjen mirë që ai ka qenë kaq i vëmendshëm. Të tjerët me siguri nuk kanë vënë re gjë, ndryshe, do të kishin reaguar. Pra, nuk kam qenë unë aq mirë, po ka qenë spektatori keq.

Alfredi nuk më thotë asgjë. Në vështrimin e tij ndiej njëfarë kundërshtimi të lehtë ndaj Karlit, por, në të njëjtën kohë, edhe një mëdyshje.

Unë nënqesh.

— Karl, — i them, — unë nuk e di në ka vallë në botë njeri që të më njohë kaq thellë sa ti. Bile, unë mund të them se ti nuk më kuption, po më ndien. Unë vërtet kam qenë i nervozuar.

Fut dorën në xhepin e xhaketës. Ajo copëz letër është aty, e ftohtë, e akullt. Letrën e nxjerrë ia hap përpara syve.

— Ja!

Alfredi nxiton ta marrë i pari.

— Të lutem, lexoje! — i them.

Alfredi lexon mirë, me një zë të thellë, në nota të ulëta, që të kujtojnë mërmërimën e madhërishme të detit.

— Ju *italian arrogant, shqiptar, apo çfarëdo që jeni, shtrembëroni, ngatërroni*

me theksin tuaj të huaj jo vetëm fjalët por edhe vetë fryshtën e poezisë gjermane!

Alfredi ngre kokën. Unë nuk e shoh dot në sy. Mbërthej vështrimin në njërin nga katroret e mbulesës së tryezës. Megjithëse nuk e shoh, e di mirë se në këto caste atij i lëviz një tik nervor në nofullën e majtë dhe sytë menjëherë i marrin një hije të zezë që të trondit.

— Vazhdo, — i them, pa ngritur sytë.

Alfredi vazhdon të lexojë me një ton tjetër, të lehtë, njësoj sikur po thotë tekstin e ndonjë operete. Me siguri këtë e bën që të më lehtësojë mua.

— Së shpejti nuk do ta konsideroni vreten si aktorin e parë gjerman; te gjermanët po rilind krenaria nacionale dhe pasardhësit e teutonëve do t'ju hedhin jashtë derës ju dhe ata që janë si ju... A s'të vjen për të qeshur? — shton Alfredi.

— Ma kishin futur nën derën e studios, — sqaroj unë, — ja përsë ndoshta luajta me nervozizëm, Karl!

Karli më hedh dorën në sup miqësisht.

— Kuptoj, — thotë me qetësi.

Alfredi e mblodhi letrën shuk në duar. Pastaj unë e ndiej se si duart e tij kërkojnë të krijojnë grushtin dhe grushti kërkon sherrin.

— Maskarai! — shfryn ai. — Unë e di se kush e ka bërë.

— Kush? — pyesim njëherësh unë dhe Karli, por që të dy e dimë.

— Bryneri!

Alfredi shtyn me nervozizëm karrigen, ajo lëshon një zhurmë 'gërvishtëse. Ai ngrihet dhe, pa kërkuar ndjesë, ikën me rrëmbim. Dera rrotulluese tringëllin për një kohë të gjatë. Unë e përfytyroj Alfredin duke ecur nëpër natë. Në këto çaste ftyra e tij është e murrëtyer dhe me vete thotë mijëra sharje e kërcënime, që mund t'i thotë me zë të lartë vetëm në qoftë se rastësisht atë çast do ta gjejë Brynerin. Ndryshe gjithçka do të paloset brenda Alfredit. Dikur Bryneri i kishte shkruar një letër kërcënuese edhe Alfredit kur kishte luajtur rolin e Faustit.

«Lakuriq nate, — kishte thënë atëherë Karli. — Ekuilibrin atij ia prish drita e diellit. Suksesi i të tjerëve e tmerron si nuset e reja të porsamartuara murgeshat.»

Por kjo letër nuk shpreh thjesht ambicie. Ka diçka më shumë, që unë filloj ta ndiej pak nga pak, ndërsa qëndroj i heshtur përballë Karlit, që ka ulur sytë i menduar. Kur nisa të punoja Hamletin, më nxiti një fejton i shkruar në gazetë.

Atë ma solli Karli. Në fillim nuk e kuptova. Në fejton thuhej se çdo gjermani, sipas statistikave, i takonin kaq marka, kaq mish, kaq makina, e të tjera. Autori i fej-

tonit thoshte se ai nuk kishte asgjë nga ç'i takonin mésatarisht dhe kërkonte të gjente se kush e kishte marrë pjesën e tij. Unë në fillim nuk e kuptova se çfarë lidhjeje kishte kjo me mua.

«A nuk të duket se çdo gjerman i ndershëm është një Hamlet për padrejtësitë që i bëhen?» më tha atëherë Karli.

Filloj të ndiej se, ndonëse mbrëmja duket e qetë, ndonëse drita derdhet e butë nga globet e bardha qumësht brenda kllubit, ndonëse jashtë rruga duket e qetë, e zhystur në humbëtirën e natës, ndonëse njërezit qëndrojnë secili në punët e veta, një rrymë e ftohtë armiqësie përshkon gjithçka. Unë tani e lidh gjithçka me atë kryq të thyer të vizatuar me bojë të zezë mbi afishen e shfaqjes sime, pikërisht mbi sytë e mi, sikur të donin të m'i lidhnin që të mos shihja.

— Për fat të keq, zëri i Brynerit rezonon mirë në këtë Gjermaninë tonë... akustike! — thotë më në fund Karli. Kështu e ka ai, hesht gjatë.

— Si ta kuptoj këtë? — pyes unë.

— Përfytyro një depozitë me' ujë të qelbur, të harruar hapur. Në fillim ajo mbush vetëm një gotë, pra vetëm shpirtin e një njeriu, pastaj uji mbush lavamanin, fillon të derdhet, lag dyshemenë, del pastaj nëpër shkallë dhe zbret deri poshtë në

rrugë e në shesh dhe përmbyt me ndyrësi tërë qytetin, aq sa vjen erë.

— Kuptoj! — i them dhe i propozoj të ngrihemë.

Karli kërkon të më shoqërojë, por i them se dua të iki vetëm. Atëherë ai thotë disa fjalë për të më dhënë kurajë, por unë vazhdoj ta ndiej veten të fyter, të huaj, dhe çdo fjalë qetësuese ma shton dhimbjen.

Më kujtohet kur luajta për herë të parë në skenë. Ende më ushtojnë në vesh, aq sa më rrëqethin, ato vërshëllima, britma, sharje, të gjitha njëherësh të ngjeshura.

«I ćmendur!»

«Turimajmuni melankolik!»

«Jashtë nga skena gjermane!»

«Violinë e vjetër, e shkurdisur!»

«Tingull histerik!»

Atëherë unë dëgjoja i heshtur në dhomën time, i strukur atje si urithi. Qëndroja i ulur, me litarin në sup (atë litar e kisha të mbështjellë rrëth qafës, sepse në rol unë do të varesha), dhe pashë se nga pëllëmba e dorës më rridhët gjak. Dukej që isha gërvishtrur kur mundohesha të ngjitesha në muret e ashpra të skenës, ku kishte shumë gozhdë të ndryshkura, por që nga zemërimi i ćmendur nuk kisha ndier asgjë. Vështroja pikat e gjakut, atë ravijëzim

të çuditshëm si diafragmë e lojës sime, dhe mendoja:

«Do të flasin përherë, ndoshta nuk do të më kuptojnë kurrë, do të mundin vetëm të më admirojnë ose të më urrejnë...»

Kur kujtoj këto gjëra, ndiej nevojën të mbështetem diku. Për të qëndruar i fortë, vazhdoj të eci. Një makinë më kalon me shpejtësi pranë duke lënë pas vetes një erë të ftohtë dhe duke bërë të më valëvitet cepi i palltos. Ngjishem fort në cep të trotuarit. Nata është shumë e errët dhe më kujton errësirën e skenës një sekondë para se të hapet perdja. Vërvshëllej një arie. «La dona e mobile...» Më kujtohet monologu i Shtritmajerit, atij piktorit të ri që vazhdimisht e kam parë të dehur, ashtu si dhe në ditën e parë kur më njohu Karli.

«Sot mua nuk më pranuan në galeri një portret, vetëm se ai ishte çifut, — më tha. — Dhe unë, e dini se çfarë bëra? Ia fala një të vobekti që i binte sazes e lypste anës rrugës. Nuk bëra ndonjë gabim. Vështrimi i çifutit tim do të bjerë mbi kapelën e pluhurosur dhe do të numërojë tërë ditën monedhat që tringëllijnë. Punë e denjë për një çifut, apo jo?»

Më pranë gjendjes sime është pjesa tjetër e bisedës së tij.

«Sot unë mendoj ç'do të bëhet me mua! Më duket sikur kam brenda vetes një zgat-

vër të madhe, të pafund. Një humbëtirë. Jam 26 vjeç. Jam përpjekur edhe unë të zgjedh një udhë... zë, ose më mirë të them një monopat në art. Profesori im. mjeshtri i shquar M., më ka veçuar vetë dhe më ka thënë të merrem me portrete. Dhe unë e kam besuar. Kam filluar t'i studioj njerëzit nga sytë, nga buzët, xigomatikët, balli, nga rrudhat e gushës dhe prej këtyre t'u kuptoj shpirtin... Njoha kaq shumë portrete të të tjerëve dhe nuk arrita të njihja mirë portretin e vetes. Së unë kam bërë një gabim të tmerrshëm. Unë **merrem** me njerëzit, dhe njerëzit janë të vdekshëm. Më mirë do të ishte të isha marrë me peizazhe, sepse natyra është e përjetshme, ajo nuk njeh as politikë dhe as modë. Gjethet janë njësoj, të blerta, dhe drurët nuk përzihen në punët e njëri-tjetrit... Tani kam vendosur të bëj portrete artistësh dhe, po të duash, unë e filloj nga ti. Artistët janë ndryshe. Arti është i përjetshëm, si natyra, dhe nuk ndryshon me koniunktura politike. Njerëzit ju duan dhe ju duartrokasin dhe kush nuk do të vendoste në sallonin e kështjellës së tij një portret të hijshëm, të përcudnuar nga një dhimbje e thellë gjatë interpretimit apo nga një ngazëllim marramendës...»

Më vjen të qesh hidhur kur kujtoj se si mund të bëhet Shtritmajeri, po të marrë

vesh përbajtjen e letrës që më kanë dërguar. Me siguri do ta zërë frika. Do të kthejë dhe një gotë tjetër dhe do të qëndrojë pa folur, duke menduar se çfarë zgjidhjeje të re i mbetet të gjejë për të rezistuar në këtë lojë kukamçefti të jetës me artin.

«Është mirë që të kthehem në shtëpi», them unë dhe shoh rrugën e errët ku kam ecur. Dritat e shtëpive janë të fikura. Është vonë dhe njerëzit flenë.

Vetvetiu më vijnë ndër mend vargjet e njohura:

*Le të qajë i plagosur dreri,
o, le të qajë e pangarë dhia,
se njëri fle dhe tjetrin e ha vreri,
kështu na qenka bota, njerëzia...*

Kam qejf t'i them këto fjalë më ulërimë në mes të qetësisë së thellë të natës, por e kuptoj se është më mirë të kaloj i heshtur drejt atij feneri që e lëkund era dhe që tre-gon se ku është kthesa e shtëpisë sime. Nuk dua ta lëshoj më veten në mendime, sepse Golgothaja e tyre nuk merr fund kurrë.

Nis të vërvshëllej e më pas të këndoja me mërmërimë:

«La dona e mobile...»

«Unë vetë kam vendosur të vuaj, — i them vetes, — përderisa zgjodha artin. A nuk është arti një dhimbje, një dhimbje e gjatë sa vetëjeta?»

Fenerin në fund të rrugës e lëkund era dhe prej kësaj hijet e shtëpive ndryshojnë trajtë dhe dimensionet në muret përballë. Është një peizazh i lëvizshëm, që më argëton për pak çaste dhe më bën të ndihem në lojë, meqë përpinqem të zërthej figurat që krijojnë. Kaq mjafton që unë të hyj në shtëpi krejt i qetë në fytyrë, dhe bile-bile t'i them dy fjalë dashurie gruas sime. Kemi vite që jemi martuar, por nuk i kam harruar ato fjalë që thuhen thjesht e plot efekt për të shkundur gjithçka të zyrtë e të rëndë nga një mbrëmje e gjatë dhe e lodhshme.

Mëngjesi më gjen me një mendim në kokë.

«Unë jam i huaj!»

Nuk kam menduar asgjë gjatë gjithë natës, gjumin e kam bërë të qetë dhe e mbaj mend mirë se nuk kam parë asnje tëndërr të keqe që të them se ky mendim është pasojë e tyre, përsëri këto tri fjalë më duken si përfundim i një përpëlitjeje të gjatë.

«Unë jam i huaj!»

Ndoshëta këtë ndjesi më kanë krijuar ato dy fjalë dashurie që i pëshpërita gruas

mbrëmë që, megjithëse ngarkuar me rrahje zemre, përsëri janë në një gjuhë të huaj. Babai im është shqiptar dhe nëna është shqiptare nga arbëreshët e Italisë. Por unë pothuajse nuk kam folur fare shqip. Vëtëm kur rënkoj, them disa fjalë të pakuptimta, që me siguri janë në gjuhën e nënës.

Shoh sendet e shtëpisë sime. Më duken shumë familjare. Takoj me sytë e gruas dhe të fëmijëve të fiksuar në një fotografi të madhe. Një abazhur në formën e gjysmës së globit, i ndarë me paralele dhe meridiane, më kujton se bota është shumë e vogël, aq e vogël, sa për të ndriçuar të vërtetat që mund të fshihen në një faqë të vetme libri netve kur nuk ke gjumë.

Por në këtë botë të vogël unë jam i huaj.

Atmosferën në shtëpi e kam shumë të ngrohtë, gjithçka që shoh rrëth ë qark e kam vënë me djersën time të ndershme, e, megjithatë, ky mendim i çuditshëm më bën t'i shoh ndryshe të gjitha e të më duken si objekte butaforike, të rrëme, të ftohta. Më duket sikur nuk mund të mbështetesh me forcë në mure, se ato thërrmohen në kokrriza kartoni dhe tutkalli, çezmën nuk mund ta mbaj gjatë hapur, sepse lavamani mund të laget dhe të griset si të jetë prej letre me ngjyrë...

Bëhem gati shpejt dhe dal në rrugë. E

harroj për pak caste mërzitjen, që më pas-ka dhënë një dhembje të tmerrshme koke. Hyj në një farmaci dhe marr një pako me aspirina. Farmacisti është një djalë i ri që nuk e njoh. Megjithatë ai më buzëqesh dhe kërkon të m'i japë falas. Me shumë mundime të tij, unë pranoj, por i premtoj se do t'i jap një biletë për shfaqjen time të sot-me.

Ai më shoqëron deri jashtë. Mëngjesi premtion për një ditë të mirë, të freskët dhe me diell. Diku në një kënd të rrugës shoh afishen e shfaqjes sime. Vë re nga larg një copë letër të bardhë të ngjitur mbi të dhe ndihem i kënaqur që të paktën nuk është ai kryq i zi i thyer. Bëhem kureshtar të shoh se ç'është ajo letër. Në fillim mendoj se mos është ndonjë lojë e fëmijëve të shkollave. Më ka ndodhur një herë që mbi portretin tim të jenë shkruar edhe orare takimi dashurie të atyre që e kanë të vështirë ta gjej-në njëri-tjetrin. Jam kënaqur shumë kur kam lexuar «Fred, në orën katër, te kisha jonë, Juli.»

Letra e bardhë më ka qarkuar ballin sikur ata që e kanë vënë, ta dinin se unë sot do të kisha dhembje koke. M'i kanë shtrënguar tëmthat fort. Mbi të është shkruar: «Anulohet!» Si anulohet? Kush anulohet? Unë nuk di asgjë që shfaqja të jetë anuluar! Më duket sikur ato germa

kanë diçka të përbashkët me atë pusullën që mora një natë më parë. Nuk jam në gjendje të dalloj nëse është i njëjti shkrim apo jo, por sidoqoftë më duket se e ka shkruar e njëjta dorë.

«Anulohet! Mos vallë...?»

Një mijë pyetje më lindin në kokë. Nissem për në teatër të marr vesh se si është puna. Rrugës, mbi të gjitha afishet kanë vënë atë letër të bardhë që është kaq sinkron me dhembjen e tmerrshme të kokës.

Nuk di përse dhembjen për veten e ndiej në formën e një keqardhjeje për atë djalin e ri të farmacisë që ndoshta i prishi më koi të gjitha programet e mbrëmjes, ndoshta një takim dashurie, mundet la pa pirë një gotë birrë bashkë me shokët e tij.

Në teatër është rrëmujë e madhe. Të duket sikur punëtorët e skenës nuk kanë fjetur tërë natën. Shoh njërin prej tyre, me sytë e nxirë e të enjtur nga pagjumësia, që ngre një tog të madh flamurësh.

Inspektori i skenës më del përpara të për i alarmuar. Ai ka hapur duart dhe tund kokën sikur do të thotë se na ka gjetur ndonjë gjëmë e madhe.

— Na urdhëruan, mjeshtër, nuk kemi ç'bëjmë.

— Ç'do të thotë kjo *na urdhëruan*, — thëm unë dhe kujtohem se shkrimi mbi afishe është i dorës së tij.

— Na zunë sallën. Sot pasdite këtu do të bëhet një miting i Partisë Naziste.

— Këtu? Po parashikimi...

— Ah, mjeshtër, parashikimet në kohën e sotme mund të bëhen vetëm afatshkurtra.

— Unë nuk e di se çfarë afati më të shkurtër doni, sesa vetëm një natë... — them i zemëruar.

— Në një natë mund të zhduket edhe një jetë njeriu, mjeshtër, nuk është shkurt!

— më thotë ai dhe unë ndiej në zërin e tij tonin e fajtorit, të fatkeqit dhe të korrëktit. Ai nuk ka faj.

Mbyllim në studio dhe qëndroj për një kohë të gjatë para pasqyrës. Portieri më sjell një kafe. Ai nuk më shikon në sy, e hedh vështrimin herë mbi një parukë, herë mbi një afishë, dhe unë, duke ndjekur vështrimin e tij, zbuloj një tufë lule të thara. Janë lulet e mbrëmshme.

— Merri, — i them.

— Po... — matet të më kundërshtojë ai, se ma di zakonin, që unë nuk e ndërroj tufën pa ardhur tjetra. Ndoshata edhe kjo ka ndikuar për të më shtuar këmbënguljen për suksesin. Ndihem shumë i trishtuar kur shporta është bosh, ose kur shoh lulet që thahen përditë.

— Merri, — i them, — sot nuk ka Hamlet. Gjersa të më vijë përsëri radha,

kushedi sa lule do të jenë tharë e sa të tjetra do të kenë çelur.

Ai i merr në heshtje dhe del po në heshtje, pa u ndier. Lulet kanë varur kokën.

Ulem në një kolltuk; mbështet kokën mbi duar dhe dremit për një kohë të gjatë. Një vorbull marramendëse mendimeshi më rrëmbe është dhe më vërtit poshtë e përpjetë në një karusel të tmerrshëm, që i ka humbur çelësi.

Nga dremitja më shkundi Frici. Ai, pasi ka marrë leje të hyjë, vjen i heshtur, sikur do të bëjë një ngushëllim vdekjeje. Ka veshur kostum të zi dhe këmishë të bardhë. Kollarja e zezë e kufizon atë pak bardhësi që përpinqet të vendosë jaka. Edhe Frici është i mërzitur. Tani Frici është plak dhe nuk mund të luajë dot role të gjata. Roli i tij i fundit është fantazma e tim eti.

— Sot ka qenë një natë e keqe, — më thotë ai.

— Sigurisht, — i them, — kur të pret një mëngjes i tillë!

— Unë dhe Liza nuk kemi mbyllur sy fare, — vazhdon ai dhe më shikon thellë në sy, me një vështrim të tillë, sikur ka aty dy gropat e një kafke.

— E paskeni marrë vesh që mbrëmë? — pyes unë.

— Ah, jo! Nuk është puna për një

shfaqje, — më thotë ai. — Mbrëmë mua më thanë të ndahem nga Liza, sepse është çifute!

— Të ndahesh? Kush e tha?

— Më trokitën në derën e shtëpisë mbrëmë disa djem me pishtarë në duar. Ishte midis tyre edhe Bryneri.

Unë kërcej më këmbë.

— Ah, Bryner! Ah, djall! — ulërij unë me gjithë fuqinë e shpirtit dhe qëlloj fort një shandan me qirinj të tretur. Ai bie në dysheme dhe tringëllin për pak çaste.

— Është e tmerrshme, — vazhdon Frici dhe mua më duket sikur mblidhet krus-pull dhe bëhet më i vogël, edhe më i vogël nga ç'është bërë prej pleqërisë së gjatë. — Ata më propozojnë të ndahem me gruan në këtë moshë. E pra, ajo nuk ka bërë asgjë të keqe. Kam pesëdhjetë vjet që jetoj me të. Ti nuk e di sa të lumtur kemi qenë me njëri-tjetrin. Fëmijë vërtet nuk patëm, por fëmijë jemi vetë për sho-shoqin. Kur unë luaj në skenë, ajo qëndron në lozhë dhe qan. Ka qarë bile edhe kur kam luajtur komedi. Përse, e pyes unë? Nga lumturia, më përgjigjet. Dhe ja tani na u dashka të ndahemi...

Unë i shkoj pranë dhe i hedh dorën mbi sup. Supet i dridhen si drurët nën erë. Ai është dobësuar shumë dhe duket sikur nën xhaketë nuk është një njeri, por hija e tij.

— Po ndoshta Liza nuk është çifute!
— i them unë për ta qetësuar.

— Është! — më thotë me një zë të shuar, sikur është djegur e tërë e vërteta.

Unë vij vërdallë nëpër studio. E di se çfarë do të thotë të jesh çifut në këtë kohë. Jo më larg se okeloja «Rubrikë kulturore», ku është shkruar vazhdimisht për mua shpeshherë kam lexuar lajme të tmerrshme, ngjarje tronditëse, ku më të lehat janë hedhjet nga katet e larta dhe vrasjet në rrugë e xhamat e thyer. Tani po mendoj se ato kanë qenë në fund të fundit spektakle, njësoj si spektaklet e mia, ndaj nuk paska qenë rastësi që janë botuar kaq pranë e pranë. Janë spektaklet ku koha tregon vetveten.

Frici vazhdon të flasë me zërin që i dridhet. Më thotë se ka ndër mend të fshihet, si shumë familje çifute, në pritje të ndonjë pasaporte për të ikur jashtë shtetit. Plot çifutë, kur i kanë kapur, i kanë nisur me tren në kampet e punës, nga të cilat askush nuk është kthyer. Një pelerinë mëndafshi e ngjer me bojë të kuqe si gjak më ngjatërhohet nëpër këmbë. Unë e shkul me forcë dhe e hedh diku tutje. Ajo bie ngadalë, si krah i këputur zogu dhe lë pas pluhur.

— Ka kohë që rrojmë me halucinacione,
— vazhdon Frici me një zë të brendshëm

gjoksi, fare pranë mërmërimës, — po mbrëmë ka qenë e tmerrshme. Nuk mbyllëm sy fare. As unë, as Liza. Kur ndodhët që dremitja për pak çaste, ngrihesha i llahtarisur dhe përgjoja çdo zhurmë që vinte nga rruga. Parandiej keq!

Më rikthehet përsëri ajo ndjesi që kisha në mëngjes.

«Edhe unë jam i huaj!»

Kur shoh Fricin që është bërë një grusht, më vjen të qaj. Ngashërimi më mbyt të gjitha fjalët dhe më duket sikur një ditë më vonë edhe unë do të kem po atë pamje. Bindem se Frici është vetëm një hap përpara në këtë Kalvar mundimesh, ku do të më zvarritin edhe mua. Frici vazhdon të flasë dhe më duket sikur vërtet ai është fantazma e tim eti, njësoj si në shfaqjen e mbrëmshme, që më zbulon një të vërtetë të tmerrshme.

Që të mos ngatërrohem më tej, dal të gjej Alfredin. Nëpër shkallë shoh të hedhur pa kujdes, njëra mbi tjetrën, copëzat e mureve të Elsinorit. Të lëna njëra mbi tjetrën, ato të krijojnë idenë e një rrënimisë. Alfredi ende nuk ka ardhur. I lë porosi portierit që, sapo të vijë, të më takojë menjëherë.

— Zoti Bryner pyeti për ju! — më thotë portieri dhe kjo më kthjellon menjëherë. E gjithë turbullira që kisha, zhdukët, ashtu

siç zhduk retë e dendura shiu me rrebesh, dhe më mbetet vetëm një inat i kthjellët e i qartë.

— Ku është? — pyes, dhe portieri më tregon me dorë.

Shoh figurën e Brynerit diku përtej disa dërrasash dekorë dhe, ndonëse është larg, më duket sikur ia shoh vështrimin e zbardhëlyer, atë nënqeshjen e mangët që i del prej dy buzëve të holla të ngjitura fort me njëra-tjetërën dhe lëkürën e bardhë si të lyer, për fat të keq, me dritë të bukur hëne.

Bryneri më pret buzëqeshur, sikur kërkon t'i bëjë ballë kështu zemërimit tim. Ka zgjedhur një mënyrë tëpër heroike dhe të sigurt. Ai ka qenë artist dështak dhe i paafte, ndaj edhe falsiteti i duket sheshit.

— Unë e di që ti më sheh siç do të shihte Hamleti vrasësin e të atit, — nis të thotë ai një frazë të menduar që më parë, — grabitësin e fronit dhe dashnorin e së emës. Porrri i qetë. Unë nuک kam qenë mbrëmë në shtrat veçse me zonjën Kessler!

I pacipi! Kjo ma shton akoma më tëpër zemërimin.

— Bryner! — i them dhe e ndiej se si më dridhen muskujt e pulpës së majtë nga zemërimi.

— Ma ditkeni emrin, mjeshtër? — më thotë ai me nënqeshjen e tij të pështirë.

— È ka dhe poshtërsia një emër, — i them, — Bryner! Dje kam marrë prej teje një letër kërcënuese...

— E pastaj? — më thotë ai qetë. Kjo qetësi mua më tërbon. Më ngatërrohen fjalët në gojë. Nuk di çfarë të them më parë.

— Ti, — bërtas, — guxon të dërgosh letra kërcënimi?! Ti, që kurrë nuk u bëre aktor e që në jetë të jetëve nuk do të bëhesh? Ti, që nuk të ndihmuani dot të ngjiteshë në skenë as paratë e derdhuralumë të xhaxhait tënd industrialist, as intrigat prej pushti të deklaruar?! Ti guxon të më fyesh në çastin kur unë i jap frymë Hamletit?

Ai më sheh me vështrimin e tij të zbardhëlyer, më hedh paturpësishë dorën në sup. Unë ia largoj dhe ai e vendos përsëri.

— Mjaft! — më thotë me të njëjtin ton që kisha unë. — Siç e sheh, po të duroj shumë. Të ishte për mua, do të ta kisha treguar vendin me kohë. Por kjo koha jonë është shumë e butë dhe mëshirëmadhe. Sa përdijeni, po të them se qysh sot e tutje unë jam zëvendësi i zonjës Kesler dhe gjithçka që ka të bëjë me artin varet prej meje.

— Aq më bën, — ia kthej unë. — Ako-ma nuk je bërë edhe burri i zonjës Kesler?

Dhe bëj të iki, por ai më kap për bërryli dhe nuk më lëshon. Ngaqë ka gish-tërinj të fortë dhe për më tepër më shtrëng-on me inat, më duken krejt si kthethra.

— Të siguroj unë se zonja Kesler mban zi për burrin e saj, — më thotë me qetësi.

— Të brendshmet i ka të zeza!

Dhe ai qesh paturpësisht, ndërsa unë i largoj me forcë krahun.

Ai më ndjek pas dhe thotë atë kërkesën e tmerrshme që të marr pjesë në veprimtaritë naziste. E dija prej kohësh që do të ma bënin një ditë këtë kërkesë.

— Unë nuk jam këngëtar kabareje, — i them në ecje e sipër, pa i kushtuar kurfarë rëndësie.

— E kuptoj që je zemiëruar, — vazhdon ai dhe më ndjek pas edhe disa hapa. Ka hapa të vegjël e të shpejtë. — Por unë përsëri po të them: Kam porosi të bëhem miq!

Unë qëndroj, kthehem drejt tij dhe e shoh me përbuzje.

«I mjeri Bryner! Nuk e luajti dot Klau-din në skenë dhe po përpinqet ta luajë paturpësisht në jetë!»

Duke ikur, kujtohem se ndoshta zonja Kesler e ka emrin Gertrudë. Kam luajtur një sezon teatral bashkë me të, kur ajo ende nuk ishte martuar me regjisoren e kinematografisë F. L. Pas martese ajo luante vetëm në filmat e tij. Mirëpo ka kohë që nuk kam parë më asnjë rol të saj, sepse F. L. u arratis në Amerikë, ngaqë ishte çifut. Kur iku F. L., «Gertruda» e demas-

koi në mënyrë publike. Bëri një dokumentar për jetën e tij private, ku i trajtoi siç deshi fotografitë e tyre intime. Kishte mbledhur edhe shumë fotografi të tjera (një numër të madh të tyre me siguri i ka sajuar), dhe të gjitha i vuri nën titullin e përbashkët «Jeta intime e çifutëve». Që atëherë ajo merret me organizimin e regjisurës së manifestimeve naziste dhe për këtë mbledh rreth vetes të gjithë artistët që mundet. Më kujtohet një intervistë, ku midis të tjera ve pati thënë: «Më thonë se kam braktisur parimet e mia të mëparshme artistike, tendencën time për t'u marrë me jetën intime të njerëzve. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Në fund të fundit, tërë këto manifestime publike janë gjithçka jona, e brendshme, e shpalosur në rrugë dhe sheshe.»

Dakord, e nderuara zonja Kesler! Në rregull, Gertrudë! Po në qoftë se ti vërtet i beson këto fjalë, që në fund të fundit i ke thënë vetë, atëherë mua mos më prit!

Fricin nuk e gjej në studion time. Kolltuku ku qe ulur, më duket i shkretë dhe më kujton një fole zogjsh të boshatisur nga dimri i ftohtë. Ky imazh më bën të rrëqethem. Ulem aty, që të mos ndiej zbrázëtirën që më krijon, por kam përballë kolltukun ku isha ulur vetë, që përsëri më forcon ndjesinë e boshllékut dhe mendimin se njëri nga ne të dy, gjithsesi, është i

humbur. Kujtohem që atë çast unë jam i anuluar, nuk ka Hamlet. Ngrihem dhe lëviz vërdallë nëpër studio. Hedh vështrimin përmbi sendet e rekuizitës e të makiazhit. Të gjitha më duken si sendet e një njeriu që porsa ka vdekur, sende të kota, që nuk i vlejnë më askujt. Është ftohtë. Ende nuk i kanë ndezur kaloriferët. Dal në dritare dhe ngrohem për pak çaste nga rrezet e diellit. Sytë nuk i mbaj dot hapur nga shkëlqimi i lëbyrtë i diellit. Përpinqem të kujtoj ndonjë gjë të gëzueshme ose për të qeshur, që të lehtësoj këtë ndjesi të rendë. Kujtoj kohën kur zonja Kesler vuante nga koliti dhe herë pas here detyroheshim të përshpejttonim ritmin e skenave. Ato shkonin me një nxitim të llahtarshëm drejt fundit.

Përpjekja është e kotë. Asgjë nuk mund ta ndryshojë humorin tim të keq. Një buzëqeshje në fytyrën e një gruaje të veshur me të zeza, i bën të duken edhe më të zeza rrrobat e saj, apo jo? Me sytë gjysmë të myllur përpinqem t'i vë një emër kësaj dite dhe vetes. I mësuar me konvencionet e skenës, vlerësoj gjithçka si një simbol plot domethënie. Kjo jo gjithmonë më bën të gjykoj saktë, po nuk mundem ndryshe. Është një ditë e ngatërruar. Po ç'them kështu? E ngatërruar vetëm sepse më kanë verbuar me atë letër të bardhë mbi pllakatin e shfaqjes së sotme. Është

një ditë e zakonshme, krejt e zakonshme për një Hamlet! Nuk mungon madje as edhe Gertruda (zonja Kesler), as Klaudi (dështaku Bryner) dhe as Frici i gjorë, që, i tretur brenda rrobave të veta, më kujton fantazmën e tim eti. Është një ditë e gjatë me helmin në vesh.

Në sallë bëjnë provat e altoparlantëve dhe deri tek unë vjen zëri i keq, metalik i Brynerit, që deklamon disa parulla naziste.

— Një, dy, tre, katër, prova teknike... •Fyhreri ynë i madh ka thënë... Një, dy, tre, katër, prova teknike... Gjermania lulëzoz në saje... Një, dy, tre, katër... Hail!

Zëri i tij më shpon timpanin e veshit, si helmi përvëlues i Klaudit, i tmerrshëm, vdekjeprurës.

Ngaqë provat zgjatin shumë, bëhem nervoz dhe dal në rrugë. Nuk pres as Alfre-din, bile nuk marr vesh as se çfarë u bë me Fricin. Ndjesia se jo vetëm mua, po të-rë Gjermanisë po i hedhin helmin në vesh, më kaplon, ndërsa bares me gjunjët e kë-putur në rrugët që ndriçohen zbehtë nga dielli i Veriut. Për herë të parë-vë re se nuk ka qoshk të qytetit ku të mos jenë ngjitur pllakatet naziste, të mëdha e me ngjyra të ndezura, si zbukurime fëmijnore panairi. Në rrugë janë vendosur shumë altoparlan-te, që përcudnojnë tingujt natyrorë dhe

shpérndajnë një muzikë gërvishtëse, parulla, marshe. Më mbetet në mendje një librari me xama të thyer, të bërë thërrime dhe librat e shqyer. Në vitrinat e saj duket sikur ka zbarkuar një lukuni e tërë minjsh të uritur. Në fillim u kushtoj vë-mendje të rinxve që ecin në një hap dhe këndojnë të njëjtën këngë që ulërin altoparlanti, pastaj gjithçka më duket e mpirë dhe monotone.

Kthehem në shtëpi.

Eshtë një ditë e gjatë, me helmin në veshët e rrumbullt të shesheve dhe në lla-pushet e rrugëve të gjata.

Përtej xhamave njerëzit me pishtarë duken të frikshëm. Ecin tre e nga katër dhe fytyrat u përskuqen duke zbuluar tipare të theksuara e hije të frikshme hundësh, mollëzash, veshësh.

Qëndroj për pak çaste te dritarja dhe vë re se si griset nata nga flakët e pishtarëve. Eshtë një imazh i frikshëm lëvizës, edhe pse e di që ata pishtarë pompozë nuk janë gjë tjeter, veçse kuti konservash të boshatisura, ngulur me një gozhdë mbi shkopinj druri dhe mbushur me pak hi e vajguri.

— Unë them të shkojmë të shohim se ç'bëhet, — ngul këmbë Karli.

Alfredi nuk do, kurse unë, sidoqoftë, e kam një kureshtje.

Biem dakord të shkojmë pa u vënë re. Ka rënë nata e thellë dhe flaka e pishtarëve duket edhe më e frikshme, më e dridhshme dhe më e paqëndrueshme, e gatshme që të vërtitet andej nga fryn era dhe të gllabërojë një copë hapësirë.

— E gjitha kjo filmohet, — tha Karli.
— Kam marrë sot në drekë intervistën e zonjës Kesler. Nesër ajo do të botohet.

— C'hotë? — pyet Alfredi.

Unë vë re se nuk kanë të gjithë pishtarë. Mund të ecim lirshëm. Futemi në mes të një grupi të rinjsh në moshë fare të re, që luajnë «ngri shkri» në ecje e sipër dhe na ngatërrohen niçpër këmbë, na bëjnë të ndihemi disi si në lojë.

— Zonja Kesler pretendon se puna që bën ajo, i përket pavdekësisë. Unë, thotë ajo, bëj të pavdekshme idetë e nazizmit, përjetësoj realitetin, fiksoj madhështinë e kohës sonë në atë mënyrë, që të tmerrojë e të tronditë jo vetëm bashkëkohësit, por edhe brezat që vijnë.

— Sa marka do t'i paguhet një rresht?
— pyet Alfredi. Ai nuk do ta shohë me sy zonjën Kesler. Burrin e saj e ka pasur shok kolegji dhe e lidhin kujtime shumë të bukurë të fëmijërisë.

Karli nuk i përgjigjet. Në xhamat e sy-

zeve të tij reflektohet kuqëlimi i zjarrit me përshkënditje.

— Kur shoh këtu në Sheshin e Paqes kaq shumë njerëz të ndarë në kuadrate, bindem se zonja Kesler është shumë e aftë, — thotë Karli.

— Zonja Kesler është kurvë! — gati bërtet Alfredi. Unë i tërheq krahun që të ulë zërin.

— Zonja Kesler përballon detyra të vështira, — vazhdon Karli qetësisht, duke hedhur vështrimin përqark. Po të mos ishte xixëllimi i pishtarëve në syzet e tij, do të dukej sikur sodiste një natyrë-mort.

— Mos vallë duhet të shkojmë ta ndihmojmë? — i them unë dhe kërcej përpjetë nga qetësia e tij.

— Nuk e kam fjalën aty, — ngul këmbë Karli. — Po më pëlqen vitaliteti dhe madhështia. Pa shiko, asaj i duhet, njësoj si ushtarakëve, të bëjë mobilizimin. Po në qoftë se ushtarakët i ndihmon ligji i mobilizimit të përgjithshëm të popullsisë, asaj i duhet të përdorë vetëm argumentet figurë dhe zë.

Djemtë, në mes të të cilëve jemi futur, ndalojnë, sepse lëvizja është shtuar. Ata kanë lënë lojën e parë dhe kanë nisur të luajnë «biz». Mua më dhimbset njëri prej tyre, që ka mbyllur sytë e kafshon buzën, ndërsa të tjerët, pasi e qëllojnë fort me pë-

llëmbë, bërtasin njëherësh «bizzzz», duke ngritur gishtat para syve të tij. Ai ka fytërë gati-gati fëmijërore.

Një dallgë njerëzish na shtyn në të majtë.

— Kthehemë, — them unë. — Do të na marrë rrjedha e do të na nxjerrë në krye.

— Qëndrojmë edhe pak, — thotë Karli dhe vazhdon të soditë i mahnitur madhësh-tinë e lëvizjes dhe ndarjen në kuadrate.

— Ikim, — këmbëngul unë. Tani do të filmohet.

Projektorët e mëdhenj, që ndizen në çast, u japid bardhësi portreteve dhe na bëjnë ta shohim gjithçka ashtu siç nuk e kemi parë deri në ato çaste. Një operator ka hipur në qerren e Monumentit të Paqes dhe filmon.

Unë vë përpara syve pëllëmbën dhe shmang fytyrën në hije. Tashmë jam njeri pa kokë. Në vend të saj është hija e stërmadhe e pëllëmbës dhe e gishtave të mi të gjatë.

Alfredi i kthen shpinën dritës dhe ngul këmbë që të kthehemë. Atëherë unë nis të çaj me bërryla, pa pritur përgjigjen e Karlit. Alfredi më vjen nga pas dhe Karli na ndjek duke kthyer kokën herë pas here majtas e djathtas dhe duke soditur njerëzit e shumtë. Karli është shumë plak dhe e kënaq rinia. Shumë gjëra, të cilave ai ua ka ha-

rruar emrin, ata i jetojnë dhe kjo i ngjall një lloj ndjenje inferioriteti ndaj tyre.

Më në fund dalim atje ku njerëzit janë më të paktë. Prej andej duket se si brenدا kuadrateve pishtarët formojnë një kryqë madh të thyer, që ende nuk është i plotë.

Në rrugë lëvizin disa djem me motorçikleta. Ulim kokën të ikim pa na vënë re. Megjithatë nuk shpëtöjmë. Thérresin Karlin. Ishte Shtritmajeri, piktori që ka marrë përsipër të më bëjë portretin. Kujtohem se ka kohë që ai ka munguar. Asnjëherë nuk kam dashur që të më bëjnë portretin, sepse vetë kam krijuar portrete të të tjerëve, por, sidoqoftë, moskorrektesa e tij e meriton që të mos i flas e të largohem sikur nuk e kam vënë re. Por ai më kap vetë për krahu.

— Do të më falni për vonesën, — më thotë. — Po ju e dini që kam qenë në çastet e kërkimit të artit tim. A e dini, kam zbuluar një element fantastik për pikturën: flakën. Juve ju duket sikur flaka është një lloj, por jo. Flaka ndryshon, është më e ndryshueshme se qelli apo deti. «Flaka e pishtarëve të historisë», «flaka e shtëpisë së rojtarit të varrezave», «flaka e kufomës së makinitit», «flaka e dashnores prej parafine»... E dini që këto punë më janë shitur ende pa i përfunduar mirë?

Mua më neveritet ky piktor i dehur,

që kujton se e ka shpikur ai dekidentizmin, duke harruar se mendje të shthurura ka pasur në çdo kohë.

Vazhdoj rrugën.

— Sidoqoftë unë do të vij edhe të ju...

— Në qoftë se digjem, — i them unë pa e kthyer kokën dhe më vjen për të qeshur me këtë që i them.

— Shiko, — i thotë Alfredi me zemërim, — shko piktuoro këtë Gjermani piktoreske!

Shtritmajeri ngelet në mes të rrugës, i rrëthuar nga zhurma e motoçikletave. Vërsheilla e frenave të tyre më ushton në veshë, megjithëse jam ulur në klub dhe kam kohë që qëndroj i heshtur përballë Karlit. Alfredi i ka ngulur atij sytë dhe e gjykon në heshtje si fajtor. Më çudit kjo gjendja e Karlit, që ngjan si një fëmijë, të cilit apo i kanë prishur lodrën. Nuk mund ta kuptoj edhe pse e dua dhe e ndiej fort. Duket sikur diçka e turpshme, e fashitur deri atëherë, është zgjuar papritur, duke prishur qetësinë.

E tërë mbrëmja kalon pa fjalë. Është një natë e qetë, me yje të shumta. Xhamat janë veshur me avull të lehtë nga frymët tonë.

Nuk e di përse nuk më vjen mirë të flas. Karli heq syzet dhe fillon t'i fshijë dalëngadalë me shami, me lëvizje të ngathë-

ta e të plogështa. Edhe ai u trembet fjalëve. Alfredi troket nervoz me gishta syprinën e tryezës, e melodisë që përpinqet të ripro-dhojë, i ngatërrohet ritmi.

„Befas dera e madhe rrrotulluese tringë-llin fort dhe në të vërsulen një grup njerë-zish të veshur me këmishë të murrme dhe pas tyre ca të tjerë të veshur si punëtorë. Nuk kam kohë të shoh se kush janë, sepse këmishëmurrmit më marrin dhe më vendosin përballë murit, me duart lart.

— Aty qëndro! — bërtet njëri dhe më vë revolverin poshtë veshit.

Të njëjtën gjë kanë bërë edhe me nje-rezit e tjerë që u ndodhën në klub. Unë shoh se muret e klubit kanë njolla të lehta lagështire. Ndoshata nga frymët tona janë krijuar ato hartëza të vogla që të kujtojnë shtetë të ndryshme të botës.

— Fillojmë, — bërtet sërish ai zë i tmerrshëm që më ka tringëlluar në rrëzë të veshit dhe dëgjohet një e qeshur e madhe, që bën të kumbojë e tërë salla. Me sa ëdhet, kanë vendosur të na terrorizojnë.

Unë atëherë përfytyroi kasaphanën. Kuj-tohem se kam kaq shumë gjëra në jetë, që ende nuk i kam bërë. E ndiej se, sado të jetosh, është pak. Ditët as dalin, as mbarohen..

E qeshura e frikshme përsëritet dhe unë guxoj të shoh me bisht, të syrit atë

njeri, që ka një vështrim të zymtë prej Mefistofeli. Këmishëmurrmit rrështohen njëri pas tjetrit.

— Kthehuni këtej, — bërtet zëri i tmerreshëm dhe ne të gjithë kthehemë pa marrë vesh se çfarë bëhet. Unë mbështetem fort pas murit dhe e ndiej se jeta më ka sjellë rastësisht në këtë breg dhe nuk e kuptoj se si ë kam gatuar kështu fatin e jetës sime, që më duhet të përballoj gjëra që nuk më përkasin. Ndoshta, po të ishte ndryshe...

Atëherë e kuptoj se këmishëmurrmit nuk janë gjë tjetër veçse një grup aktorësh rruge. Ata shpërndahen nëpër shkallë pa ndonjë Mizanskenë të paracaktuar dhe fillojnë të recitojnë disa vargje që të kujtojnë konceptin teatral të Brehtit:

*Sot ishte lodër,
por nesër drejt teje
një armë e vërtetë
do shkrepë si rrufeja!*

Çdonjëri prej tyre zë vend përballë se cilit prej nesh dhe marrin nishan me revolverët e shpuar të rekuizitës së ndonjë teatri të periferisë.

*Përpara meje
ti s'je asgjë,
sa një fishek
koka të vlen!
Pra asnë markë!*

Njeriu që është përballë meje, më buzë-qesh në mënyrë miqësore, në heshtjen midis dy vargjeve. Pastaj ai më ngul fort gishtin trëgues në gjoks dhe unë e kuptoja që ai më ka buzëqeshur që të mos bërtas kur të ndiej të më godasë fort në gropën e gjoksit.

— Ky thotë «Shekspiri!»

Ai që qëndron përballë Karlit, vazhdon me një zë të ngjirur:

— Ky thotë «Shileri!»

Një tjetër, që ka qëndruar përpara banakierit, vazhdon me të njëjtin ritëm dhe duke nënvizuar talljen:

— Ky tjetri Gëten e di përmendësh!

Në të vërtetë banakierin mund ta ngatërosh lehtë me ndonjë artist. Ka portret fisnik dhe sy të mëdhenj e plot melancoli.

— Po kjo çfarë vlen? — thonë të gjithë njëherësh në kor.

Dhe vazhdojnë duke ndarë vargjet njësoj si në një recitim shkollarësh.

*Me një tytë pushke
të vë pas muri,
t'i harrosh të gjitha
në frysëmarrje të fundit,
ndaj të bëj thirrje
të mos vazhdojë më tej
kjo kasaphanë
dhe luftë e re.*

Mua më shfaqen para syve drithërimat e pishtarëve dhe përqëndroj vëmendjen në hapjen dhe mbylljen mekanike të buzëve të tyre. Ndoshta ata nuk do të donin të flisnin në vargje, por kjo është mënyra më e mirë për të futur në një ritëm një shumicë njerëzish.

Ata hedhin një tufë fletushka të bardha nëpër sallë dhe ikin. Ndónëse e gjithë kjo që ndodhi, gjithsesi e ka një tingëllim qesharak, ata largohen të heshtur, seriozë dhe hijerëndë (si Kasandra që paralajmëron një katastrofë të tmerrshme e të përgjakur).

Ne ulemi përsëri në tryezë. Salla nis të gumëzhijë. Në banak tingëllon fort një e hapur shisheje. Ne nuk themi asgjë. Nuk rrihet më. Alfredi ngrihet i pari.

— Ikim!

Unë shoh orën. Dikur kam kujtuar se një artist është i harruar nga të dyja pa-

lët. Në të vërtetë ai është i sulmuar nga të dyja palët.

Rruga është e qetë, por e frikshme. Diku më zë syri një pllakat të Hamletit. Qëndroj për pak çaste i menduar përpara syve të mi, ku një fëmijë ka shkruar germën A të madhe të shtypit.

Ky detaj më krijon një ngrohtësi e një mall për gjëra të largëta, të harruara. E heq me kujdës atë pllakat dhe e marr në dorë. Kam ndjesinë se kam bërë një mirësi. Më duket sikur e kam shpëtuar nga një gjë e keqe atë A të shtrembër e të pastër, të shkruar plot përkujdesje nga një dorë e vogël, e pasigurt.

Gruaja më sheh që nuk jam mirë. Më pyet se çfarë kam. Dhe unë i përgjigjemi ngadalë:

*O prapësi, o dreq!
Që paskam lindur të të ndreq!*

Ajo për herë të parë nuk më kuption, sepse unë ia them pa asnjë nuancë teatraliteti. Kur ia përsërita, më buzëqeshi.

Kjo kohë është shumë e ngatërruar, nuk e dallon dot se ku fillon spektakli dhe ku mbaron jeta.

Don Kishoti

Në konferencën e shtypit unë dola pa
hequr parzmoren dhe kaskën butaforike në
ngjyrën e gjelbër në të kuqërrëmtë të bakt-
rit të ndryshkur.

Ndoshta kjo e krijoj atë ndjesi vjetërsie që më shoqëron në çdo rast dhe që e
bën Alfredin të më thotë se jam një Don
Kishot i vërtetë.

Mua nuk më duket fare e çuditshme që ai më quan kështu, përkundrazi, më duket sikur e meritoj këtë emër, jam kre-
nar dhe më lind dëshira të luaj me çdo kusht don Alonso Kihanën, Kalorësin e Mjerë të Fytyrës së Vrerosur. Vetëm se unë atë e ndiej thellësisht në tragjizëm dhe kurrë nuk do të mund t'ia pranoja anën komike.

Ka ditë që në çdo send ndiej tragjizmin. Kështu, kur shoh fëmijët, sytë e tyre më duket sikur mbajnë një ngarkesë vje-
shte të lagësht me shi e llohë, bile edhe kur u përkëdhel flokët e butë si mëndafshi, në çast i përfytyroj me kokat e qethura, ku zbulohen shenjat e plagëve të marra. në

lojëra fëmijërore. Pikërisht këto ditë kam vënë re për herë të parë edhe rrudhëzat në ballin e sime shoqeje. Nuk e kisha vënë re që qenkej plakur. Në ballin e bardhë të saj ato m'u dukën si buzë greminash e krateresh në sipërfaqen e ftohtë të hënës, siç e kam parë në një revistë të ilustruar. Edhe vetja më duket si njeri i detyruar ta ndërtojë argëtimin e tij brenda një kazerme nga ku ëndërron të ikë. Që kur më ndodhi ajo përplasja e shëmtuar në konferencën e shtypit, mendoj vetëm përkjen time. Kontratat jam duke i përfunduar, ndonjëren mundet edhe ta lë përgjysmë. Kam kursyer aq para, sa të paktën për një vit të jetoj pa dhembje koke, natyrisht pa atë pjesë të dhembjeve që varen nga xhepi.

Alfredi vjen vërdallë nëpër dhomë.

— Ishte tjetër puna e Fricit, — më thotë ai. — Ti nuk ke arsyе pse të kesh frikë dhe të kthehesh në mesjetë.

Fritzin dhe Lizën i ka fshehur Alfredi diku, në pritje që t'u gjejë pasaportat false, për të iikur nga Gjermania. «Nuk ta tregoj se ku, — më është përgjigjur Alfredi kur e kam pyetur, — sepse ti je një fëmijë që të turbullohet shikimi nga lotët.» Unë nuk ngulmoj, sepse e di që jeta e tyre është në rrezik. Në qoftë se do t'i gjej- në, me siguri do t'i zhdukin.

— Por edhe për mua nuk është lehtë,

— i them. Megjithatë Alfredi nuk do që ta pranojë.

Ai ka grumbulluar mbi tryezën time të punës një deng të madh gazetash, ku me tituj të mëdhenj, në kohë të ndryshme, është shkruar për mua, dhe më tregon disa prej tyre.

— Tashmë këto mund t'u vlejnë vetëm biografëve të mi, — nënqesh unë me qesëndi. — Mua nuk më vlen asgjë. A e di që e ndiej veten si një zog në dimër, të cilit porsa i kanë prishur folenë?

Ai përsëri nuk do ta besojë dhe unë i përmend Karlin. Karli është shtrirë në shtrat dhe nuk është ngritur.

Sa herë që e kujtoj, rrëqethem. Ishte një çast i vetëm; një zbardhje e menjëherëshme e gjithçkaje, si fotografi e djegur.

«Po sikur të jenë kështu të gjitha ditët?» — pyes veten.

— O tmerr! — vë duart në kokë dhe i ngre flokët përpjetë me gishta.

«Po, ndoshta, po të jetë e gjithëjeta një fyerje e gjatë, mpihesh dhe nuk të bën më gjë përshtypje.»

✓Sidoqoftë të dyja variantet janë të këqija.

Alfredi e di fare mirë se çfarë ka ndodhur. Paçka se për Karlin mendon se ka marrë një mësim të mirë për nostalgjinë e tij prej plakushi. Unë nuk jam kaq i ash-

për me të. Nuk kam qenë, bile, edhe atëherë kur Alfredi e qortonte për atë ngazëllim të lig që kishte filluar të shfaqte kur shihte atë lëvizje nëpër rrugë e sheshe. «Më pëlqen gjallëria, — thoshte Karli. — A nuk është madhështor vitaliteti që shpallos kombi ynë?» Por atë ditë në konferencën e shtypit Karli qëndronte i heshtur, pak-mënjanë gazetarëve të tjerë, që më rrrethuan duke më mbytur me pyetje.

— A ka karakter politik interpretimi juaj?

— Si e ndieni veten pas tablosë së parafundit?

— Cili vend ju takon në galerinë e teatrit gjerman?

Unë i dhashë përgjigjet pa i hequr systë nga Karli. Ndoshfa kish parandjenjën se për të ajo do të ishte një ditë e tmerrshme. Karli qëndronte i menduar, ndonëse mund të mos mendonte asgjë. Ndodh edhe kështu.

— Mos jeni monarkist, që luani role mbretërish?

— Cila pije ju pëlqen më shumë?

— A gënjen aktori?

Vura re se Karli u bë gati të fliste. Si të ishte nxënës shkolle dhe kërkonte leje të fliste, ngriti gishtin fregues në ajër. Pas kësaj, përmua të gjithë zërat e tierë u fashitën. Nisa të dëgjoja vetëm zërin prej basi, ndonëse të zvargur, sikur dilte nga nënshtrresat e thella të gjoksit.

— Ju keni studiuar në Gjermani. Gjaku juaj është italian, por në lojën tuaj ka disa impulse të çuditshme, që s'janë as italiane, as gjermane. Këto duken si shpërthime të panjohura dhe unë pyes me ç'qëllim i keni.

Pyetja e tij më bëri të mendoheshha gjatë. Gazetarët qëndruan të heshtur, me blloqet hapur, në pritje. E kuptova përse ma bëri këtë pyetje. Ndoshta donte të justifikonte ato çaste të shpërthimit të lig në plegërinë e tij, pas një jete të gjatë pa njolla.

— Ti më njeh mirë, — i thashë. — E megjithatë bën një gabim të vogël për sa i përket origjinës sime. Babai im është shqiptar dhe nëna ime është shqiptare nga arbëreshët e Italisë. T'i shikosh shqiptarët në jetë, duken njerëz të qetë, por gjithë ajo qetësi shndërrrohet në fuqi luani, dhe s'ka zot që i mban, nëse dikush i prek në sedër ose në të drejtën e tyre.

E pashë në sy' Karlin. Me sa duket, u kuptuam mirë. Brenda xhamave të bardhë, që vezullonin zbehtë, munda të via re se vështrimi i tij ishte i përhumbur. Flokët e përhimtë përsëri më ngjallën imazhin e një statuje të dhimbshme, që nuk flet dot.

— Kaq, — thashë unë dhe hoqa kaskën, sepse e ndjeva që tëmthat m'u djeritën pa masë.

— Kam edhe unë një pyetje, — u dë-

gjua një zë që unë e njihja mirë. Ishte Bryneri, i veshur me mushama të zezë, që shkëlqente nga shiu. Unë nuk e kisha vënë re se kur kishte hyrë dhe ku kishte zënë vend, sikur të ishte hije.

Erdhi dhe më qëndroi përballë.

Më ka ngelur në mendje vështrimi i një gazetari. Ishte si një lepur i trembur nga çiftja e gujetarit.

— Po të, më pyesnin mua personalisht, unë do të t'ë digjja në turrën e druve, — më tha Bryneri me nënqeshje në cep të buzëve të holla, — por detyrohem të të pyes edhe një herë se cili është mendimi yt për aktivitetet naziste.

Unë heshta.

Dëgjohej zhurma që bënte kaldaja që shpërndante avullin e nxeh të nëpër sallë. Ndjeva nevojën të hiqja parzmoren nga vapa e madhe që më kishte djersitur të terin.

— Nuk m'u përgjigjët, — vazhdon ai.
— A do të merrni pjesë në aktivitetet naziste?

Dikush shfletoi bllokun. U bë një zhurmë si ajo e fëshfërimës së pyllit në prag të stuhisë.

— Në njëfarë mënyre nazistët po marrin pjesë në aktivitetet tonë, — i thashë edhe unë me nënqeshje, pasi e blova mirë frazën.
— Ju besoj se e dini që për një javë rresht

shfaqjet tona u anuluan se salla ka qenë e zënë nga mitingjet.

— Të mendojmë se heshtja juaj do të thotë refuzim? — vazhdoi ai. Kishte një këmbëngulje të çuditshme. S'ishte e vëشتirë ta kuptoje se ai priste që unë pikërisht këtë të pohoja, ndryshe, do t'i duhej të mendonte ndonjë mënyrë tjetër si të mund të merrte hak.

— Nuk e di, — iu përgjigja, pa i dhënë asnjë lloj kënaqësie.

— Mos lidhet kjo me origjinën tuaj të dyshimtë? — vazhdoi ai me zërin e vet të shpëlarë.

— Ç'doni të thoni me këtë? — kërceva unë përpjetë, sepse parandjeva në sytë e tij intrigën. Intriga mund të lindë edhe nga sy pa ngjyrë.

— Është një institut i tërë që merret me verifikimin e origjinës së lloj-lloj të famshmish. Në qoftë se del që ti je çifut...

— Kjo s'ka si të jetë e vërtetë, — kërceva unë përpjetë dhe më ra nga dora kaska butaforike. Ajo nuk bëri zhurmë, por vëtëm u shtyp, sepse ishte prej kartoni të ngjitur me tutkall.

— Në qoftë se del që ti je çifut, ti e di fort mirë se sa ngrrohtë i mban Gjermania çifutët. Me zjarr!

— Ai më qëndroi pranë fytyrës dhe unë gati sa nuk e pështyva. Vura re se qerpi-

kët i kishte fare pa ngjyrë, si gjemba të tharë.

— Kjo është e tepërt! — bërtiti Karli.
— Në sallën e teatrit guxonitë kërcënoni një artist?! Ky është skandal!

Bryneri largoi vështrimin nga unë dhe shkoi drejt Karlit me hapa të ngadaltë. Hapat e tij kumbuan si pendule të orëve fatale. Heshtje e plotë.

Pastaj, gjithçka ndodhi, qe e tmerrshme. Unë e mbaj mend përmes bardhësisë së zemërimit. Ai e qëlloi me pëllëmbë Karlin aq fort, sa i ranë syzet. Krisma e pëllëmbës në faqen e tij qe e thatë si krismë çarku. Unë u vërsula t'i ktheja përgjigjen, por më mbajtën, dhe dikush më pëshpëriti në vesh: «Ky është provokacion.»

Nuk e mora vesh se si iku Bryneri, as se si u zhdukën të gjithë gazetarët, vetëm mbaj mend se si kam ulëritur fort me gjithë qenien time:

— Largohuni! Largohuni të gjithë! Të gjithë!

Karli qëndronte në gjunjë pranë kasës sime të shtypur dhe në fytyrë nuk i kishte mbetur pikë gjaku. Ùnë mora në dorë syzet e tij, ia zgjata, por ai nuk guxonë të kthente kokën. Atëherë e pushtova fort me të dy krahët dhe, ngaqë më dukej se edhe kështu e kisha larg, shqeva parzmoren, që më shtrëngonte fort gjoksin, dhe e flaka

te këmbët. Ngjyra e bakrit të ndryshkur më bëri të ndieja gjithçka si një vjetërsirë.

Për herë të parë mendova se edhe unë jam plakur disi.

Alfredi e di të gjithë këtë, po nuk do që ta besojë. Ai nuk mund ta pranojë kurrsemi që unë të largohem nga Gjermania e të kërkoj shtetësi shqiptare.

— Kjo botë nuk ndreqet duke u kthyer në mesjetë, — më thotë ai. — Kjo botë ndreqet ndryshe.

— Kur marrëzia mbretëron në sheshe, nuk mund të flitet veç me gjuhën e saj, — i them unë.

Por ai tund kokën dhe më kundërshton.

— Unë nuk e kuptoj përse kërkon, me çdo kusht, ta quash veten vjetërsirë. Arti është i gjallë. Arti është i ri dhe unë besoj tek ai. Arti që bën ti, nuk është jashtë kohe. Asnjëherë mençuria nuk është jashtë kohe, paçka se shpeshherë mbretërron marrëzia!

— Edhe unë besoj, por nuk di se çfarë të them.

Ai më vë duart, në supe dhe nuk më lë të ngrihem nga kolltuku.

— Kam frikë se do të mbyllësh jetën tënde në mes të atyre maleve, — thotë ai. Zëri i tij ka shumë dhembshuri si dhe dëçka nga drithërima e muzgut të thellë. — Pa mendo se çfarë do të lësh dhe çfarë do

të gjesh. Bëj një llogari të thjeshtë: do të lësh sallat e mëdha të Evropës, lavdinë, gëzimin e krijimit, ndriçimin e bliceve, ushtimën e mikrofonëve. Do të gjesh një vend të humbur, një grumbull njerëzish që kurrë nuk kanë dëgjuar gjë për personazhet e tua, ca salla gjysmëmehjane të pështyra nga mizat. Ti vetë m'i ke treguar këto...

Ai më flet, dhe unë për herë të parë e ndiej kaq të fortë mallin dhe dëshirën për t'u lkthyer në Shqipëri. Ë përfytyroj atë vend me qetësinë dhe pastërtinë që ruaja në kujtesë që nga fëmijëria. Për herë të parë atë çast kuptova përsë pleqtë gjallërohen kur kthehen në vendlindje. Ndoshta dhe mosha ime ka vetëm këtë shërim.

— Alfred! Të lutem, mos! — i them me zë të butë dhe ai hesht.

Unë ngrihem në këmbë dhe marr mantonë. Alfredi më ndjek pas dhe dalim të dy në korridorin e gjatë e të errët të teatrit, pastaj zbresim shkallët e mermarta dhe kërkojmë një taksi.

— Mos ma merr për keq, — thatë Alfredi dhe unë i hedh dorën në sup miqësisht. — Unë mendoj thjesht për ty.

— Nuk dyshoj.

— Dhe për artin tënd!

— Nuk mendoj fare keq! — e qetësoj kur zbres nga taksia dhe ndahem prej tij. Ngjit shkallët e shtëpisë dhe bluaj në

kokë se si do t'ja them Johanës këtë vendim. Johana është e shqetësuar prej shumë kohësh. Paksa po të voniohem, ajo bëhet merak dhe del në dritare, largon perden e mëndafshët dhe vrojton. Ajo më thotë se hijet e rrugës janë të frikshme. Ndoshta kështu duken ngaqë fenerët lëkunden shumë. Ka filluar të fryjë shumë erë. «A thua kështu të ketë qenë më parë?» — pyet ajo.

Në shtëpi është ngrohtë. Njëra nga vajzat është ulur në piano dhe bën sikur kompozon një serenatë. E tërheq zërin zvarrë si llastik, e tendos aq shumë, sa duket sikur do të këputet. Mua më vjen për të qeshur më lodrën e saj. I shkoj pranë dhe bëj edhe unë të njëjtën gjë. Për pak çaste ndihem i cliruar dhe i qetë si një fëmijë. Pastaj sytë e mi takojnë me sytë e Johanës dhe bëhem përsëri i menduar. Kam harruar të vë mantonë në portmanto, e vazhdoj ta mbaj në dorë sikur ajo më ndihmon të mos humbas drejtpeshimin.

Bie zilja e derës.

Ah, qenka baronesha D.!

Ajo vjen e zhurmshme, me zërin midis altos dhe soprano, dhë cicërin pa pushim.

— Sa ngrohtë është këtu në folenë e një artisti, — nis ajo avazin që Johanën e mërzit shumë. — Të zgjohen mijëra dëshira, mendime dhe fjalë të bukura. — Ajo ndalat-për pak çaste në të gjitha tablotë e va-

rura në mure. — Ah, sado trishtim të ketë njeriu, i harron të gjitha në një ambient si ky.

Johana i jep dorën me mirësjellje dhe e fton të ulet, por ajo nuk ma largon shikimin. Më bezdis shikimi i saj, ashtu siç bezdiset njeriu nga një mizë këmbëngulëse.

Baronesha ka sy të lyer bukur. Qerpikët i ka të mëdhenj e të kthyer në modën kra-hë dallëndysheje dhe buzë të holla e të kuqe, të lyera si petale. Është e hollë si një dru pa gjethë dhe e gjatë.

— Ju duhet të jeni shumë e lumtur, zonjë, — i kthehet ajo më në fund Johanës.

— E lumtur? Përse? Unë dua të them se jetoj shumë thjesht dhe bile me shumë tela-she! — ia kthen Johana, që, me siguri, e merr malli të qëndrojë gjatë vetëm me mua.

— Ju keni kryesoren, zonjë, — vazhdon baronesha, — një burrë, në këmbët e të cilët përkulet bota. Dëgjova se gjoja qen-keni çifut! — më kthehet mua.

Unë bëj një gjest bezdie me duart, por, me sa duket, ajo nuk e njeh fare pantomimën.

— Mos u shqetësoni! Po të dëshironi ju, unë mund të ndërhyj dhe t'i pushoj gojët llafazane.

— Unë nuk jam çifut dhe nuk kam pse të trembëm, — ia kthej dhe dua të ndërroj

bisedë, por nuk më kujtohet asnje temë tjetër. Vetëm i lavdëroj dantellat e fustanit të saj të bukur, «që kaq shumë shkon me stinën», por asgjë nuk e bën atë të më largojë madje dhe vështrimin.

Johana ngrihet të bëjë gati gostitjet dhe na lë vetëm.

— Besoj se ke dëgjuar që Frojdin e famshëm, atë shkencëtarin psikanalist, që çuditit njerëzit, e ka marrë në mbrojtje kontesha N. E ç'rëndësi ka që është çifut? Edha unë ju marr në mbrojtjen time. Kështjella ime është më shumë se 200-vjeçare dhe ju nuk jeni i pari që mund të gjeni strehë atje.

Më duket kjo baroneshë sikur sapo ka dalë nga një komedi e keqe dhe më forcon ndjesinë e vjetërsisë. Ndoshta dantella e bardhë e saj nuk është gjë tjetër veçse shenjë myku.

— Ju shoh të trishtuar, zonjë! — i kthehet ajo Johanes, që sapo afrohet përsëri.

— Aspak, — buzëqesh Johana dhe sytë e mëdhenj i xixëllijnë nga një ndjenjë argëtimi. Ndoshta mënyra më e mirë për ta kundruar jetën është komedia. Ajo të largon shumë arsyetime të zymta e të trishtura dhe të bën ta shijosh çdo çast me mendjelehtësinë që krijon.

— A më lejoni t'ju bëj një kompliment, zonjë? — thotë Johana, dhe unë ndiej shakanë.

Baronesha bëhet gati të dëgjojë.

— Jeni si shkumë deti!

— Ah!

Kjo e kënaq pa masë. Qesh e kukuriset në nota të larta, ngrihet e puth Johanën dhe vjen vërdallë e zhurmshëm nëpër shtëpi.

Pastaj bëhet gati të ikë.

— Do të vij përsëri që t'ju qetësoj, — thotë ajo duke zbritur shkallët, gazmore, sikur t'i ishte kthyer rinia e humbur. Shpeshherë mjafton vetëm një fjalë. — Sidoqoftë unë po jua përsëris se dyert e kështjellës sime i keni të hapura. Atë kështjellë e kam trashëgim nga gjyshja dhe gjyshja ka qenë mikeshë e Götes...

Ajo ikën, unë mbyll derën dhe mbështem pas saj duke pshëretirë.

— Iku, — them i lehtësuar dhe Johana më sheh në sy. Ngrin në shkallë, me një ravijëzim të lehtë trishtimi në rrudhat ndanësyve. Ajo nuk e di në e kam me tërë mend keqardhjen apo jo.

— U mërzite? — më pyet, dhe mua më vjen keq që iu zbeh gjëzimi i atij çasti që ndjeu pak më parë.

I shkoj pranë dhe i hedh dorën në sup.

— C'flet kështu, Johanë? C'është një baroneshë para një dashurie të thjeshtë, të pastër? C'është një mbret përpara njeriut të

ndershëm e të thjeshtë, që ajo thërrime buke që ha i bëhet shëndet se e ka gatuar me djersën dhe gjakun e vet? Mua më ka qëlluar të luaj kaq shumë kontër, princër, mbretër, baronë. Kështu që mund të them se më takon, bile e kam edhe unë një titull fisnikërie.

Ngjit shkallët bashkë me të i përqafuar dhe ajo nuk e merr vesh se përse duhen gjithë këto fjalë për të thënë fare thjesht me heshtje se sa shumë e dua. Por, me sa duket, mosha na detyron të thérresim në ndihmë fjalët.

— Ti nuk e di, Johanë, se sa keq e ndien veten njeriu i ndershëm atje në fron. Ti nuk e di se kurora e mbretërve vërtet është e bukur, por ama ta shtrëngon kokën deri në dhembje, ti nuk e di se sa false i kanë fjalët e dashurisë ata. Një dashuri mbretëreshë, baroneshe, apo dreqi e di se çfarë, qoftë edhe e një bije industrialisti apo e një gualitieri nuk mund të barazohet kurrë me dashurinë e një Johane të thjeshtë, që qan nga mallëngjimi kur sheh se i dashuri i saj është i lumtur, që i rreh zemra me frikë, me mall e dashuri e tmerr njësoj si zemra e të dashurit të saj, me dashurinë e Johanës sime të thjeshtë që gjendet gjithmonë pranë për të mbajtur në këmbë jetën time. Asgjë, Johanë, asgjë nuk barazohet me dashurinë e vërtetë pa tituj e ndere!

Ajo mbështet kokën fort në gjoksin tim dhe të dy ndalojmë në krye të shkallëve në një përqafim të gjatë. Unë ngre fytyrën e saj dhe shoh se ajo është e përlotur. Në sytë e lëngshëm pasqyrohet tërë xixëllimi i shandanëve, ku treten qirinj gjysmë të shkrirë.

Pulitja e lehtë e qepallave ka diçka të ngjashme me rënien e butë e të ngadaltë të perdeve prej kadifeje të kuqe të thellë në skenën e teatrit, ku porsa ndodhi diçka e thjeshtë, e paharruar, e madhërishme.

Nuk e kam të vështirë të bisedoj me Johanën, vetëm se e ndiej veten herë-herë si fajtor përparrë saj. Ndoshta, po të mos ishte njojur me mua, ajo do të kishte pasur një fat tjetër. Sikur atë ditë maji, që ne u njo'hëm, ta kishte vrarë këpuca dhe të mos kishte ardhur në shfaqje, unë do të largohesha nga qyteti i saj përjetë dhe s'kishte ku të më takonte më. Po njeriu është i lidhur me rrëthanat në një martesë «a la italiane» pa të drejtë divorci. Mundet që ajo do të kishte ndërtuar një jetë më të qetë dhe me më pak mundime, por ama, në qoftë se vërtet shqetësimet do t'i kishte pasur më të pakta, në të njëjtën kohë nuk do të kishte provuar as gjëzimet madhështore, kaq të magjishme dhe kaq misterioze e kaq të largëta për shumë të tjerë, si planetë të parritshëm.

Qëndroj në dhomën e Karlit dhe mendoj se jeta ime ka filluar të vërtitet midis pak njerëzve. Megjithatë, prapë është diçka më shumë se kjo që bën Karli. Ai nuk del fare nga shtëpia, Brynerin e ka hedhur në gjyq për fyterje publike. Unë e siguroj se do të dëshmoj siç duhet. Data e gjyqit ende nuk është caktuar.

Dhoma bie erë librash të vjetër. Raftet janë të mbushura plot dhe unë zgjatem të kap njërin prej tyre. Është një tekst i vjetër shkollor për historinë e Gjermanisë.

Në faqen e parë lexoj emrin e Karlit, të shkruar kushedi se sa vite të shkuara, kur ishte ende fëmijë, me uniformën e shkollës e kokën e qethur dhe me... Në çast hapet me rrëmbim dera e hyn Alfredi. Ai mezi merr frymë dhe në drithërimën e zërit midis dy frymëmarrjeve të thella përpinqemi të kapim fjalët.

- Frici... Liza...
- Cfarë?
- Fricin me Lizën... Do t'i gjejnë!
- Ku kështu?
- Te librat.
- Fol më qartë!
- Ata po djegin librat.

— Më mirë pi një gotë ujë, pastaj fol siç është për të folur. — i them unë, por ai ndërkohe e ka mbledhur **veten**, më kap përmëngë dhe më tërheq drejt derës.

— Eja, — më thotë, — ata janë fshe-hur në bibliotekën e teatrit dhe djemtë me pishtarë kanë ardhur të dëjegin librat.

Unë tmerrohem nga këto fjalë. Karli vërsulet me ulërimë mbi çarçafët e bardhë të shpupurisur të shtratatit të vet dhe fillon të dënesë me gulçim.

Alfredi zurret i pari shkallët dhe unë e ndjek nga pas. Ecim me nxitim. Nuk nxitojmë, vrapijmë. Njerëzit, shtëpitë, tramvajet, pemët, ndërtesat e vjetra, retë, të gjitha bashkë i shoh si një njollë të madhe, një përzierje ngjyrash, nga e cila të merrën mendtë.

Dikush më kap për krahu dhe më ndalon vrapin. Është Shtritmajeri.

— Si të duket një tablo për këtë ngjarje?... — Unë vazhdoj rrugën e ai ecën i kthyer me shpinë nga rruga që bën dhe më shikon me ngulm në sy. — «Flaka e klasikëve». Klasikët janë djegur një herë kur kanë vdekur. Imagjino se çfarë ngjyre mund të ketë hiri i tyre.

Unë e largoj me forcë atë se më ka zë-në rrugën dhe ndjek nga pas Alfredin. Dy dijem të veshur me këmishë të murrme na ndalojnë. Krahët e tyre të fuqishëm na kujtojnë trarët e postbllokut, ndonëse këmi-shët nuk i kanë me vija të bardha.

Në mes të sheshit është ndezur një flakë e madhe. Një djalë i ri lexon duke u ngër-

dheshur një listë të gjatë. Thirrjen e çdo emri e pason një ulërimë e zgjatur.

— Karl Marks!

— Uuuuu!

— Bertold Breht!

— Aaaa!

— Erih Maria Remark!

— Auu...

— Emil Zola!

— Balzak!

Mua më kujtohet se Bryneri njëherë më pati përmendur gjuetinë e shtrigave.

Librat, togje-togje, i japin zjarrit shpërthime të reja. Gjuhët e flakëve lëpijnë qieillin dhe kafshojnë pllakat e murme të sheshit.

— Unë protestoj! — bërtas.

Por nuk më dëgjon askush. Bindem se kjo botë është e shurdhët. Të flasësh njerezisht, është njësoj sikur të ngrihesh nga një gjumë letargjik dhe të të marrin për të përcartur. Më duket sikur realisht në rrugë jetoj nië kohë tjetër nga ç'ndiej në shpirtin tim. Këto dy kohë përplasen e thyejnë me rrapëllimë gjithçka gjejnë, bindjet, ndjesitë e arsyetimin.

— Ata! — thotë Alfredi dhe kafshon fort gishtat e duarve.

Unë shoh se si nxjerrin nga ndërtesa e rëndë e teatrit, përmes dyerve prej dru ahu, të shpërthyera në të dy kanatet, Fricin dhe Lizën.

I shoh se si zbresin ngadalë shkallët e mermerta, të përqafuar fort me njëri-tjetrin, si për të kërkuar një mbështetje në këtë ditë të ngatërruar.

— Ej, djema! — bërtet njëri nga këmi-shëmurrmit. Ai i ka dhëmbët të krimbur, apo ndoshta kështu më duket mua. — Këta janë çifutë!

— Unë kujtoja se ishin personazhe dramash klasike, — thotë duke qeshur ai që lexonte listën e librave të ndaluar.

— Janë Romeo e Zhuljeta të plakur! — ulërin përsëri ai i pari dhe shpërthen në të qeshura histerike.

— Romeo dhe Zhuljeta në zjarr!

— Në zjarr!

— Rroftë shpirti i ri, poshtë shpirti klasik!

Nuk mund të duroj dot më. Përpinqem tē çaj atë postbllok prej mishi tē bardhë, por më flakin tutje. Alfredi vjen vërdallë si një ujk dhe gulçon.

— Ndaluni, — bërtas unë, por përsëri më flakin tej, më përplasin fort pas murit. Nga goditja bie në gjunjë, pastaj e marr veten menjëherë dhe vërsulem përsëri. — Ndaluni!

— Është e kotë, — më thotë dikush.

— Lérini simpatitë personale për albumet familjare. Në sheshe shpalosni simpatitë e kombit.

Dhe më hedh dorën në qafë, si për të më mbrojtur. Nuk qenka i panjohur. Eshtë Shtritmajeri, të cilin unë përsëri e flak me përbuzje dhe me tërbim.

Rreth e qark zjarrit është bërë një grumbull i madh njerëzish. Përmes kokave, që më ndërpresin herë pas here pamjen, shoh Fricin me Lizën. Ata qëndrojnë me sytë ngulur te njëri-tjetri sikur asgjë të mos ekzistojë në këtë botë, përveç asaj që lexojnë atje, thellë tyre. Është një tekst i lashtë, edhe më i lashtë se vetë gjuha. Fytyrat e tyre janë të bukura e të qeta, jashtëzakonisht të qeta, sikur t'u ketë rënë nuri i një vdekjeje që e prisnin prej kohësh me ankth.

Njëri nga djemtë qëllon me automatik dhe ata të dy, të përqafuar, bien ndanë flakëve. Pastaj njëri nga djemtë sjell një tok librash, unë gjithçka e shoh përmes lotëve, flakët ripërtërihen kësaj radhe duke brambullitur.

Unë zë fytyrën me duar.

Pranë meje Alfredi qan me gulçe.

Ditët janë të gjata dhe të mërzitshme. Jam kurdoherë në pritje. Në konsullatën shqiptare në Vienë më priten mirë, por nuk e di përsë përgjigjja ime po vonon. Thonë se ka vështirësi komunikacioni. Kam filluar ta përfytyroj si një udhëtim romantik vajtjen time në Shqipëri.

Është një sezon pushimi. I prisha të gjitha planet. Prej kësaj edhe ditët më duken tmerrësish të gjata e të mërzitshme. Qëndroj herë pas here në studio dhe shoh rrangullinat e roleve: mantelet, parzmoret, kaskat, heshtat. Ndiej nostalги për t'i veshur e për t'i marrë nëpër duar. I përkëdhel plot mall dhe ndihem disi më mirë, edhe pse nëpër gishta më mbetet herë-herë pluhur.

Ka ardhur dimri dhe në rrugë drurët janë krejt të zhveshur. Përballë dritares si me është një bli që të kujton Rosinantin kockë e lëkurë, por që qëndron, si kuajt e cirkut, me këmbët përpjetë. Herë-herë ai duket sikur vallëzon vals nën ritmin e erës.

ANTRAKT

Dekori: Shqipëri e vitiit 1933

«Dikur, midis dy pjesëve të një drame, dilnin në paraskenë aktorët dhe luanin ndonjë komedi, — mendoi Mistoja, ndërsa nuk e mbante dot të qeshurën. — A thua vërtet të jem duke jetuar një antrakt gazmor?»

Kjo lidhëj edhe me mallin që ndiente për qytetin e lindjes, por, mbi të gjitha, me këtë njeri që i qëndronte përballë dhe i tregonte gjëra që e bënин të shkulej gazit. Ishte një burrë i shkurtër dhe i imët, me një fytyrë serioze dhe tepër të zymtë, me nofullat si dy copa gurësh majëmprehtë ndanë humbëtirës së gropave të faqeve të tij të fishkura. Kur Mistoja e kishte pyetur se si quhej, ai i ishte përgjigjur shkurt: «Njeriu i një mijë barceletave!»

Mistoja kishte qeshur dhe e kishte ngacmuar më tej, pastaj ai kishte nisur pa pushim t'i tregonte lloj-lloj ndodhish të jetës

së tij, që tingëllonin mjaft argëtues për atë pamje të mjeruar që zbulonte fytyra.

— Ke dëgjuar ndonjëherë barceleta që fillojnë «Ishte njëherë një shqiptar që shkoi në Amerikë...?» Ai jam unë!

Një herë ai i tregonte se, kur shkoi në Amerikë, «do të hante, do të merrte dhe do të ikte», siç thotë A-mer-ik! Një herë tjetër se si njoihu një shqiptar nën këmbët e një ure në një rrethanë krejt komike dhe banale, një herë tjetër...

Mistoja kishte tre vjet jashtë shtetit, në një shkollë muzike, pranë një profesori të dëgjuar të violinës, por nuk kishte jetuar dot kaq shumë gjëra të bukura dhe interesante, ndaj e pati zili.

Gati tërë udhëtimin e kaluan së bashku dhe, po të mos ishte ai me ato historitë e tij plot humor, Miston me siguri do ta kishte zënë deti.

Në çastin kur qëndronte mbështetur në parmakët e anijes dhe vuri re për herë të parë pulëbardhat, që donte të thoshte se toka ishte afër, ai ndjeu keqardhjen që udhëtimi do të mbaronte shpejt dhe do t'i duhej të ndahej nga ky njeri që e kishte bërë përvete me atë shpirt të çiltër e të gëzuar, në kundërshtim me vështrimin e tij melankolik dhe pamjen e vrerosur.

«Një kujtim të zgjon gjithçka të trish-

tuar, kurse një njeri i gjallë të bën t'i harrosh të gjitha», mendoi Mistoja dhe e ngushëlloi veten se, sidoqoftë, edhe në tokë e priste ndonjë gjë interesante. Sapo të mbërrinte, do të nxitonte të takohej me princeshën padrone të artit dhe të përcillte atë mesazhin e konsullatës së Vienës, që t'i jepjet shtetësia shqiptare një artisti me famë botërore.

«Nuk është pak, apo jo?» — i tha vetes duke ndier krenari.

Sapo dolën në sheshin e boshatisur të skelës së Durrësit, Mistoja i bëri me shenjë një karrocieri dhe pranë u ndaloi një pajton i pastër dhe i shtruar me shilte, me kuaj të zbukuruar me fiongo të kuqe e të gjelbra dhe me një zilkë që bënte një zhurmë të ëmbël e të bukur.

Mistoja do të donte që edhe këtë copë udhë ta bënin bashkë, po tjetri i zgjati dorën dhe i tha se do të qëndronte pak në Durrës, pastaj «... kësмет! Ka zoti për të gjithë!»

Mistoja e përqafroi fort dhe deshi t'i thoshte se do ta merrte malli për atë njeri, që nuk e kuptonte se si e kishte bërë përvete aq lehtë, por mundi vetëm ta falënderonte dhe t'i shprehte zilinë për kaq shumë gjëra të bukura që kishte jetuar.

Tjetri nënqeshi, tundi lehtë kokën dhe i tha se ato që kishte jetuar, kishin qenë

gjëra shumë të trishtuara, vuajtje dhe mundime të dhimbshme, por ai i tregonte si barceleta, që ta kishte vetë më të lehtë për t'i përballuar dhe për të besuar se, sidoqoftë, janë diçka e gjëzueshme, pérderisa, në fund të fundit, nuk janë gjë tjetër përveçse jeta e tij.

«Madje edhe në qoftë se vdes, dije që edhe vdekjen time do të lë amanet të matregojnë si barceletë!» — tha ai, e përqafot fort dhe iku pa e kthyer kokën pas.

Mistoja e ndoqi me sy për pak çaste dhe, kur shihte se si largohej ai trup i vogël dhe i tharë si një trung i mbetur cung nga rrufeja, gjithmonë e më tepër besonte se ai vërtet nuk kishte jetuar ndonjë gjë të gjëzueshme, por gjithë ç'tregonte, ishte një mënyrë për të mbajtur veten gjallë. Në çastet e rënda të humbjes, ishte e qartë, ai e flakte tej trishtimin, ashtu si astronautët flakin thasët me rërë për t'u ngjitur më lart drejt qiellit, që thonë se përtej reve është krejt i kaltër.

Më vonë, ~~në~~bështjellë me pallto, i struktur në karrocerinë e pajtonit, me një bataniye te këmbët, duke dëgjuar muzikën e ëmbël që bënин zilkat dhe potkonjtë, Mistoja mendoi se sidoqoftë jeta është e bukur. Paçka se ka dhembje dhe trishtime, midis dy humbjeve është gjithmonë një çast i fi-

tuar ngajeta, që shpeshherë merr më tepër vlerë prej kësaj, ashtu si dita me diell midis dy ditëve të murrëtyera me shi.

Shokët e fëmijërisë ia rikthyen trishtimin. Ndonjëri nga ata nuk ia kurseu qësënditë, ndërsa nëna pati turp të dilte në rrugë bashkë me të, vetëm se qëndroi nga pas dhe e soditi e kënaqur ecjen e tij të lehtë si prej «zotërie të vërtetë». Te porta e pallatit mbretëror nuk i nxorën pengesa. Ai, i shoqëruar nga një maxhordom, përshkoi një rruginë mes përmes parkut të mbajtur mjaft mirë, edhe pse ishte dimër. U ul në njérën nga verandat e zbukuruara me luledhëkëza dhe stilizime druri. Ishte një mjedis i qetë dhe tepër i përshtatshëm për të luajtur pjesën që kishte zgjedhur ai, simfoninë numër 42 të Moxartit.

Mistoja hapi kutinë e violinës dhe nisi të bënte disa ushtrime pa u sforuar Maxhordomi i qëndroi përballë, por, me të ardhur princesha, u zhduk i trembur dhe i përulur, duke hyrë me shpinë në pallatin e madh e të heshtur.

Princesha ishte shumë e gjëzuar, me gjithëse bisedën e nisi me ankimin se i dhimbte shumë këmba që kishte ndrydhur në gjueti tri ditë më parë.

Mistoja qëndroi përmes pak çaste i përku-

lur, iu afrua, i puthi dorën me mirësjellje dhe e pyeti nëse në shenjë mirënjojheje dëshironte të dëgjonte ndonjë gjë të luajtur prej tij.

— Sigurisht, — u përgjigj ajo dhe iu ul përballë, atje ku kishte qëndruar pak më parë maxhordomi. Mistoja vuri re se ajo ishte e hijshme dhe shkonte bukur me tërë atë sfond dredhkëzash elegante, që nga flladi fërgëllonin si krahë fluturash. — Por, përpara së gjithash, desha të them se kërkesa për të marrë nënshëtësinë shqiptare artisti për të cilin interesohesh ti, u aprovua.

— Vërtet?! — gati sa nuk bërtiti Mistoja dhe e ndjeu veten të ngazëlyer, s'gjeti fjalë të tjera për të shprehur mirënjojen. «Ky paska qenë një udhëtim shumë, shumë i gëzuar. Udhëtim i gëzuar në palcën e dimrit!»

— Mbreti është dakord! Posta zyrtare u nis që sot!

— Oh, zonjëzë, ju po më detyroni që t'ju puth dorën në emër të tij! — tha Mistoja dhe u ul sërisht në gjunjë, tepër i vëmendshëm, që të mos i ndoteshin pantallonat e zeza.

— Pa më thuaj. — vazhdoi princesha duke e ndihmuar të ngrihej sërisht në këmbë. — A është ndopak fisnik ky artist?

— Doni të thoni...

— Dua tē di se sa i famshëm është. Ti besoj e di që vlera e një oborri varet shumë edhe nga artistët që mbahen në tē.

— Atë e njojin në tē gjithë botën, — tha Mistoja, sa pér tē dhënë një përgjigje.

— Dhe kushdo do ta kishte pér nder...

— Po tē mos ishte interesimi im...

— Nuk dysho... Ju jeni pér artin sic është Diana pér pyjet.

— Ah, mos më kujto gjuetinë. Është pasioni im i tmerrshëm. Do tē na luash, më në fund, ndonjë gjë?

Mistoja mori në dorë violinën, ngriti harkun, priti pak çaste, pastaj e uli lehtë mbi tela, aq lehtë, sa c'do tē ulej edhe vëtë era. Nisi tē luante me aq përkujdesje dhe dashuri, sa ato çaste do tē donte tē kishte pranë profesorin e vet tē muzikës.

Princesha e dëgjoi me përzemërsi, me një buzëqeshje tē ëmbël në fytyrë, që harmonizohej aq bukur me jakën e purpurt të fustanit tē saj prej mëndafshi. Pastaj buzëqeshja pér pak çaste qëndroi si e ngrirë dhe e harruar, ashtu sic mbetet ndonjëherë hëna në qìll kur ka zbardhur dita. Kjo zgjati fare pak kohë, sepse përnjëherë gjithçka u shua. Ajo lëvizi dhe u ngërdhesh nga dhembja që i shkaktoi këmba e ndrydhur.

— Mirë, mjaft me këto! — tha. — Unë sot jam e mërzitur. Kam kaq ditë që nuk

dal nga shtëpia, ndaj dúa të më luash diçka
të gëzueshme.

Mistos nuk i pëlqeu që ajo e ndërpreu,
por sidoqoftë ajo kishte njëfarë të drejte të
zgjidhte pjesën që i pëlqente.

— Dëshironi ndonjë gjë tjetër nga Mo-
xarti? — pyeti ai me delikatesë, por ajo
bëri një gjest nënvleftësimi.

— Jo, jo, asnje nga këto avaze «viu
viu». Më mërzitin dhe nuk i dëgjoj dot deri
në fund. Dua diçka të gëzueshme. Për she-
mbull ndonjë gjë cigane.

Mistoja mendoi njëherë të luante diçka
nga Bramsi, por, sa po filloj, ajo përsëri e
ndërpreu, kësaj radhe e nervozuar.

— Nuk merr vesh? Kërkon të më shtosh
dhembjen e kokës? Në djall me gjithë atë
violinë!

Dhe u ngrit të ikte. Mistoja e ndjeu
veten të fyter. I shkoi nga pas dhe me një
zë prej fajtori u përpoq të merrej vesh me
të.

— Më falni, zonjë, por unë...

— Ti je një hic! — bërtiti ajo duke he-
qur dorë nga mëshira. Kishte zë të hollë
dhe therës, që të kuitonte fshikullimën e
kamxhikut. — C'dreqin e mban atë qemane
në dorë, kur nuk mund të më argëtosh dot
mua? Më mirë thyeje! Po, po! Thyeje!

Dhe u largua çalë-çalë.

Mistoja ngriu në këmbë. Ende nuk e kishte marrë veten nga ajo që kishte ngjarrë, vetëm se në vesh i ushtonin ato fjalë të tmerrshme, që ia kishin prishur ekui-librin. «Thyeje!». Qëndroi për pak çaste me vështrimin të mbërthyer nga dera që gëlltiti princeshën. Sa po matej të kthehej, krejt i nemitur pa se si u hap një derë përsëri dhe u shfaq figura e maxhordomit me fytyrë tepër të pikëlluar dhe qesharake, nënvizuar nga ngjyra e verdhë e praruar e uniformës së tij.

— Hajde tani, ik! — tha ai dhe Mistoja bëri disa hapa si i trulloSUR, duke këruar rruginën që të conte te porta e daljes. Ato çaste i dukej sikur po jetonte një èndërr të pashpjegueshme, plot me kontraste.

Më vonë këtë skenë Mistoja e përfytyronte në dy mënyra.

Përfytyrimi tragjik: I tronditur nga pamja që pa, ai thyente violinën. E mbështeste fort te gjuri. Ajo ndahej më dysh me kërcitje të thata, ndërsa telat, tek këputeshin, lëshonin piskama të lehta, si njerëz që i mbytnin në gjumë. Pastaj Mistoja, i mbetur pa violinën, pra, pasi kishte braktisur pasionin e tij të dashur, shkonte drejt detit të madh e të shkumëzuar, i bindur t'i jepte fund jetës tashmë të pakuptimtë. Para se të mbytej, i thoshte disa fjalë atij artistit të shquar, që kishte bërë plane të

vinte në Shqipëri. Fjalë plot zemërim. Po të donte, le të mos i dëgjonte.

Përfytyrimi komik: Ai luante me violinë repertorin e vet më të zgjedhur. Princesha, ndërsa e dëgjonte, vente e vinte vërdallë nëpër dhomë e mërzitur. Ngaqë nuk mund t'i kuptione dot tingujt e tij, ajo vinte jastëkë në veshë, jastëkë të mëdhenj, nga të cilët dilnin pupla shpendësh. Ai vazhdonte të luante dhe ajo iku larg, u zhduk thellë e më thellë nëpër pyje, hipur mbi një kalë. Zogjtë, si për inat, e shoqëronin me cicërima ikjen e saj të tërbuar nëpër pyll. Ai vazhdonte të luante e dhjetëra njerëz e futnin në mes dhe qeshnin e argëtoheshin bashkë me të, ndërsa princesha ikte larg, larg, derisa u bë një pikë e vogël në hapësirë.

Të dy këto variante atij i dukeshin njësoj të besueshme dhe njësoj të justifikuara brenda vetes. Ngaqë nuk ishte i zoti të nxirrte një barceletë të gëzueshme për këtë që ngjau, ai i përfytyronte në baraspeshim.

— C'është kjo muzikë? — tha mbreti dhe nisi të vallëzonte.

— C'është kjo këngë? — tha princesha dhe hipi mbi kalë.

— Janë zorrët e mia, — tha i urituri,
— këndoja!

Ai që tregoi këtë barceletë, qeshi vetë i

pari ëdhe Mistoja pas tij. Pastaj Mistoja e mendoi thellë domethënien e kësaj barceleste dhe iu duk sikur ishte aty e tërë historia që porsa i kishte ngjarë dhe ajo ikje kërcënuese e princeshës, që, në fund të fundit, do të thoshte këngë e zorrëve të tij.

«Ndoshta kjo këngë do të të kënaqte më shumë», qeshi ai me vete, se iu duk se barceleta u krijua. Ishte një bracelet e hidhur, por e vërtetë, që e bënte të ndihej më i barabartë me atë shokun e tij të fëmijërisë, që e përcolli deri në skelë dhe që nuk pushonte së qeshuri. Mistos nuk i vinte aspak turp që ai ishte veshur me rroba të vjetra, me një xhaketë të ngrënë te bërrylat dhe një këmishë të pahekurosur, ndaj dhe i hodhi dorën në qafë.

Ai tregoi përsëri një histori tjetër, po kësaj radhe jo barceletë. Ishte një ngjarje në parlament, përsëri qesharake. Tërë ato ditë, ndoshta dhe pse ishte Viti i Ri dhe një rëzit harxhonin në këto ditë gjithë gëzimin e kursyer nga viti që kishte ikur, ndoshta duke hyrë edhe në borxh në gëzimin e vitit që vinte, ai kishte dëgjuar shumë historira gazmore. Mistoja nuk u çudit që shumë prej tyre kishin të bënин me mbretin.

— Është lolo, lolo i vërtetë! — i kishte thënë nën zë ky shok i fëmijërisë, që e përcolli në skelë, e përqafroi fort në ndarje dhe

e ruajti me kujdesin më të madh, derisa kaloi doganën dhe hipi në vapor i qetë, që askush nuk ia gjeti atë letër që duhej të hidhte në të parën kuti postale që do të gjente për ta nisur në redaksinë e gazetës «Liria Kombëtare» në Zvicër.

Mistoja e përshëndeti gjatë nga kuverta e vaporit, derisa ai u zhduk dhe u bë një me qytetin. Pastaj qëndroi duke soditur, derisa qyteti u tret e u bë një me reliefin e kodrës që kishte mbi të, dhe feneri humbi përtej kaltërsisë së pafund.

Duke vajtur për në kabinën e tij, ai nuk dinte se si ta quante tërë këtë udhëtim, gazzo mor apo të trishtuar.

«Ndoshta jeta asnjëherë nuk i ndan këto gjëra,» tha dhe hapi sytë mos gjente ndonjë fytyrë të njojur.

Sidoqoftë, atë artistin e madh e përfytyronte vetëm në variante tragjike.

AKTI I DYTE

Dekori: Po ai i aktit të parë, vetëm se në rrugët e Gjermanisë janë shtuar dekoracionet e nazistëve dhe lëvizja e kalimtarëve është bërë më e rrallë. Edhe ata të paktë ecin më të trembur.

Mbreti Lir.

Tani që nuk luaj më, më duket vetja si një mbret pa mbretëri, sikur i kam humbur të gjitha, në një plangprishje të madhë.

— Kam dhënë dashuri të pamerrituar!

Zbuloj këtë gjë dhe ndiej një zhgënjim të llahtarshëm, që më bën, për pak, t'i bie kokës me grushte, ose ta përplas fort pas murit, aq fort, sa të vij në vete.

Herë-herë e mbledh veten dhe them se kjo nuk është gjë tjeter veçse një pamje e rrreme që krijon mendja ime e nxehjtë dhe zemra që rreh e çakorduar. Por, po të ishte kështu, në gazetë nuk do të kishte mbetur asgjë, ashtu siç nuk mbetet dot në fil-

min fotografik asgjë nga hipnoza dhe sugjestionë.

E gris njérën nga gazetat e sotme: Në të më fyejnë hapur dhe unë jam i detyruar vetëm të hungëroj me vete, i ngujuar në shtëpinë time. Johana këmbëngul që të mos i lexoj gazetat, por nuk e dëgjoj. Dua të mbushem aq shumë me fyere e poshtërimë, sa të mundem pastaj të duroj gjithçka dhejeta e përditshme të më duket e lehtë, gazmore, me ngjyra të çelura operete, ashtu siç mësoheshin dikur me helmin sulltanët e Turqisë.

Në njérën nga gazetat është botuar edhe fotografia ime. Në të dukem shumë i butë dhe paqësor dhe më vjen inat për këtë. Do të desha të mos e kisha bërë kurrë atë fotografi. E gris gazetën dhe shkoj e myllem në dhomën time.

Ulem në kanape, ndez radion, gjej muzikën që më pëlcen dhe dremit.

Ngaqë ditët e mia kanë fare pak veprim, meditoj shumë, aq shumë, sa shpeshherë më myt një melankoli e bezdisshme, si shiu aë s'pushon për ditë dhe net të tëra, aë përmbyt gjithçka. Asnjëherë nuk kam menduar për veten time kaq gjatë dhe mërzitshëm, njësoi si për nië rol të zakonshëm, i distancuar dhe i ftohtë, duke kundruar gjithçka nga një finale që dihet. Për fat të keq, nuk i gjej vetes asnjë gabim, për-

veç faktit që kam dhënë në jetë më shumë nga ç'kam marrë prej saj, gjë që, në fund të fundit, më përkëdhel sedrën.

Ndonjëherë përfytyroj se çfarë do të bëhej me mua po të kisha pranuar ftesën e Brynerit dhe të zonjës Kesler. Ndoshta do të isha bërë si ai H i neveritshëm që luajti Mefistofelin për herë të dytë. Për herë të parë Fausti kam qenë unë. Ishte një Mefistofel interesant. Në figurën e djallit ai kishte treguar gjithçka të errët e tinëzare që kishtejeta. Për herë të dytë ai e luajti Mefistofelin këto ditë dhe përpiquej të thoshte se djalli janë komunistët. Diçka ishte shtuar trashë edhe në tekst. Në fund të shfaqjes, H-së i dhënë një dekoratë. Pëshpëritez se mund të bëhej edhe me përgjegjësi shtetërore. Nuk e besoj, por, po të jetë e vërtetë, nuk më bën përshtypje. Si nuk më bën përshtypje Shtritmajeri, që, duke rendur me rrapëllimë, ndjek shkatërrimin. Edhe ai është i paracaktuar të ikë, bashkë me rrëmujën, ashtu siç merr me vete një ndërtësë që shembet njerëzit që ka brenda. Ndoshta, po të isha fillestar, mund të më gjenjenin modat dhe izmat, megjithëse asnjëherë nuk e kam ndier veten aq të paaftë sa të rend pas tyre. Një ditë dëgjova një kolegun tim që recitonë në radio. Ishte një tekst i dobët, i zvargët, pranë vargëzimit, një histori vulgare pa asnjë domethënje.

Sado që ai përpinqej ta recitonte bukur dhe madhërisht, asgjë nuk ndryshonte, bile prej kësaj vargjet dukeshin edhe më pa vlerë, ndërsa ai, i humbur, si motorët e vjetër të anijeve, që harxhojnë shumë qymyr për të lëvizur fare pak nga vendi.

Vë re se kolltukët e shtëpisë sime janë vjetruar dhe kanë krijuar gunga të vogla. Edhe njëra faqe muri ka disa njolla lagëشتire që nuk kam mundur t'i vë re më parë, sepse kam ndenjur fare pak aty.

Troket dera.

Është Alfredi. Ai vjen çdo mëngjes e më pyet nëse ka ndonjë lajm. Unë i përgjigjemi: «Jo», dhe nuk jam në gjendje t'i them ndonjë gjë të gëzuar për të mos e lënë edhe atë të trishtuar. Alfredi ka dëshirë të më flasë. Ai kohët e fundit merr pjesë në disa mbledhje punëtorësh, një herë bile është rrahur me të policisë, por unë nuk mund ta dëgjoj. Edhe ai e kupton që kërkesa ime për të ikur në Shqipëri, në fund të fundit, nuk është mërgim, po kthim.

Alfredi rrufit në heshtje, përballë meje, tasin e kafes që sjell Johana. E pyes për Karlin.

Karli nuk i ka punët mirë. Alfredi thotë se atij ia shtynë përsëri datën e gjyqit kundër Brynerit, sepse do të hapej një proces i madh kundër disa punëtorëve dhe komunistëve. Është hera e tretë. Duket sikur do

të jetë një shtyrje pa fund. Sepse të pafund do të jenë edhe këto antagonizma sociale, shton Alfredi.

Kur Alfredi ngrihet për të ikur, unë i them të ruhet. Manikota që ka pasur nga ajo rrahja në polici është hequr dhe ka lënë në mollëzën e djathtë një vijë të lehtë, si një varr në mes të një kodre të rreshkur ku balta porsa është përtharë. Ai ikën duke murmuritur nëpër dhëmbë dhe unë mbetem përsëri vetëm.

Johana kthehet të marrë taset e kafes dhe ulet për pak çaste përballë meje e heshtur dhe e menduar. Unë e di që ajo shumë gjëra nuk i mendon si unë. Arsyjeja e saj do t'i ndërtonte ndryshe dhe për pasonjë edhe ngjarjet kishin për të rrjedhur ndryshe. Por për një gjë jam krejt i sigurt, ajo ndien njëlloj si unë. Kjo më krijon një ngazëllim të shkurtër që më bën t'i afrohem dhe në heshtje t'i përkëdhel flokët. Pastaj kjo zgjat më shumë se ç'e ndiej dhe bëhet monotone dhe bajate. Johana e merr vesh këtë gjë, ngrihet, merr taset e kafes në dorë, ikën dhe, duke mbyllur derën lehtë, më hedh edhe një vështrim të fundit. Në sytë e saj spikat një buzëqeshje që nuk është shuar.

Unë ulem përsëri dhe mbështet kokën mbi duar, bërrylat i ngjesh fort në anët e kolltukut prej meshini. Filloj të mendoj.

Kështu deri vonë, kur shuhet dita. Kështu disa ditë me radhë.

Si mund të quhet ditë kjo, kur nuk ndodh asgjë?

Letra e baroneshës më vjen ende pa zbardhur dita. Më përsërit të njëjtën ftesë. Vendos t'i përgjigjem. Thérres edhe Johanna dhe qeshim për pak caste.

Në kështjellën time do ta ndiesh veten shumë mirë...

— I thuaj se, që ditën kur u veshe për herë të parë si mbret, ke frikë të ecësh vëtëm nëpër korridore kështjellash, prandaj do të të shoqëroj unë! — më thotë Johana. Qeshim me të madhe. E më shumë se me fjalët qeshim nga nevoja për të shkundur atë plogështi dhe zymti që na ka mbështjellë shpirtin si pezhishkë e zezë merimange.

— Do t'i them që dyerve të kështjellës t'u vërë nga një lloz të rëndë dhe të mos presë të trokasin netve nga shtegtarë të trembur. Sikur të ishin të gjitha kështjellat me dyer të hapura, atëherë nuk do të ishin vrarë kaq shumë njerëz në dyert e tyre...

Përsëri qeshim e ndoshta do të vazhdojmë të qeshim tërë ditën, po të mos vijë posta e ditës bashkë me gazetat. Johana vrapon t'i marrë e para, për të hequr ç'të mundet nga gjërat që më prishin humorin.

Unë bëj sikur nuk e vë re. Ul sytë mbi letrën e baroneshës dhe e lexoj kushedi për të satën herë. Johana ndihet e kënaqur sepse gazetat, më në fund, më kanë harruar dhe i del nga mendja se unë gjithmonë e kam pasur tmerr harrimin; më mirë të të shajnë, se sa të mos të vënë re. Kështu ndihem i tërbuar dhe i shqyhej gazetat njëloj sikur të kenë thënë gjérat më të përbindshme për mua

E ndiej që këto janë shenja dobësie dhe përpinqem të mbledh veten, kur Johana klith e gëzuar: — Erdhi! Erdhi! — Dhe vjen drejt meje me vrap, e lehtë si vesa, duke ngritur lart një zarf të bardhë:

— Letra nga mbreti!

Unë matem ta hap, duart më dridhen nga emociioni, por Johana më thotë që ta pres për pak çaste. Ajo kërkon të më bëjë një surprizë.

Duke pritur atë, sodit zarin: Është hera e parë që marr një letër nga «një mbret», edhe pse në skenë kam marrë aq shumë mesazhe, kuptohet, nuk kanë qenë të vërteta. Ndonjëherë kanë qenë letra porosish, ndonjëherë letra të thjeshta ambalazhi, herë-herë fletë të bardha, të pashkruara, në ndonjë rast letra ku ndonjë partner i huttuar, i porsarënë në dashuri, ka shkruar adresën e vajzës që i ka grabitur zemrën. Dhe ja një letër nga mbreti, që qenka fare e zakonshme. Vetëm se mban një vullë të

çuditshme. Se pse përfytyroj dorën e zgjatur të një mbreti të vërtetë.

Johana vjen e veshur kuqezi. Kështu është veshur edhe një herë tjetër në një takim me disa shqiptare vite të shkuara.

Mua më befason ky fakt dhe shkoj e përqafoj, e ngre lart, e rrrotulloj si i çmendur nëpër dhomë. Qeshim dhe dhoma rreth e qark më duket më e gjerë, përderisa asnjë orendi nuk na pengon në këtë gjëzim të përbashkët.

— Pa të shohim tani se ç'thotë mbreti.

E grisim zarfin me solemnitet, letrën e mbaj pastaj pak larg vetes, me të dy krahet e shtrirë përpara, siç e kërkon sëra mbretërore dhe nis e lexoj, duke shkoqur mirë çdo fjalë.

Në përgjigje të kërkesës suaj për të marrë nënshtetësinë shqiptare, ju njoftojmë me kënaqësi se ajo kërkesë u mor parasysh. Mbreti i Shqipërisë, Ahmet Zogu i Parë, ju njeh nënshtetësinë shqiptare juve dhe bashkëshortes suaj të nderuar. Ju pret me kënaqësi në oborrin mbretëror si...

Mua më mbetën sytë mbërthyer tek ato fjalë që vinin më pas. Nuk dua t'u besoj syve. I lexoj një herë, dy, tri, katër, pesë. Do t'i lexoja, s'dihet sa do të vazhdoja, po të mos më ndërpriste Johana.

— Çfarë nate? — Zëri i saj i tronditur më përmend. Kushedi c'pamje të tmerrshme duhet të kem marrë atë çast.

— ... *Ju pret me kënaqësi në oborrin mbretëror si... mjeshtër i ceremonive...!* —
dhe një valë tèrbimi më errëson gjithçka.
Më duket se më verbuan ato germa të zeza
të shkruara me një makinë shkrimi të
papastruar prej kushedi sa kohësh, ku e-të,
o-të dhe a-të janë të mbushura si gropë plehrash.
Ulërij me sa kam fuqi: — Jo, jo, jo!

Dhe dal nga dhoma pothuajse duke rendur,
pa ditur ku të fut kokën. Nëpër shkallë përplasem me një njeri që më sheh krejt
i habitur. Dua ta kap për jake dhe ta flak
nëpër shkallë, por i përhumbur vazhdoj të
zbres dhe shtyj derën e kuzhinës, ulem
me kokën mbështetur në gjunjë dhe qaj pa
zë.

— Për ca kohë nuk marr vesh se ç'ndodh,
pastaj qetësohem.

Dëgjoj se si në korridor Johana grindet
me një njeri. Duhet të jetë ndonjë gazetar.
Nuk e di sa kohë kanë kaluar që kur u
strukë këtu në kuzhinë, por ai tèrbim vë-
shtirë aë të jetë qetësuar për pak çaste.

— Zonië. mua më interesojnë... — thoshte
zëri këmbëngulës i nië njeriu, mbase
i atij aë ndesha në shkallë.

— Ju lutem, na lini të qetë, — e kun-
dërshton Johana. — Tani neve nuk na
intereson asgjë.

«Vërtet asgjë!»

— Desha pak letrën e mbretit...

— Ja ku e keni, — e bëri copë-copë.

Unë nuk e mbaj mend kur e grisa letren, por duhet ta kem bërë patjetër. Mos kam thyer ndonjë gjë, bile nuk jam i sigurt nëse e godita atë njeri që ngjitej nëpër shkallë apo jo.

— Keni grisur letrën e mbretit?

— E ç'është letra, para shpirtit të grisur!

— Zonjë, nuk ju kuptoj!

— Aq më mirë! Tani, ju lutem, më lini të qetë...

— Unë do të desha...

— Ju lutem, largohuni, unë ju premtoj se do t'ju ndihmoj pak më vonë.

Po tjetri ngul këmbë në mënyrë të tillë, sa më bën të ngrihem dhe ta përzë me shkelma. Dhe në qoftë se nuk e bëj këtë, kjo ndodh sepse kanë filluar të më trembin gazetarët.

— Çfarë ka ndodhur, zonjë? Ndonjë grindje midis jush?

— Të ishte kështu, do të ishte mrekulli, do ndreqej shpejt.

— Çështje dashurie?

— Pa shih ku ju shkon mendja!

— Politike?!

Më në fund Johana mbyll derën dhe unë shpëtoj nga ai zë i tmerrshëm që më cingëris nervat.

Bëhet qetësi. Përpiqem të mbledh ve-

ten. Mendime të ngatërruara më vërtiten ne koke. Jam gati të shpërthej fort, po men-aimi se tashmë jam i humbur, pa rrugë-daije, më bën të hesht e të tërbohem brenda vetes.

Ngrihem dhe bares nëpër dhomë. Ndiej diku në një pikë të papercaktuar lëvizëse vështrimin e Johanës. Ajo e di se, kur jam i tronditur, më shqetëson çdo gjë dhe nuk më bie në sy. Hap me vërtik derën dhe ngjit shkallët për të vajtur përsëri në dhomën time.

Strukem përbys në kanape.

Ndihem si një qen i rrahur paturpësisht nga jeta. Tanimë jam vërtet një mbret pa fron, i humbur, i dhimbshëm, që baret në udhët pa krye të natës.

«Më duan si lolo.» E ndiej veten keq. I braktisur nga të gjithë, kërkoj të mbështetem diku, po nuk kam se ku, atje ku vë dorënështë një humbëtirë që më gremis përherë e më poshtë. Këtu ku jam, më kërkojnë të tradhtoj të vërtetën që besoj, më kërkojnë për ortak në këtë marrëzi të tmerrshme dhe si shpërblim premtojnë të më japid një kockë për të jetuar. Edhe an-dej më duan për të njëjtën gjë.

«Unë lolo? Kurrë!»

Kujtohem se këtë gjë ma kërkojnë vetëm mbretërit. «Ka mbretër me tituj, mbretër pa tituj, burokratë, zyrtarë me rangje

dhe grada. Por unë gjithmonë kam qenë kundër tyre. A s'jam unë, që u kam zbuluar skutat e errëta të shpirtit, që u kam bërë të kuptojnë se ua di hilen, kalbjen, ambiciet, rrënimin? Atëherë përse bëhem kaq i lehtë dhe besoj se mund të lidh një aleancë të barabartë me ta? Kush është ai mbret, ai tiran, që do të pranonte përballë vetes një rival si unë, që në skenë, si në një pasqyrë gjigante, i zbulon errësirën e shpirtit të mbuluar me një mantel në ngjyrën e ditës? Kush... Por prapë vetja më duket sërisht i hedhur poshtë si qeni plak që nuk kap dot më lepuj të freskët dhe e ushqen veten me krunde. Më kërkojnë plot lolo! Se mbretërit na dashkan të qeshin! Rrinë ngrysur kaq shumë mbi hallet e kombit dhe të botës, mërziten kaq shumë dhe i zë koka nga tymi i duhanit në mbledhjet e fshehta e të hapura që bëjnë, sa na paskan nevojë për një bufon që t'i bëjë të qeshin! Nuk ka më keq.

Ngrihem dhe ndez një cigare. Mbështet kokën pas murit, por nuk ndihem rehat. Atëherë shkoj te dritarja. Xhami është i ftohtë. Më vjen mirë kur mbështet aty ballin. Rrugën e shoh vetëm për pak çaste, pastaj në sy më mbetet vetëm një njollë e bardhë drite.

«Tërë jetën time jam shqetësuar vetëm për një gjë, për artin tim, si për një krije-

së tē brishtë ndërtuar prej èndrrash dhe jete njerëzore. Tërë jetën time u kam dhë-në frymën dhe jam tretur në këto tē vërteta që shpalos arti, pér t'i bërë njerëzore dhe konkrete, tē prekshme dhe reale pér tē gjithë. Kjo ka qenë dashuria ime më e madhe, që duan tē ma vrasin. Por kjo dashuri nuk vritet.

— Nuk vritet, — them pa dashje me zë dhe vë re se xhami i dritares është veshur me avull prej frymës sime tē nxehjtë. Jashtë në rrugë njerëzit duken si silueta tē stërmadhuara e prej mjegullnajës ngjajnë si tē veshur me skafandra.

Largohem nga dritarja, kaloj pranë librave, i prek, hap kot njërin prej tyre, e mbyll, e lë mënjanë.

«Atje larg më thërriste një tokë e largët, ndoshta gjaku im shqiptar. Kur përfytyroja lojën, skenën e ardhshme, para syve më dilte loja gazmore e kohës së fëmijërisë, kur mbi një tel vinim një çarçaf. Kisha mall pér atë fëmijëri tē papërlyer... Dhe ja më del një mbret...

Dhe kujtohem se, në qoftë se ka njeri që nuk duhet tē mërzitet nga kjo gjë, jam pikërisht unë, që ua njoh mirë shpirtin. I njoh aq mirë, sa nuk më sugjestionojnë më as pëershndritja e kurorës, as vulat e rënda dhe as spektri xixëllues.

«Mbretërit nuk i kam dashur kurrë...

Sikur unë të mos e dija se atje në cep të sa-llës është një njeri i ndershëm, pa tituj e ndere, sikur unë të mos e dija se zëri im do ta kthjellonte mendjen e tij dhe do ta ngrinte kundër padrejtësisë e tiranisë, nuk kisha për të nxjerrë fjalë nga goja. Lë të më thahej fytì si përrënjtë në stinën zhuritëse të verës...!»

«Po unë e di se ai më pret atje!»

«Përpinqem të gjej rrugën për tek ai.» Nuk e di përsë sjell ndër mend një njeri që dikur në fund të premierës nuk duartroki-ste si gjithë të tjerët, por përshëndeste duke tundur dorën lart. «Sa bukur, — kisha menduar unë ato caste, — ç'gjë të bukur ka zgjedhur për të më përshëndetur.» Më vonë mora vesh se ai njeri nuk e kishte njërin krah. E kishte prerë në luftë. Natyrisht, a! nuk më kérkoi kurrë autograf, por unë këto caste ndiej një dëshirë përvëluese që ta gjej dhe, në qoftë se nuk i jap, të paktën t'i kérkoj një autograf të thjeshtë, njerëzor, mundet një autograf të vënë në erë nga më-nëga boshe e krahut të tij të prerë.»

Pamjet konkrete që përpinqem të sjell ndër mend më qetësojnë disi nga fyera që porsa më bëri mbreti dhe më kthejnë në përmasa të reale të jetës.

Më duket sikur dhoma nuk është ndri-çuar mirë dhe se drítaret i ka tepër të ngushta, aq sa drita hyn me kursim. Edhe

orenditë janë vjetëruar pa masë dhe kanë nevojë të thirret ustai që t'u japë sadopak shkëlqim.

Kur e ndiej veten krejt të qetësuar, thërrres Johanën.

Ajo vjen në çast, sikur të kishte qenë aty pranë, brenda hijes që bënte te dera trupi im i ngarkuar me dhimbje e poshtërim.

— Jam këtu! — më thotë.

Sytë e saj më vrojtojnë me ngulm dhe e ndiejnë që jam qetësuar. Shoh një rreze gëzimi në bebëzat e saj.

— E more vesh, Johana? — i them unë.

Ajo tund kokën dhe, për të mos më lënë të flas, ndërhyjn:

— C'pret nga mbretërit, — dhe niset gjoja të rregullojë mbulesën e tryezës, duke mos më kushtuar vëmendje.

— Po! — i them dhe vazhdoj: — Pasi kanë vrarë mijëra njerëz në luftëra mizore, kanë munduar mijëra të tjerë në tragjedinë e pafund të mjerimit, kanë zhdukur mijëra kundërshtarë në burgje e kampe përqendrimi dhe pasi janë përpjekur të shuajnë nga harta shtete e kombe, gjithçka është ripërtërirë, si natyra në pranverë, atëherë mbretërit janë tërbuar, e në tërbim e sipër janë përpjekur të vrasin atë gjë të bukur e njerëzore që ruajnë shpirrat e njerëzve të thjeshtë: dashurinë, artin, pasionet. Ja, këto bëjnë mbretërit!

Johana ngrin në këmbë, pastaj vjen drejt meje me hapa të ngadaltë, më mbësh-
tet kokën në gjoks dhe vë aty veshin si-
kur kërkon të dëgjojë se si rreh zemra ime.

— Por ata nuk mund të vrasin asgjë,
sepse është vetëjeta që ripërtërin mirësinë.
Është vetë ky shpirt i fyero që gjen forcë
të ngrihet e të luftojë i ngacmuar, ai ame-
ba nga drita. Dhe një lolo si unë do të vazh-
dojë t'u thotë të vërtetat përmbrëtërit të
gjithë njerëzve, do të ndriçojë errësirën e
kështjellave të tyre të ngritura mbi eshtra,
gjak e krime dhe mendjet e tyre të krim-
bura të lara me një cipë të hollë të rreme
floriri...

Ja kështu i them dhe shkëputem me vrik
edhe prej saj dhe kërkoj kostumin tim më
të mirë.

— Ç'do të bësh? — më thotë ajo dhe
më ndjek nga pas e pikëlluar.

— Dicka të bukur, dicka të mirë, —
i përgjigjemi dhe vazhdoj të kërkoj. Në të
vërtetë nuk kam ndonjë mendim. Vetëm
dua të dal në rrugë. Mendoj se kaq mjaft-
ton.

Vesh këmishë të pastër, të bardhë e
mbërthej fort jakën e saj të kollarisur me
një papijon të zi ceremonie, vesh një zhilë
të zezë, ku duket zinxhiri i sahatit të xhe-
pit, mbërthej mirë kostumin tim të zi, në

ngjyrën e natës së thellë pa hënë, shihem gjatë në pasqyrë, vë dorezat dhe dal në rrugë.

Johana më ndjek e habitur. Një çast buzëqeshja ime e qetëson, pastaj i rikthen frikën.

Rruga është pothuajse e qetë. Eci në kalldrëm dhe kujtohem se më mungon një shkop i bukur, i gdhendur për të qenë aq serioz dhe aq i paraqitshëm sa ç'dua të jem në këto caste. Më vjen të qesh, sepse e kuptoj që i tërë ky përkujdes është vetëm frika se mos zbuloj poshtërimin që kam në shpirt. Kjo më bën të kuptoj më mirë një lidhje të ngushtë midis luksit dhe mjerimit. Një shpirt i gjëzuar mund të vishet edhe me rroba të vjetra. Ka fare pak rëndësi. Dhe sa shpesh një shpirt i mjerë mund të mundohet të mbahet me mjete të jashtme.

Sapo bëj disa hapa të ngadaltë në kalldrëm, më afrohet një njeri.

— Desha t'ju merrja një intervistë, — më thotë dhe unë njoh zërin e atij që kishte përzënë Johana. Edhe vetë e kam parë këtë njeri diku. Në ndonjë konferencë shtypi.

Për herë të parë ndiej dëshirën të jem i rrethuar nga gazetarët dhe t'ua them me zë të lartë gjithçka bluaj me vete. Pa asnje lloj renditjeje, t'i them mendimet ashtu siç më vijnë, ku, bashkë me mendimet e

larta për artin, të përzihet dhe meraku përritjen e çmimit të vajgurit dhe të sheqerit.

— Në orën 12 në teatër! — i them dhe vazhdoj rrugën më tej pa ia varur, duke e kuptuar që bëra një gjë të pamenduar mirë. Ai seç bën edhe një pyetje tjetër, por unë kam frikë t'i përgjigjem, pendohem që vendosa për bisedë, por tashmë kjo nuk kthehet dot. Ngaqë nuk i kthej përgjigje, gazetari mbetet pas. Dy gra të moshuara, me çantat e psonisjes në dorë, më përshëndetin me një përkulje të thellë teatrale. Unë i përshëndet në të njëjtën mënyrë. Çantat e tyre janë të fryra nga lakrat. «Ka njerëz që buzëqeshja i ngop më shumë se këto lakra bullafiqe», mendoj dhe më vjen përtë qeshur e njëkohësisht më vjen mirë që e largova veten nga këneta e hidhur e trish-timit. Eci për disa çaste midis disa fëmijëve të vegjël që luajnë me njëri-tjetrin e vërtiten rrreth meje, pastaj përsëri rruga bëhet e qetë. Diku në thellësi të saj janë një tog nxënësish që ecin të rreshtuar si ushtarë dhe këndojnë një marsh që, ndoshta sepse janë larg, nuk më tingëllon i frikshëm, por i trishtuar.

Kujtohem përsëri që i lashë takim gazetarit për intervistë dhe ndiej pasigurinë që kam pasur gjithmonë para tyre. Nuk i kam rreshtuar ende mendimet e mia, nuk di se çfarë do të them. Ata aq presin. Një

fjalë e pamenduar do të thotë sensacion, për ta do të thotë më shumë parâ.

Eci rrugës. Megjithëse e ndiej se s'di ende se ç'do të bëhet me mua, jam kaq i qetë dhe i sigurt. Atëherë e ndiej se kjo qetësi nuk është gjë tjetër vecse ajo prehje që gjen një i varfër kur i mbarohen edhe ato pak para që i ranë në dorë rastësisht.

Eci rrugës i vetëm, pa asnje shpresë.

«Ç'do të bëhet me mua?»

Kjo pyetje më mbetet pezull për pak çaste. Vështrimi më lëviz mbi një dyqan sahatçinjsh, ku sahatë të mëdhenj e të vegjël, në forma gjeometrike, shpendësh, kafshësh, objektesh, tavllash duhani, me pendule e pa pendule lëvizin përpara me shpejtësi akrepatur e sekondave. Pastaj në një dyqan kukullash vë re se ka shumë lodra, tanke, auto-blinda e njerëz me uniforma. Me sa duket mobilizimi është i përgjithshëm, deri te lordinat e fëmijëve.

«Le të bëhet ç'të bëhet!» — them dhe mendoj një zgjidhje të fundit.

Hyj në një kabinë telefonike, marr librin e telefonave dhe lajmëroj dhjetë gazetarë që të vijnë në orën dymbëdhjetë në teatër sepse dua të jap një intervistë. Nuk harroj të njoftoj dhe Karlin, që mbetet i çuditur, po të gjykoj nga zëri dhe heshtja në telefon, dhe Alfrerin, që kërkon të më takojë paksa më përpara. «Në asnje mëny-

rë», i them. Mbyll telefonin dhe dal përsëri në rrugë.

Në vend që të ndihem sadopak me përgjegjësinë se do të shfaqem para kaq shumë njerëzve, ndiej një lehtësim të çuditshëm. Për të mos menduar më asgjë, hyj në një bilardo dhe luaj karambolin, ku humbas gjithsej 130 marka.

Gazetarët vijnë një nga një. Ndoshta secili prej tyre ka kujtuar se është një nder që po i bëj gazetës së tyre dhe nuk e dinë se intervista do të jetë e përbashkët. Nuk kanë përse të mërziten, sepse shumë gjëra në kohën tonë po bëhen të përbashkëta, qethja e flokëve, veshja, ecja, këngët madje edhe argëtimet.

Alfredi përpinqet që të më térheqë mënjanë, por unë nuk i përgjigjem, bile i bëj me shenjë të mos më kërkojë asgjë më shumë dhe ndiej se sa mirë është të mos kesh se ç'të humbësh.

Nuk erdhën të gjithë, katër gazetarë nuk e panë të arsyeshme të vinin. Me siguri, unë, për ta, nuk përbëj më ndonjë mall me fitim dhe fjalët e mia janë zhvlerësuar aq shumë, sa nuk blihen as tre greshë copa. Për ta tashmë, me sa duket, unë nuk jam më një emër, por një shifër brenda shifrave të tjera e që shprehin në përqindje kategori të ndryshme sociale. Nuk di nëse

unë shtoj ndonjë gjë në shifrën e tyre pas presjes dhjetore të papunëve, emigrantëve apo çifutëve, ku mund të më futin ata.

Karli qëndronte ende i heshtur, si një kalorës që nuk ka marrë shpagimin. Njëherë mendova të mos e thërritja, po këtë intervistë, që unë e quaj një çast mjaft të rëndësishëm të jetës sime, nuk do të desha ta bëja pa të.

U kërkoj ndjesë gazetarëve pesë minuta dhe ngjitem në studion time. Ngaqë kam kohë pa hyrë, ajo më vjen era vjetërsirë. Mbi mobiljet, tryezën, kolltukët, në mënyrë më të dukshme edhe mbi pasqyrën ka rënë pluhur.

E mbledh veten duke marrë frymë thellë dhe ato çaste me pak fjalë ngjit brenda vetes mendimin që më vjen në kokë.

«C'do të bëhet me mua?»

Pastaj rend të gjej sendet që më duhen për ta bërë më sugestiv dhe me ngjyra sa më teatrale takimin. Më paska marrë një mall i tmerrshëm për të dalë në skenë. Këtu në studio, këto çaste, më duket vetja si mbreti Lir kur i hedh vështrimin e fundit froni. Është një vështrim nostal gjik, ku sundon mençuria e vonuar.

I them portierit të m'i sjellë gazetarët në studio.

Ata vijnë. Është shtuar edhe një fotoreporter që shkrep blicin dhe fillon ashtu siç

është, permes pluhurit. Nuk di nëse fotografia do të datë sfokato, apo pluhurin e djeg bluci, që shpërthen me zhurmë.

Nuk pres sa të zënë vend të gjithë, ngrihem në këmbë, ngrë dorën lart dne ata ndalojnë të gjithë. Përballë kam Karlin.

Filloj të rras. Asnjeri, çuditërisht, nuk shkruan, ndoshta të befasuar nga ndërhyrja ime.

— I braktisur nga të gjithë mbretërit, unë do të kërkoj në botë njeriun më të thjeshtë, atë që më do dhe më kujtom, atë që është i interesuar të dijë të vërtetat patituj e ndere. Ndonjëherë braktisja është e keqe, ndonjëherë është fatlume sepse të jep kurajë dhe burräri. Pra, nuk do të rri askëtun në Gjermani, nuk do të shkoj as në Shqipëri. Do të endem në një turne të gjatë nëpër botë. Dhe e dini çfarë do të luaj?

Rend, marr një parukë dhe e vendos në kokë. Është një parukë e shëmtuar, me flokët e gjatë e të pakrehur. Heq xhaketën e zezë të kostumit dhe hedh një pelerinë mbi supe, shtrihem në dysheme dhe nuk pyes nëse më bëhet pis kostumi i ri, bile kam dëshirë këto çaste të më griset fare.

O, sa shpirt rob e sa i humbur jam!

*Nuk është çudi që ky aktor në përrallë
vetëm në ëndërr pasioni
e shtrëngoi shpirtin aq fort pas frysës,*

*sa prej kësaj iu zverdh faqja,
iu përlot syri, iu hutua pamja,
iu thye zëri,
trupi, trupi u trondit!*

Në studio nuk dëgjohet asgjë. Unë heq mantelin dhe rrok një mantel tjetër. Në këtë fluturim shoh siluetën time që duket e zhduket në pasqyrë si vegim. Vërsulem mbi gazetarët dhe bie në gjunjët e Karlit.

— Më thuaj, xhaxha, çfarë emri ka i gjithëfuqishmi: mbret apo njeri i thjeshtë? Ti thua mbret?... Jo, jo! I gjithëfuqishmi është ky njeri i thjeshtë... Prandaj duhet të jesh i çmendur që të durosh mbi vete birin e një oborrtari!...

Ngrihem, heq mantelin, heq parukën, shkundem dhe qëndroj serioz përpara tyre.

Mbledh veten dhe vazhdoj të flas me një ton serioz, të qetë e solemn.

— Pra, siç e morët vesh, do të luaj mbretin Lir e të tjera si kjo, ku një lolo guxon dhe e gjen të drejtë të tallet me të gjithë mbretërit e tiranët. Do të bredh nëpër botë dhe do të bërtas me gjithë zërin tim të vërtetën, vetëm të vërtetën.

Bëhet heshtje, pastaj Karli duartrokët si në fund të një spektakli. Alfredi më përqafon dhe studioja mbushet plot tym nga shkrepjet e panumërtë të blicit.

Epilog

U duk sikur po mbyllej perdja është po e ndante nga ajo dramë e gjatë dhe e pafund që ndodhte përtej skenës. Në fillim rënia e perdes fshiu nga sheshpamja atë pjesë të hapësirës që i takonte pafundësisë, pastaj me radhë, qytetin, sheshin, dhe së fundi sallën e teatrit, duke filluar nga lozhat, plateja e deri te bardhësia e së shoqes së përlotur, me lulet e stinës në duar, duke e tretur gjithçka në një errësirë të thellë e të plotë si nata kur nuk ndriçon

asnjë yll, xixëllonjë, madje asnjë sy i dashruar.

Vdiq fare i qetë dhe të gjithëve kjo iu duk ë natyrshme, pas asaj rendjeje të shpejtuar nëpër botë, në atë turne të gjatë dhe të ngjeshur, kur i duhej gati përditë të ndërronte qytetin, të udhëtonte me trena, vaporë, automobila, madje dhe me karroca. E gjithë kjo kohë kishte pasur një shpërthim të habitshëm: të gëzueshëm dhe madhështor, dhe të gjithë e ndienin veten të kënaqur prej kësaj, edhe pse kjo qe një flakë qiriri, që, sa më e madhe të ishte, më shumë e shkrinte atë.

Ceremoniali i varrimit ishte fare i thjeshtë dhe i ngjante një spektakli pa zhurmë e bujë. Secili prej atyre që qenë në varrim kishte dëshirë të thoshte dy fjalë dhe kjo ishte e vëtmja vonesë që pati ky ceremonial që, ndonëse pa protokoll, përshkohej nga një ndjenjë e thellë respekti dhe dashurie për atë që kishte ikur.

E në këtë ceremoni të përzishme nuk morën pjesë dy nga miqtë e tij më të mirë. Karlit nuk ia thanë fare lajmin e hidhur të vdekjes së mikut të tij, sepse ai ishte vetë në grahmat e fundit, në shtratin e vdekjes. I zhgënjer pa masë nga shtyrja pa fund e gjyqit që do të vinte në vend nderin e tij, ai nuk besonte më në asgjë. Ngagë nuk besonte, jeta për të nuk kishte

më kuptim. Alfredi gjithashtu nuk mundi të vinte, sepse policia e kishte marrë para disa muajsh dhe e kishte nisur me «pushim» të detyruar në njërin nga ato kampet e punës, për të cilat thuhet se pushon aq mirë, sa të prehen kockat përjetë.

Pasi folën të gjithë me radhë, asnje gazetar nuk mbajti shënim, kortezi u largua duke marrë në mes gruan e veshur me të zeza dhe që qëndronte hijshëm, duke përballuar me natyrshmëri këtë që ngjau. Madje ajo e dinte që kjo do të ndodhë dhe e kishte pritur në heshtje, duke menduar vetëm përditë nga një çikë gjatë gjithë kësaj kohe.

Kur varri mbeti i shkretë, mbuluar me lulet e shumta të stinës dhe me kordele ku shkruheshin fjalë të dhimbshme lamtumi-re, aty u afrua me hapa të lehtë një njeri.

U përkul në gjunjë dhe nxori dicka nga brendësia e rrobave në pjesën e gjoksit. Duke pëshpëritur lehtë, aq sa edhe rojtari i varrezave, të cilit i kishte bërë përshtyp-je ky njeri i vonuar, nuk dëgjoi asgjë, tha:

— Përpara teje përkulet me respekt edhe djelmuria shqiptare. Ti nuk arrite të luash asnjëherë në skenat shqiptare, por emri yt do të jetë i paharruar për ne.

Ajo që nxori nga xhepi, ishte një qese, të cilën ai e ktheu përmbyss mbi pllakën e varrit dhe e derdhi. Ishte një grusht dhë.

— E pata ruajtur në gji një grusht dhë nga Shqipëria, ta puthja kur të më merrte malli shumë. Po e hedh mbi ty për të shuar atë mall, që, sidoqoftë, diçka, diçka zhurit.

Ishte Mistoja.

BANJA RERE TË NXEHTË

Verën që kaloi, me rekomandim të mje-kut, shkoja rregullisht në plazh. Më qe bllu-kuar gjuri nga reumatizmi dhe më duhej të bëja banja rere të nxehjtë. I hipja au-tobusit çdo mëngjes, në mes të rrëmujës së zakonshme shkoja tek Apolonia, merrja një çadër sa për të futur kokën, mbulohesha përgjysmë me rërë dhe rrija shtrirë duke dëgjuar muzikë.

Të qëndroje shtrirë tërë ditën, i mbuluar me rërë që digje, ishte një torturë e vërtetë. Dalëngadalë trupi niste të ngrohej dhe diçka fillonte të zhurmonte brenda mus-kujve, deri në padurim. Djersët më mbulo-nin të terin. Deti ishte dy hapa pranë dhe nuk hyja dot.

Një ditë nuk durova dot. U ngrita më këmbë, duke shqetësuar njerëzit që qëndronin aty pranë me rërën që shkunda nga trupi, dhe vravova drejt kaltërsisë. Ù futa në ujë me llokoçitje dhe pastaj qëndrova gjatë duke u kredhur në nanurisjen e valë-ve. Dielli më pas e humbi për mua forcën

e ndriçimit e të ngrohjes, dita nisi të mos digjte dhe aq shumë e gjithçka rreth e qark u bë e freskët dhe e pranueshme.

Pas dy ditësh u bllokova keq nga gjuri i majtë. Kur u ngrita, si zakonisht, në mëngjes, e ndjeva që nuk lëvizja dot. Bëra nja dy-tri prova, po më keq. Çalë-çalë e me dhembje të madhe, me ndihmën e dy djemve të panjohur i hipat urbanit, duke mallkuar veten për mungesë vullneti. Dëmshpërblimin e një kënaqësie të castit ndodh që njeriu e paguan gjatë gjithë jetës. Megjithatë i mora përsipër vetë të gjitha, e binda veten se duhej të isha më i vullnetshëm dhe vendosa të mos futesha më në ujë edhe sikur trupi të më avullonte nga vapa e madhe.

Përsëri çalë-çalë, mora çadrën te sporteli, ku të gjithë më ndihmuani, dhe u nisa në vendin e zakonshëm.

— Pa shiko, Bajroni! — tha një vajzë. E kisha parë që qëndronte prej katër ditësh pranë vendit ku torturohesha unë.

Më erdhi për të qeshur kur dëgjova kallimthi këto fjalë. Kisha kaq vite që përpinqesha të bëja një libër me vjersha, recensentët ma kthenin gjithmonë me vërejtje dhe, ja, mjaftonte një mëngjes të ngrihesha i bllokuar nga reumatizmi dhe papritur prej kësaj të bëhesha i famshëm si Bajroni.

— Më duket se dëgjoi, — tha një vajzë tjetër, që qëndronte me të.

— E pastaj? — ia ktheu tjetra, e cila ngriti zérin që unë ta dëgjoja me tërë mend.

— Kur një njeri shkruan vjersha dhe çalon, ai s'mund të jetë tjetër veçse Bajroni.

Dhe qeshën. Unë nuk u zemërova.

— Lëreni të shkretin njeri rehat, — u thashë unë duke mbuluar me vështirësi me rërë të nxeh të këmbën e bllokuar. — Në vend që të më ndihmoni... Nuk është njerëzore!

Dhe u buzëqesha për miqësi.

— Të të ndihmojmë? Dakord! — tha ajo që ngacmoi e para. Quhej Ela dhe ishte simpatike. Flokët i kishte të prerë shkurt dhe mua sepse më pëlqeijnë vajzat me flokë të shkurtër.

U afroan dhe nisën të më mbulonin me kujdes këmbën.

— Po të mos keni bezdi...

Po politesa ime qe e kotë. Ato më mbuluan me zell të madh, sikur të ishin infermieri. Nuk e dinin që ashtu, i mbuluar, unë do të torturohesha, se ndoshta s'do ta bënin me kaq dëshirë.

— Unë të njoh, — tha papritur Ela, kur po matesha t'i falënderoja. — Ti shkruan vjersha!

— Që nga e di?

— Unë lexoj vazhdimisht vjersha. Më pëlqeijnë shumë.

Ja, më në fund e gjeta një gjë interesante. Tjetra, që quhej Gita, s'ndérhynte fare. Ajo ishte ulur në rërë dhe shikonte nga deti.

— Po ty çfarë të pëlqen? — e pyeta unë. Edhe ajo s'ishte e keqe.

Gita bëri një gjest nënveftësimi.

— Gitës i pëlqen sporti, — ndérhyri Ela, — rrëshqitjet në akull.

— Asaj iu dashka të presë vazhdimisht dimrin, — thashë unë dhe buzëqesha. Gita në ato çaste m'u duk një vajzë e lehtë, bile torollake.

— Ne verë më pëlqen vetëm noti, — ma preu. — Tërë ditën dua të rri në det.

Atëherë unë vendosa të bisedoja vetëm me Elën. Në fund të fundit, kur je përpara dy vajzave, vetvetiu bëhet një zgjedhje e brendshme.

— Të paktën më thuaj, — iu ktheva Elës, — të kanë mërzitur vjershat e mia?

— Jo. Më pëlqejnë.

— Vërtet? (Këtë të kishte dëgjuar ai recensenti, që çfarë nuk thoshte.)

— Po.

— Vetëm kaq?

— Unë mund të flas edhe më gjatë po të duash. Më duket se ndjenja nuk të mungon. Ka edhe shqetësim. Dhe kjo ëshë kryesorja. Një shkrimtar ka thënë se poezia

pa shqetësimë është si qelli pa shkrepëtima,
tërë zagushi.

— Kë të drejtë, — i thashë dhe u
ngrita përgjysmë. — Pa hë!

— Çfarë?

— Më thuaj ndonjë vërejtje!

— Unë nuk di ende se çfarë tipi je,
kështu që po hesht, — buzëqeshi ajo.

— Di të them që më pëlqen sinqeriteti.

Gita psherëtiu thellë.

— Kam edhe vërejtje, po do të t'i them
herë tjetër. Gita u mërzit dhe mua më du-
het ta shoqëroj deri te trampolina. Ti po
nuk vjen dot, se...

— Ç't'i bësh, — thashë me keqardhje
për veten. — Jam i dënuar. Megjithatë fa-
leminderit!

— Nuk ka asgjë për të na falënderuar,
— ma ktheu.

Gita nuk foli, por eci ngadalë drejt
detit. Ela pas saj. Unë i ndoqa me sy.
Dalëngadalë u tretën pas njerëzve të tjerë
në breg, pastaj m'u lodhën sytë nga refleksi
i diellit dhe nuk i pashë më. Në mendje më
ngeli mënyra se si fliste Ela. Ishte e qetë
dhe e sigurt në ato që thoshte. Duhej të qe
nga ato vajza që lexojnë shumë, bile ndoshta
edhe nga ato që shkruajnë ndonjë vjershë
fshehurazi, por që kanë turp t'i thonë kujt
për këtë gjë.

Të nesërmen Ela erdhi me një arançatë në dorë.

— Merre shpejt, se i ikën gazi, — më tha. — Është shumë vapë.

— Më befasove. Nuk e prisja.
Dhe m'u bë qejfi.

— Nuk e bëj lehtë një gjë të tillë, — ma ktheu ajo. M'u duk një çikë e guximshme kjo deklaratë, po, ngaqë më pëlqeu, nuk e ngacmova më tej. Sidoqoftë veten ngushtë e ndjeva.

— Ti the se do të më bëje vërejtje, — e ngacmova unë kot.

— Më vonë, — ma ktheu.

— Përse më vonë? Tani!

— Është vapë! — tha ajo fare kot.

Unë pohova duke u përpjekur ta shihja në sy, por ajo e kishte vështrimin diku pas meje. Ktheva kokën. Nuk kishte asgjë interesante. Vetëm një fëmijë fare i vogël vraponte duke iu ngatërruar këmbët pas një topi të madh plazhi. Unë u kujtova për Gitën.

— Po Gitën ku e paske lënë sot?

— Shkoi të shihte maratonën e notit. Është mërzi e madhe të rrish me njerëz me të cilët nuk shkëmben dot dy mendime, — foli ajo nervoze. — Nuk e marr dot me mend. (Sapo fillon t'i flasësh Gitës për vjersha e për opera, të shikon sikur je ngritur nga gjumi dhe po flet përcart. Po

ty, natyrisht, tē pëlqen tē flasësh pér to?

— Doemos, — i thashë, — arti është pasioni im.

— Edhe imi, — tha Ela. — Megjithëse vetë nuk kam shkruar asnje varg, prapë më pëlqen jashtëzakonisht tē flas pér tē.

— Në shkollë je?

— Jo, — m'u përgjigj, — apo kam mbaruar maturën. Tani pres. Kushedi se çfarë do tē bëj.

— Ke dëshirë ta vazhdosh shkollën e lartë?

— Si tē thuash...

Ajo ngriti supet dhe kjo m'u duk thjeshtësi. Lëviza pér tē ndërruar pozicionin e këmbëve sepse ndjeva se u mpiva.

— Po ti ku je sëmurur kështu?

— Nuk e di.

Ajo buzëqeshi dhe më pa në sy me një mënyrë tē dyshimtë.

— Diku kam dëgjuar se reumatizmi është sëmundje profesionale e të gjithë poëtëve. Kur bie shi, u pëlqen tē lagen deri në kockë. Mua më pëlqeijnë vjershët me shi.

Unë vendosa tē bëja një vjershë me shi.

— Kam lexuar Eseninin, Pushkinin, Hygojin, Bajronin, De Mysenë. Është kënaqësi tē lexosh vargje tē tillë si «gjallë je ti, moj nënokja ime, gjallë jam dhe unë, tē

përshëndes...» Apo «Shalli i zi». Është një mrekulli e vërtetë.

— Shumë të bukura janë, — i thashë unë jo vetëm sa për të pohuar, por sepse vërtet më pëlqenin.

Pastaj ajo vazhdoi të fliste me pasion për poezinë. Më çuditi që dinte aq shumë. Në rrëthim tim shoqëror më mbanin ndër ata që lexonin më shumë, megjithatë, në krahësim me Elën, kisha ndonjë mungesë.

— Kur ti ke lexuar vargje të tilla, çuditem si të kanë pëlqyer vargjet e mia, — thashë unë.

— Pavarësisht se ndonjëherë i largohesh njeriut, prapë kanë sinqeritet, — foli ajo me kompetencën dhe superioritetin e një kritiku. (Këtë le ta dëgjonte ai recensenti i dytë. Dhe libri im kishte për t'u botuar patjetër.)

— Ku e sheh ti këtë largim?

— Ja ku dolëm te vërejtjet, — tha ajo. — Të marrim për shembull poezinë tënde për nënën. Edhe kur flet për të, do të përmendësh që je diku larg në një kantier, të kujtohet, betoniera, shoku me çizme e ku di unë se çfarë...

Unë u përpoqa të rikujtojë edhe një herë poezitë e mia. Isha përpjekur gjithmonë të jepja shqetësimet e moshës sime. Gjithçka të përthyer aty. Dhe nëse brenda moshës sime hynin shumë gjëra, unë nuk

e quaja mangësi ose «largim nga njeriu», por një vlerë. Pikërisht për këtë përpinqesha të jetojë sa më shumë. Megjithatë nuk desha të kundërshtoja. Nuk ia vlen që me një vajzë të bukur të prishesh për poezinë.

Pasdite unë vendosa të bëja një vjershë me shi. U përpoqa të sillja ndër mend ditët me shi që kisha jetuar, dhe të gjitha m'u dukën të bukura. Ndoshta këtu kishte pjesën e vet edhe nxehësia e asaj vere, që ngjallte nostalgji për shiun. Bile m'u kujtua se një ditë, kur isha në aksion në hekurudhë, na zuri një shi i papritur në trase dhe ne u futëm në këmbët e një ure, derisa pushoi Po, në qoftë se do të flisja për këtë në poezi, Ela me siguri do të thoshte: ç'hyn ura? Shkurt, poezinë nuk e bëra. Po në kokë më mbetën vetëm dy vargje: «Sytë e tu rimojnë me sytë e mi, kjo është dashuria.»

Megjithatë Elës nuk ia thashë as atë ditë, as në ditët që vijuan, kur ne takohenëshim dhe bisedonim kryesisht për letërsinë. Kujtonim emra, vargje, deklamonim dhe në të njëjtën kohë vazhdoja banjat e rrëres së nxehëtë.

Një ditë ajo më pyeti se çfarë do të shkruaja.

— Dua të bëj një skenar filmi, — i thashë.

— Për çfarë?

— Për shpronësimet e borgjezisë nga revolucioni.

— Ohu! — tha ajo dhe bëri një gjest me dorë. — Gjithkund po kështu. Hap televizorin, sheh ndonjë film me këtë temë. Merr një libër, do të gjesh dy tregime ose një personazh patjetër. Dhe gjithkund njësoj. Në fund të fundit ti je kundër skemës, apo jo?

Në njëfarë mënyre Ela kishte të drejtë. Sapo një temë ngajeta trajtohet nga dikush dhe ka sukses, të tjerë vrapojnë ta rrokin. E këqja është se e shohin nga një pikë. Për pak çaste m'u luhat mendimi që kisha në kokë për ta bërë këtë skenar. Më vinte keq sepse kisha rrëth një vit që mblidhja materialet dokumentare, po fundja skema ëshë e bezdisshme. Jeta ka kaq shumë tema, sa nuk bën të ngulesh vetëm te një.

Megjithatë Elën e kundërshtova. Edhe ajo më kundërshtoi përsëri. Dhe kur unë e pyeta se çfarë duhej të shkruaja sipas saj, ajo, për çudinë time, m'u përgjigj:

— Shkruaj ndonjë gjë si «Zonja me kamelje»!

Unë qesha me të madhe.

— Përse qesh? — foli ajo me seriozitet.

— Je shumë romantike, megjithatë kjo të bën interesante!

— Megjithatë ti me këtë të qeshur më fyeni.

— Nuk kam ndër mend të të fyej, po kërkesa jote është naive.

— Naive? Pse, ç'mendim ke ti për «Zonjën me kamelje»?

— Është një letërsi tjetër.

Ajo nuk e ndien veten mirë.

— Unë them se nuk ka se si t'i kalojë koha, përderisa dashuria jeton, — nguli këmbë ajo. E vura re që ishte zemëruar. Nuk e kuptova arsyen. Ndoshta unë me të qeshurën time i tregova se kishte një pamje naive dhe naiviteti shpesh të bën të skuqesh.

— Letërsia ka lidhje gjithmonë me kohën, me realitetin, — i thashë unë për ta mbyllur këtë bisedë.

Por ajo vazhdoi vetë:

— Ne nuk jemi të zotë të bëjmë gjëra të tillë të pastra, — tha ajo, — dhe ngatërrrohem i në lloj-lloj problemesh. Kam lexuar një ditë një vjershë për gëzimin e një mjelëseje. Një ditë për një saldator që diskutonte në mbledhje. Kjo është letërsia?

Ajo qeshi si për të nënvizuar se isha unë që kisha mendime naive për letërsinë.

— Po ne nuk jetojmë në shekullin e tetëmbëdhjetë, — i thashë unë.

— Edhe ti kështu mendon?!?

— Doemos, — ngula këmbë unë seriozisht, — letërsi jashtë kohe nuk mund të ketë kurrsesi.

Dhe u ngrita. Nuk ia vlente të zgjatesha.
Ajo u ngrit pas meje.

Ishte po aq e bukur sa edhe ditën e parë.

— Po si shpjegohet që neve na pëlqeijnë njerëzit që kanë shkruar edhe dhjetë vjet më parë? — pyeti me vendosmëri.

— Sepse kanë shkruar në përputhje me kohën, — iu përgjigja dhe m'u duk vetja sikur isha në një sallë provimi. M'u duk disi e çuditshme kjo bisedë në atë mjedis plazhi.

— Megjithatë letërsia është e përjetshme, — tha ajo. — Nuk e di, por unë e besoj që ndjenja është dëcka hyjnore. Gjërat tokësore e ngatërrojnë... Dhe kam lexuar aq shumë...

— ... sa unë ndonjëherë skuqem para teje, — ndërhyra unë. — Është e vërtetë që ke lexuar shumë, po e di... nuk është i shëndoshë ai që ha shumë, por ai që tret mirë.

— Këtë fyterje nuk ta pata borxh, — u nxeh ajo dhe iku.

Iku me inat, sikur ta kisha ngacmuar në ndonjë plagë. Unë nuk arrita të shpjegohesh, se ajo u zhduk pothuajse me vrap.

Në fillim qortova veten. Si dënim, u mbulova përsëri me rërën e nxeh. Më pas, kur u mendova thellë, nuk gjeta asnje fjalë që të justifikonte zemërimin e saj. Përkundrazi, ajo ishte treguar një cikë teka-

njoze, romantike, që e merr jetën si ne ca libra. Bile unë ndoshta duhej të isha sjellë pak më i rreptë, duhej t'i kisha thënë se e kishte një mijë herë gabim.

E prita të nesërmen, por ajo nuk erdhi. Këmbën e mbulova vetë. Prita edhe të pas-nesërmen dhe përsëri nuk erdhi. I téri i futur mes rërës së nxehjtë, si brenda një ankthi, prisja, turfulloja, pshëretija, djersitesha dhe nuk e merrja vesh, nga vapa apo nga pritja.

Ditën e tretë pas hënë Gitën në mes të një grupi shokësh. I thirra dhe ajo m'u përgjigj ftohtë. Nuk ma vari fare, megjithatë, e detyruar, m'u afrua. Unë e pyeta për Elën.

— Nuk vjen më, — më tha prerë. — Ti e kiske zemëruar.

— Zemëruar?!

— Më keq, e kishte zhgënjer! Edhe ai si gjithë të tjerët, më tha.

— Ku mund ta gjej? — ngulmova, ndonëse ajo ngutej të ikte.

— Ndoshta do të jetë kthyer në shtëpi. Dërgoji ndonjë letër, ose-ose bëji ndonjë lajmëthirrje, — ajo e tha me inat këtë dhe me qesëndi.

Unë u kujtova se nuk i dija mbiemrin.

Gita më tha një mbiemër të njojur. U përpoqa të kujtohesha se ku e kisha dëgjuar, po nuk më ra ndër mend. Në darkë, papritmas u kujtova se, në materialet që studioja

për skenarin përfundin e luftës, mbiemrin e saj e kishte një familje e madhe borgjëzësh. Kur ishin bërë shpronësimet, ata i humbën të gjitha, pronat, shtëpinë, gjithçka, me përjashtim të librave.

Risolla ndër mend edhe një herë bisedat e mia me Elën dhe krijova një lidhje të saj me këtë familje. Për herë të parë vura re se vetë ajo nuk ishte veçse një grumbull citatesh, vargjesh, emrash.

Për herë të parë Ela m'u duk e ftohtë, si një libër i mbuluar nga pluhuri. E kup-tova më në fund se ajo kishte të drejtë kur fliste përmungesën e komunikimit me një-rezit, ajo i përkiste një bote tjetër, të pluhurosur. E vetmja armë që i kishte mbetur, ishte pikërisht ky grumbullim kulture, librash, vargjesh. Ishte një superioritet libresk, të cilinjeta po e vjetronte përditë e më shumë.

Për një çast kisha vendosur të mos e bëja skenarin përfundim e borgjëzëve. «Për të mos rënë në skemë». Megjithatë vendosa ta bëja me çdo kusht. Dhe do të flisja përfundon.

«FATKEQËSIA» E DJALIT TË DREJTORIT

Zilja e telefonit tringëlliu gëzueshëm.

— Prapë! — tha djali.

Ai ishte i ngazellyer. Fatbardhi mori receptorin.

— Alo!

Ishte një urim i zakonshëm për emërimin e ri. Ia bëri me sy djalit dhe Ardit 10-vjeçar hoqi edhe një vijë me laps mbi një copë kartë të lënë mbi radio.

— E trembëdhjeta për sot!

«Tri ditë! Bah! C'torturë!» — mendoi Fatbardhi duke hyrë në banjë për t'u rruar.

— Babi, — e ndoqi nga pas Ardit! — mos na vono shumë!

— Ja, mbarova, deri në dhjetë, — tha Fatbardhi. — Dil e shih se mos ka ardhur makina!

Arditi i zbriti shkallët me vrap. Fatbardhi dëgjoi rrapëllimën e hapave të tij dhe qëndroi për pak çaste para pasqyrës i menduar.

Kishte tri ditë që rrinte kështu si i hutar. Ndoshta ngaqë emërimi i kishte ardhur

kaq papritur. («Të paktën të kishe kohë pér të qepur një kostum të ri», i kishte thënë e shoqja.) Ai kishte dëgjuar, po vetëm tani e besonte se si një ngjarje mund të vijë me shpejtësi rrufeje. Ai e ndiente se kishte filluar të ecte me shpatulla të ngrira, me këmbët që i ngatërroheshin («ah, këto pantallonat, shante me vete, sa të gjera që janë, shiko si valëviten!»). Përpiquej të sillej sikur asgjë nuk kishte ndodhur, asgjë e veçantë, po kjo e bënte të dukej qesharak. Nga hutimi kishte nisur të bënte humor me veten.

Ra një bori makine. Në fillim Fatbardhi nuk i kushtoi rëndësi, po kur boria u përsërit disa herë, zgjati kokën në dritaren e banjës. Ardit i ishte ulur në vendin e shferit dhe i binte borisë duke qeshur e duke bërtitur i lumturuar.

Fatbardhi bëri me shenjë se po zbriste. U la shpejt e shpejt, u vesh dhe mori në dorë çantën e udhëtitimit. Ndonëse do të shkonte e do të kthehej brenda ditës në qytetin ku kishte nënën, çanta ishte mbushur plot.

— C'dreqin më ka vënë kaq shumë, — shau ai gruan, por, kur e hapi, vuri re se në të rëndonin dhuratat që e shoqja me kujdes përgatiste pér nënën e tij.

— Për nënën! — pëshpëriti ai dhe ndjeu mall.

Duke zbritur shkallët, pati një ndjenjë faji. Nuk kishte qenë aq shpesh sa ç'duhej te nëna, po punët kishin qenë të shumta, aq sa i zinin çdo orë të ditës. Në fillim edhe gruaja mërzitej kur ai dilte në punë menjëherë pasi hante drekë e kthehej në prag të mesnatës, po me kohë ajo e kishte pranuar këtë gjendje. «Tani unë nuk shqetësohem më se më mungon, — i kishte thënë ajo një ditë, — po se lodhesh!»

Fatbardhi hyri në makinë dhe shkëmbyen përshëndetjet me shoferin. Shoferi ishte një djalë simpatik, të cilin ende nuk e njihte mirë dhe s'dinte si t'i sillej.

— Nisemi? — pyeti shoferi.

— Nisemi, — tha Ardit, i paduruar.

Në pasqyrën e brendshme të makinës shoferi takoi sytë e Fatbardhit dhe ndezi makinën. Bënë një copë rrugë të heshtur.

— Si e ke emrin? — pyeti shoferi djalin.

— Ardit!

— E gjëzofsh! Mua më quajnë Peri, — tha me zë të lartë shoferi, që ta dëgjonte edhe Fatbardhi. — Kështu e kam shkurt. Gjatë e kam Perikli.

Fatbardhit i erdhi për të qeshur. Ai për kaq gjë kishte pyetur. Ia dinte emrin. Dinte edhe se ishte martuar shumë i ri dhe kishte dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë.

— A bëjmë një xhiro nëpër Tiranë? —
kërkoi Ardit.

— Ardit! Nuk kemi dalë për xhiro! —
i tërhoqi vëmendjen i ati.

— Të keqen, babi. Një nëpër unazë. Ve-
tëm një!

— Një herë tjetër.

— Po sikur të mos ia prishim? — ndër-
hyri shoferi.

Fatbardhi heshti.

— Kjo xhiro është për ty, — tha Peri
dhe Ardit u ngrit në këmbë e bërtiti nga
gëzimi.

Makina u kthye tek ura e Lanës dhe doli
drejt e tek ATSH-ja pastaj në rrugën
«Bardhyl».

— Atje është shkolla ime. Kthehem
një çikë edhe atje? — iu hap oreksi Ar-
ditit.

— Ardit! Po të them që e teprove! —
ndërhyri Fatbardhi, kësaj radhe aspak i
qetë.

— Po pse, o babi, nuk do të shkoj ndon-
jëherë në shkollë me makinë unë?

Perit i erdhi keq t'ia prishte.

— Do të të çoj unë ndonjëherë, — i
tha.

— Kur?

— Kur të jetë shumë ftohtë.

— Edhe kur të jem ndonjëherë me von-
nesë?

— Edhe atëherë.

— Shumë mirë.

Makina e la pas Tiranën dhe shigjeta e kuqe e shpejtësisë e ngazëlleu edhe për disa caste Arditin, pastaj ai përnjëherësh u tullat.

— Të zuri gjumi? — pyeti shoferi.

Djali nuk foli, por ngriti dorën dhe bëri një gjest mohimi.

— C'pate, Ardit? — pyeti Fatbardhi, sepse iu duk sikur djali qe zverdhur.

Djali nuk u përgjigj.

— Të turbulloi makina? — pyeti shoferi si i zënë në faj. — Ja, po i jap më ngadalë.

— Qëndrojmë pak, — tha Fatbardhi pak përpara se të hynin në një urë. Fatbardhi doli dhe hapi derën e parë për të zbritur djali. Ardit i lëvizi me vështirësi dhe, apo doli jashtë, nisi të villte. Shoferi rendi t'i mbante ballin.

Nga gryka e lumit frynte një erë e freskët. Fatbardhi pati merak se mos i ftohej djali.

— Si je tani?

— Mirë, — belbëzoi ai.

— Hyjmë në makinë se do të ftohesh, — tha shoferi.

Hynë në makinë. Fatbardhi u ul në vendin e parë dhe e mori të birin në prehër.

Ai u tulat i téri në gjoksin e tij. Qëndruan të heshtuar pér pak caste.

— Si do t'ia bëjmë? — tha shoferi.

— Nisemi, — tha Fatbardhi, — apo jo, Ardit? Po na pret gjyshja! — dhe pa orën. Kishte ende kohë.

Shoferi nisi t'i jepte më ngadalë. Pemët anës rrugës mezi kalonin të plogështa. Të gjitha gjethet qenë rrëzuar dhe degët e zhveshura tundeshin ngadalë. Kjo ngadalësi i njalli një ndjesi të keqe Fatbardhit.

— Më shpejt! — tha. — Mos shkojmë me vonesë.

Shoferi, si me faj, pa nga djali dhe hesh ti.

— Nuk ka gjë. Më duket se tani e ka zënë gjumi.

Arditi volli edhe dy herë të tjera dhe u detyruan të ndalonin në një burim anës, rrugës. Kjo ishte ndalesa e fundit, pastaj hynë në qytet.

— Më mirë të mos e kisha marrë, — foli i penduar Fatbardhi.

— Makina është e keqe, kur të zë, — tha shoferi.

— Ka disa muaj që s'kemi qenë te nëna e, meqenëse na doli një punë, mendova t'ia çoja dhe djalin.

— Po ta dija, do të kisha treguar kujdes më të madh në fillim,

— Nuk ke ç'i bën. Një shokun tim një-herë e ka zënë autobusi i linjës Bankë-Kino-studio! — qeshi Fatbardhi dhe tregoi shtë-pinë e nënës. — Këtu.

Arditi qëndronte i tulatur në gjoksin e të atit, gjysmë i fjetur-gjysmë i lodhur, me ngazëllimin tashmë të tretur brenda zverdhjes së tij.

— Ardit! Çohu! Erdhëm te gjyshja!

Arditi zbriti nga makina duke ecur me vështirësi. Shoferi nuk donte të ngjitej lart, po Fatbardhi e kapi për krahu.

— Hajde, se nuk do të vonohemi!

Në shtëpi qëndruan sa për të bërë qokën, sepse nëna u merakos aq shumë, sa edhe qerasjen e bëri ngatërruar.

— Mos ma vini re mua plakës, por djalin më të mos ma marrësh në makinë, dëgjove? — i tha ajo Fatbardhit. — Do ta sjell vetë në Tiranë, me tren! Nuk e lë të ma katandisësh kështu!

— Hajt se nuk ka gjë! — u përpoq ta qetësonte Fatbardhi, duke zbritur shkallët bashkë me shoferin. — S'ka ngjarë nga ne. Do të ketë ngjarë nga e ëma.

Por ajo s'e kishte fare mendjen për shaka. Nuk i dëgjoi fjalët e fundit, se qe kthyer ndërkaq te djali i vogël, që, në mungesë të të atit, e paraqiste edhe më dramatike gjendjen e tij.

Fatbardhi ktheu kokën dhe nuk ë pa figurën e imët të nënës në krye të shkallëve. Atëherë iu krijua brenda vetes një boshllëk malli. Ky mall e shqëroi tërë kohën kur vërtitej që të mbaronte punën. Ndoshta prej kësaj u ngut të kthehej sa më parë në shtëpi.

Shoferi nuk pranoi të ngjitej për herë të dytë. I tha se do ta priste pak më poshtë, të mapoja qëndrore, sepse donte t'u hidhte një sy dyqaneve.

— Kur iki nga Tirana, s'kthehem pa u blerë ndonjë gjë të vogël fëmijëve, — u justifikua ai.

Fatbardhi nuk nguli këmbë dhe ngjiti shkallët vetëm. Shtëpia ishte mbushur plot me njerëz, qenë kthyer nga puna i vëllai, e shoqja. E éma i doli para e merakosur ta takonte.

— Mirë që erdhe, — tha ajo.

— Ç'ka ngjarë?

— Djal...
— Djali? Çfarë? Çfarë ka?!

— S'ka pushuar së qari që kur ike ti. Një minutë s'ka bërë rehat i shkreti.

Fatbardhi hyri në dhomën ku Arditin e kishin shtrirë për ta qetësuar dhe, pasi u përshëndet me të tërë, iu drejtua të birit që, sapo pa, u ngrit dhe iu hodh në qafë.

— Çfarë pate kështu?

— Asgjë. Do të më marrësh prapë në veturën tënde?

Fatbardhi e zbriti ngadalë në krevat dhe iu ul pranë.

— Po përse qave? — e pyeti duke i fshirë lotët. Ata kishin krijuar gjurmë në faqe, si përrenj të tharë.

Djali kështi.

— U mërzite që ika unë? Po unë kisha punë!

— Jo. Nuk u mërzita.

— Atëherë përse e mërzit nënën? A nuk m'u lute vetë para se të niseshim, a nuk m'u lute të të merrja me vete?

— Po. Po unë nuk u mërzita as me ty, as me nënën. U mërzita me veten time.

— Me veten tënde?! — i erdhi për të qeshur Fatbardhit.

— Kollaj është të të zërë makina?

— Jo. Kollaj nuk është, po burrat durojnë! — tha dhe i erdhi mirë që djali kishte sedër.

— Pa mendo, o babi, — tha Ardit, që e ndjeu zbutjen e të atit. — Të kesh makinë e të mos e gëzosh dot! Nuk shkon dot me veturën tënde as në plazh, as në shkollë, as te nëna, se të trazon, ja këtu! — vuri dorën ai në stomak. — Ç'më ka gjetur!

— Si?! Si?! — Fatbardhi nuk e mori vesh se si u ngrit i téri vetëtimthi në këm-

bë dhe se si i mbeti dora nderë në hapësirë, drejt të birit. Kishte dashur ta qëllonte, por qe përbajtur në çast. — Për këtë qave?! Kjo qenka fatkeqësia e madhe që të paska zënë?! Turp!

Aj donte t'i fliste më gjatë, t'i shpjetonte se makina nuk ishte e tij, por e punës, donte t'i thoshte se, po të kishte qenë babai i Arditit agronom, mund të bridhë fshat më fshat edhe me kalë, por nuk i tha gjë. Doli nga dhoma duke përplasur derën.

— Mos u mërzit, se kështu e kanë fëmijët, — u përpoq ta qetësonte nusja e të vëllait, kur e pa ashtu të zemëruar.

Fatbardhi erdhi vërdallë i heshtur në-për kuzhinë. Pastaj u ul dhe ndezi një cigare. E ëma i ndenji përballë. E pa ashtu të menduar dhe u përpoq të gjente ndonjë fjalë për ta qetësuar. Ngaqë nuk e gjeti dot fjalën, u përlot. Që ai të mos shihë lotët, u ngrit të bënte një kafe.

— Ma lër mua djalin se e shëroj tak-fak, — i foli ajo nga aneksi, duke i shqiptuar fjalët ngadalë, të ndara nga njëratjetra.

— Djali nuk ka asgjë! — tha Fatbardhi prerë. — Asgjë! Po të duash, ma bëj gati, se do ta marr që tanë.

— Si, ashtu sëmurë?! — u çudit nusja e vëllait.

— Jo sëmurë, por fatkeq! — saktësoi Fatbardhi, por ata nuk e morën vesh.

Nëna fshiu lotët me cepin e përparëses dhe iu shfaq përpara që ta merrte vesh.

— Si kështu? — pyeti.

— Nuk ka asgjë, e them me tërë mend, — i ra për shkurt ai, pa ditur si të shpje- gohej. — Dhe nëse e troshit një çikë rruga, mirë i bën!

Kafen e pinë në heshtje. Nëna vuri re se ai ishte shumë i menduar.

— Mos të lodhin shumë punët, o 'bir? — pyeti ajo me një zë të ngarkuar me me- rak dhe mall.

— Jo, — e qetësoi ai.

«Puna nuk më lodh, — mendoi ai me vete duke përshëndetur nga oborri nënën dhe mbesën e vogël, që sa kishte mësuar të përshëndeste me dore. — E di që tani në detyrën e re do të kem më shumë punë, shkresa, shërbime, tension. Po ti, moj nënë, nuk e di se mua më janë shtuar punët edhe në shtëpi. Duhet të kujdesem për një mijë gjëra të vogla që më ngatërohen tani në- për këmbë, si për shembull im bir, si për shembull rehati i një vture, si për shem- bull...»

Ai pa se Arditë e kishte pranuar në heshtje këtë ikje të nxituar. Ndoshta qante pa zë. E ndiqte dy hapa më pas si manar.

Fatbardhi nuk i tha asnje fjalë tërë atë copë rrugë deri te mapoja.

Shoferi priste brenda në makinë. Ai kishte blerë një prefëse lapsash në formën e anijes me vela për djalin dhe një karfice në formën e luledales për vajzën e vogël.

XIXËLLIMAT E NATËS SË FUNDIT

Ora tringëlliu.

Tingujt e ziles e shkundën plogështinë që sjell në dhomë prania e një njeriu që fle. Bajamja e kuptoi se edhe ajo kishte dremitur duke punuar me shitiza një triko leshi për të shoqin, që flinte, dy hapa më tutje, duke marrë frymë lehtë e lehtë. Fërkoi sytë, la mënjanë shtizat dhe u ngrit.

Ishte ora pesë.

U ngrit edhe xha Diku. Kishte më shumë se tridhjetë vjet, që ngrihej në këtë orë, një herë në tri ditë, sa herë që kishte ndërresën e natës.

Diku po u afrohej të gjashtëdhjetave.

«Përditë kam bërë këtë avaz, — mendoi. — Ngrihem, vishem, ja kështu si sot, pastaj ulem dhe, ha pak bukë me Bajamen përkarshi.»

Ai asnjëherë nuk e kishte pasur zakon të vriste mendjen, të arsyetonte gjatë, ose, siç thoshte një nipi i tij student, në biseda, «të filozofonte». Ai kishte jetuar qetë, kishte

vrarë mendjei, dhe zgjidhte ato halle që i dilnin nëpër këmbë gjatë ditës, shumë-shumë gjatë viti. Këtë gjë ai kishte ditur ta bënte me lehtësi dhe pa bërë «ububu». Megjithatë këtë natë seç ndjeu vetveti një «ububu» diku brenda vetes, njëfarë alarmi që nuk e kuptonte përsë i vinte.

Për herë të parë këtë natë të freskët shtatori Diku ndjeu mbi shpinë peshën e viteve.

Jashtë era vërvshëllente dhe pikë të mëdha shiu binin në dritare me trokëllimë.

«Sa vite kanë kaluar», mendoi ai duke u ulur i heshtur në tryezë dhe me vështrim ndiqte lëvizjet e së shqes. Ishin lëvizje që përsëritheshin për të tridhjetin vit me radhë. Ajo merrte nga dollapi bukë, vinte aty diçka që kishte përgatitur më parë dhe e mbësh-tillte me gazetën e dy javëve përpara.

«Edhe lëvizjet e saj janë ngadalësuar», mendoi. «U plakëm.»

Bajamja i bënte të gjitha lëvizjet e hesh-tur.

— Ku janë djemtë? — pyeti Diku.

Gruaja ngriti kokën e befasuar. Me sa duket, ngase u prish rregulli. Žakonisht këto çaste kishin kaluar në heshtje.

— Djemtë?! — pyeti kot ajo.

— E, moj, pse çuditesh? Djemtë, them, ku janë?

— Petriti është në turnin e dytë, Bu-

jari ka dalë shëtitje me shokët. Agimi me nusen ka vajtur nga krushka.

— Shëtitjë nëpër shi?! — pyeti ai dhe u pendua në çast. «Nuk janë të gjithë gjash-tëdhjetëvjeçarë si puna jote, plakush!» i tha vetes.

Pastaj përsëri u bë heshtje. Vazhduan lë-vizjet e njohura. Gruaja futi bukën e mbësh-tjellë në trastë, hodhi aty edhe një kokërr mollë të madhe të kuqe dhe ia la mbi tryezë.

Diku u ngrit dhe shkoi te dritarja. Nuk e kuptoi përse donte ta prishte rregullin e veprimeve. Çudi, për herë të parë e ndjeu yeten shumë ngushtë brenda asaj rregullsie që kishte zënë në udhën e shinave. Si një lëvizje e detyruar në udhën e shinave.

Hapi perden e bardhë borë, të qëndisur me dantella dhe pa shiun. Jashtë; në rrugë, ishte indezur një dritë, por ajo nuk dukej e verdhë. Ishte diçka e përafërt me blunë. Flutura nate rrëth e qark saj nuk kishte. «I lag shiu», mendoi.

— Çfarë ke kështu? — e pyeti Bajamja me një zë të merakosur e të dhembsur.

— Pse? — pyeti ai. — Çfarë po bëj?

— Sesi më dukesh, — u përgjigj Bajamja. — Ndryshe nga herët e tjera.

— Nuk kam asgjë, — e mbylli ai bis-e-dën dhe shkoi përsëri te tryeza. Mori në dorë trastën e bukës. Pastaj, pasi veshi xhaketën blu dopiopetë, doli. U kujtua se njëherë e

një kohë kjo xhaketë kishte qenë e kostumit të dhëndërisë, që tani e vishte për punë.

«Kështu vjetrchet edhe njëriu,» mendoi dhe preku bërrylin e ngrënë nga të fërkuarit.

Përsëri iu duk e çuditshme dhe një si lëmsh iu mblodh në grykë. Kishte filluar të mendonte të thella. Kjo ishte e pazakontë për të. Nuk dinte çfarë të thoshte, nuk dinte si ta shpjegonte. Puna ishte se ndiente dëshirën të mendonte, vetëm të mendonte.

Eci nëpër shi. Çadrën nuk e hapte dot, se kishte shumë erë. Flokët iu vesuan lehtë e ai ndjeu kënaqësi prej kësaj.

Në stacionin e trenit kishte shumë njerëz. Ai kaloi përmes tyre, dy fëmijë që luanin cekash iu ngatërruan nëpër këmbë dhe shkoi në zyrën e inspektorit të shërbimit.

— Hajde, xha Diku, — e ftoi një makinist i ri. — Hajde, afrohu te soba. Qenke lagur.

— Sot ndezëm sobën për herë të parë. Me sa duket, dimri është në prag të derës; — tha shefi i stacionit, që ishte përkulur mbi një grafik. Po Diku e dëgjoi nëpër tym, sepse kishte atë turbullirën brenda vetes. Nuk përqendrohej dot.

Pranë sobës nisi të mendonte.

«Sa dimra ke kaluar kështu, o plak?»

Dhe po vetë u përgjigj.

«E ku numërohen!»

— Mirëmbërëma, xha Diku! — i foli

ndihmësi, duke i ardhur afër. — Nuk do të pish një kafe? Treni ynë nuk ka ardhur akoma. Do edhe gjysmë ore.

— Jo, të falemnderit, — tha Diku dhe sytë i vajtën te flaka e sobës. Zjarri brambullinte duke i dhënë një refleks të kuq gjithçkaje përreth. Edhe ky refleks iu duk i çuditshëm.

«Çfarë ke kështu, o plak? — pyeti ai përsëri veten. — Çfarë ke?»

Ne mendje i erdhi përsëri mendimi se tërë jetën kishte jetuar fare pak gjëra të veganta dhe iu duk vetja i varfër, shumë i varfër.

E tërëjeta e tij kalonte nëpër disa pikatë domosdoshme dhe të pandryshueshme. Zgjimi në orën pesë, ngritja nga shtrati, kafja dhe dalja nga shtëpia për në punë. Atje, pasi punonte në ndërresën e tij, një herë ditën dhe një herë natën, kthehet në shtëpi, flinte për t'u çlodhur dhe ngrihet. Jeta e tij familjare ishte tepër korrekte. Biseda të shkurtra me gruan vizita të shkurtra te të gjithë miqtë, pak biseda të shkurtra me fëmijët dhe kaq. Vëtem kaq.

«Pak paske jetuar, o plak. — i tha vetes. — Në gjithë këto vite të jetosh kaq pak gjëra.»

Një ndjenjë e hidhur e pushtoi të-tërin. Ç'ishte kjo vorbull e tërbuar mendimesh që i vërvitej në kokë? Ç'ishte ky zakon i

pamëshirshëm i njerëzve pér të arsyetuar
veprimet e tyre?

— Ai u ngrit pér ta larguar mendjen nga
tërë këto gjëra që kishin nisur ta acaronin.

— Hajde, — i tha ndihmësit, — do të të
jap një kafe.

Ndihmësi i shkoi pas, po nuk e la të
paguante.

— Të thashë unë që qëparë! — kundër-
shtoi ndihmësi, duke i futur përsëri në xhe-
pin e Dikut paratë që kishte nxjerrë.

Diku mori i heshtur kafen dhe shkoi në
njëren nga tryezat te dritarja. Ndihmësi e
ndoqi pas. Jashtë shiu binte me pika të
mëdhë. Në dritaret e klubit pikat formonin
vizatime të çuditshme duke rrëshqitur.
Ndihmësi rrufiste i heshtur kafen. Dikut
nuk i pëlqeu kjo heshtje. Edhe pak ai do
të futej përsëri në ngatërresën e arsyetime-
ve dhe kio gjë e trembte.

— Më thuaj ndonjë gjë, — i tha ndih-
mësit.

— Ndihmësi e pa i çuditur.

— Çfarë të them? — ngriti supet.

— C'të duash! — i tha Diku.

Ndihmësi buzëqeshi lehtë.

— Po të them diçka kot. — shtoi. —
Sot në mëngjes takova një tezen time dyzet-
vieçare. Ajo është e pamartuar. E di çfarë
më tha?

— Pa hë?

— Ajo më tha se në vitin pesëdhjetë e një
në qytetin tonë kishte pasur gjashtë vetëvras-
je për çështje dashurie. Kurse sot asnje. Ajo
punon në zyrën e varrezave. Sipas saj, kjo
është dëshmi e faktit se njerëzit kanë filluar
të mos besojnë shumë te dashuria, ose të
bëjnë dashuri të lehtë.

Diku qeshi me të madhe dhe e vazhdoi
të qeshurën me vrull e gulç, sikur shfrynte
ndonjë lokomotivë me qymyr. Edhe ndih-
mësi qeshi pas tij.

— Po ti, — e pyeti ndihmësin, kur së-
rish u bë serioz, — a bën dashuri?

Ndihmësi e pa në një mënyrë kuptim-
plotë.

— Bëj, — i tha me druajtje.

— Është ndonjë vajzë e mirë?

— Po... si të të them... Mua më duket
e mirë!

Diku u mendua për një çast.

— Bëj dashuri! — i tha. — Përderisa
jeton, bëji të gjitha. Edhe punën, edhe da-
shurinë, edhe... Sé do të vijë dita e do t'i
biësh kokës. Do të thuash: si më iku kështu
jeta nëpër duar. Pse jetova kaq pak gjëra.

Ndihmësi e pa i çuditur.

Diku e kuptoi se nuk mund të largohet
dot nga ai mendim që kishte zënë ta shqetë-
sonë. Çfarëdo bisede që të bëhej, ai e kup-
toi se patjetër do të përfundonte në këto

dreq filozofirash, ndaj e la vetë të lirë në mes tyre.

— Ikim, — tha.

Ndihmësi e ndoqi pas. Ai nuk e kishte parë asnjëherë ustanë në këtë gjendje. Bile atij iu krijua përshtypja se sytë i kishte të lagur. Ndoshta ishte ndonjë pikë shiu.

Diku doli jashtë në peron dhe qëndroi nën pikat e rralla të shiut. Që larg u dukën dritat e trenit që afrohej me zhurnë. Ndoqi me sy afrimin e tij. Në vesh i kumboi ritmi i rrotave.

Trak-trak, trak-trak, trak-trak, trak-trak!

Ky ritëm i hyri nëpër trup dhe, kur ishte duke hipur në lokomotivë, iu duk se u bë një me ritmin e rrahjes së zemrës.

Trak-trak, trak-trak, trak-trak-trak!

Edhe zemra rrihte me të njëjtin ritëm.

I heشتur, Diku mori në dorëzim lokomotivën, pastaj lëvizi reversin dhe dorezën e kontrolerit dhe e nxori para vagònëve. Ishte treni i fundit i udhëtarëve. Në një udhë të largët malore.

Manovruesit lëviznin nëpër shi, diku tutje, fenerët. Ishte një gjë e bukur të shihje se si xixëllonte, përmes shiut, drita e lagur e fenerëve të tyre,

Dikù nxori kokën të shihte sinjalin. Një pikë e madhe shiu i ra në faqe. Atij i bëri përshtypje sa shumë njerëz kishte në peron, që lëviznin grumbuj-grumbuj; disa hipnin

nëpër vagonë, disa zbritnin, të tjerë prisnin e përcillnin të afërmit dhe Diku e dinte se, kur të nisej treni, pas do të ngelnin disa duar të ngritura lart, që përshëndetnin edhe përmes shiut dhe në çast në kokë i buisi një mendim tjetër.

«Sa njerëz ke lëvizur në jetën tënde, o plak?» Këtë pyetje e bëri me një ton entuziast, gati-gati fëmijëror. «Se njerëzit lëviznin për punë, se njerëzit kanë edhe mall e dashuri për të tyret, se njerëzit sot janë shpërndarë në të katër anët dhe ti, o plak, u ke shkurtuar kilometrat, duke i tërhequr përditë drejt njëri-tjetrit...»

— Usta.. U hap sinjali, — i foli ndihmësi.

Diku pa sinjalin e gjelbër përpara lokomotivës. Andej nga fundi i trenit u dëgjuat një vërvshëllimë e gjatë bilbili dhe disa fenerë qenë ngritur lart e drita e tyre thërrmohej përmes shiut.

Xha Diku i ra sirenës, pastaj shfrenoi lokomotivën dhe ngadalë rriti shkallën e gazit të kontrolerit. Lokomotiva filloi të lëvizte përpara.

Trak-trak-trak.

Përpara shfaqej udha e lagur. «Kur bie shi, shinat seç marrin një ngjyrë kafe të trishtuar, të errët. Ngaqë lagen traversat.» Mirëpo Dikut për herë të parë atë natë kjo gjë i bëri përshtypje.

«Plak matuf, — e shau veten, — çfarë
të ka gjetur sonte kështu? Ç'janë këto gjëra
që sheh e sjell ndër mendje?»

Po sado-sado, prapë aty u rikthye.

Trak-trak, trak-trak, trak-trak.

Ai e ndjeu se sa i afërt i ishte bërë ky
ritëm gjatë gjithë jetës. Gjithçka e jetës së
tij lëvizte brenda këtij ritmi, brenda këtyre
shinave të ndriçuara nga dritat e para të
lokomotivës.

«Jam gjashtëdhjetë vjeç, — mendoi Di-
ku dhe ndjeu një lodhje diku brenda tij. —
Jam gjashtëdhjetë vjeç.»

Pastaj heshti duke parë rreth e qark se
si çante drita përmes errësirës. Kjo ndodhte
vetëm në një distancë prej njëqind-dyqind
metrash, sepse më tej kishte përsëri errë-
sirë.

«Po të bëj një hesap, kështu me mend, i
bie që nga 1000 pasagjerë në ditë të kem
térhequr për tridhjetë vjet... — ai bëri ca
llogari të rrumbullakosura me mend, — i
bie të kem térhequr tre milionë njerëz.»

Ai e mendoi këtë fakt me një ndjesi
triumfi. Iu duk se nuk është gjë e vogël që
gjatë gjithë jetës të kesh shkurtuar kilomet-
rat midis tre milionë njerëzve, t'i lëvizësh
ata drejt dashurisë dhe hallit shëndoshë e
mirë. Dhe duke dashur të kundërshtonte
mendimin e parë që i kishte shkrepur në
kokë, tha me vendosmëri:

«Shumë ke bërë, o plák. Nuk është kllaj të kujdesesh për tre milionë njerëz! — Dhe po vetë e kundërshtoi. — Po ndoshta, ndoshta edhe kjo është shumë pak!»

Ritmi i rrotave vazhdonte i prerë.

Trak-trak, trak-trak, trak-trak-trak!

«Jo, — tha përsëri, — nuk është pak... Ka njerëz që u bie të jetojnë ngjarje të mëdha e të bujshme, ka të tjerë që jetojnë vetëm gjëra të zakonshme dhe përsëri diçka kanë bërë. Nuk është pak të jetosh me gëzimet dhe shqetësimet e tre milionë njerëzve. Se të jesh makivist, nuk është punë dokudo. Të jesh makivist do të thotë...»

Ai ndjeu një shtrëngim në gjoks. Vuri dorën aty.

«Mendova shumë, — tha me vete. — Nuk bën! Mendimet të lodhin. Aq më tepër këshitu si puna ime, që më ka shkrepur në kokë të sjell ndër mend tërë jetën...»

Ai psherëtiu një herë thellë dhe pa përsëri rrugën. Shpeshherë atyre u dilnin lepuj përpara. Ndonjëherë, te xhamat e lokomotivës, përplasej i hutuar ndonjë zog nate. Këtë natë rruga ishte e lagur nga shiu dhe asgjë nuk dukej.

Në mendjen e Dikut ishte vendosur një peshore. Ai e ndjeu se përballë njëra-tjetrës rëndopin dy gjëra. Në njérën anë shqetësimi se kishte bërë një jetë të rëndomtë, në anën

tjetër ajo shifër tremilionëshe. Njëherë Diku kishte dëgjuar se shifrat janë kokëforta. «E ka thënë Lenini», u kujtua. Prej kësaj iu kujtua edhe një thënie e Stalinit: «Trenistët janë kocka e proletariatit.» «Nuk e ka thënë kot», mendoi.

Në mendje iu shfaq një lokomotivë e vjetër me qymyr. Mijëra shkëndija shpërndaheshin gëzueshëm nëpër errësirë. Lokomotiva shfrynte. Qomyri digjej. Digjej në mijëra xixëllime të bucura, për të lëvizur përpara lokomotivën.

Pastaj Diku kaloi një kohë të gjatë në një gjendje pezulli, duke ndjekur këto xixëllime që krijonin lule të kuqe përmes natës së lagur nga shiu.

«Nuk janë xixa, — i shkrepi në kokë. — Nuk është qymyr. Është jeta e njeriut që feks në errësirë. Është jeta e njeriut që digjet për të lëvizur përpara trenin me një mijë njerëz...»

Ky ishte mendimi i fundit që i erdhi në kokë, sepse më pas mbizotëruan përsëri xixat e qomyrit, që shpërndaheshin gëzueshëm nëpër errësirë. Herë-herë ato i dukeshin si fishekzjarrë, herë-herë i kujtonin xixëllonjat e fëmijërisë. Ky përfytyrim e kjo kënaqësi zgjatën për një kohë të gjatë, derisa ai vdiq.

Ndihmësi vuri re se si ustait dalëngadalë

po i varej koka sikur kërkonte të mbështetje mbi gjoks.

— Të zuri gjumi, usta? — pyeti ai lehtë-lehtë, si të kishte frikë mos e zgjonte.

Xha Diku nuk iu përgjigj. Ndihmësit iu duk e çuditshme, ishte hera e parë që e shihte ustanë të dremiste gjatë udhëtimit.

«Është lodhur, — mendoi. — Nuk i thonë pak. Një jetë e tërë mbi shina. Dhe si kalojnë vite, pa i ndier. Unë mezi dua ta besoj se m'u bënë katër vjet në hekurudhë.»

Ndihmësit iu kujtua se në një mbledhje e kishin propozuar Dikun për ta dekoruar.

«Ka punuar shumë», mendoi përsëri, duke iu afruar lehtë për ta zgjuar.

— Usta! — i tha duke e prekur në sup.

Koka e Dikut u lëkund fare lirshëm. Ndihmësi pa i merakosur.

— Usta! — i tha përsëri dhe i preku ballin.

Tërhoqi dorën i trembur. Balli ishte i ftohtë akull. Ai vuri re se Diku i kishte sytë të hapur.

«Paska vdekur, — i vetëtiu në kokë ky mendim, duke i alarmuar tërë qenien. — Paska vdekur!»

— Usta, — bërtiti përsëri i ngashëryer. — Usta!

Nuk dinte çfarë të bënte. Erdhi njëherë vërdallë nëpër kabinën e ngushtë. Rrotat vazhdonin ecjen më ritmin e zakonshëm.

Ndanë rrugës feksnin dritat ngjyra-ngjyra
të fenerëve. U përqendrua për një çast. Pa
shinat e lagura dhe diku larg stacionin.

«Kam shumë njerëz mbi vete», mendoi
dhe i nguli vështrimin rrugës.

Hodhi edhe një herë shikimin nga Diku.
Ai qëndronte i palëvizur, i heshtur.

«Duhet bërë diçka për të!», vendosi ndih-
mësi dhe i ra sirenës. Dhe nuk e pushtoi deri
në stacion ku ndaloi.

«Kjo do të jetë për të përshëndetja më
e mirë», mendoi i përlotur.

Treni rrëshqiste mbi shina me rritmin e
zakonshëm.

Trak-trak-trak-trak, trak-trak-trak!

UNË DHE MEFISTOFELE

Në cep të portit është një rubinet me ujë të pijshëm. Unë qëndroj aty dhe furnizoj anjet. Është një punë fare e lehtë. Diku pranë rubinetit është një vend ku lidhen cimat. Ajo është «lozha» ime, ku qëndroj ulur tërë ditën dhe shoh detin, pulëbardhat, anjet që vijnë. Flamurë të ndryshëm në sytë e mi. Gjuhë të ndryshme në kokën time. Unë përpinqem të merrem vesh me atë pak anglishtë që di. Fjalën «water» nuk e kam harruar... Uoter, uoter! — sikur vinin nga shkretëtira këta njerëz. Uoter, uoter! Unë u jap ujë nga oazi im... Ata më pyesin diçka edhe më shumë në gjuhë të tjera, por unë bëj sikur nuk i dëgjoj. Pikërisht atëherë vendos që t'i rikthehem edhe një herë anglishtes. Kështu shkova te Stavri... Stavri di shtatë-tetë gjuhë të huaja...

Pasdite për pasdite shkoj tek ai. Stavri është beqar. Pesëdhjetëvjeçar. Ai ka vetëm një dhomë, të rrethuar të tërën me libra dhe një aneks të ndarë me një perde. Përfytironi një kënd fare të qetë. Rreth e qark

librat ngjyra- ngjyra të marrin mendjen. Ti shkon dhe shfletón disa prej tyre. Ka aty çfarë të duash. Histori spiunësh, dashuri kalorsiake, poezi, aventura kozmike e detare, Përrallat e Një Mijë e Një Netëve, libra me enigmat e mbarë njerëzimit... Të mund të zgjedhësh cilin të duash dhe të zhytesh në një botë tjetër misteresh...

— *I want to be a sailor...* — të thotë Stavri.

«Unë dua të jem marinar», të përkthehet vetveti në mendje.

— *I want to see a beautiful country, where people are happy!*

— «Dua të shoh një vend të bukur, ku njerëzit janë të lumtur.»

— *It is Arcady!*

— Kjo është Arkadia!

— *La terre promesse, says the Frenchman.*

— Toka e premtuar, thotë francezi.

— Dhe francezi e ka marrë nga Bibla,

— të sqaron Stavri. Dhe ti mëson se ç'është Arkadia. Natyrisht, sipas Biblës, sepse ajo nuk ekziston.

Stavri vë re një pakënaqësi që ke ti, ngaqë përmendet Bibla dhe ndërhyjn:

— Po ti mos i kushto asnje rëndësi përbajtjes. Rëndësi ka të kuptosh konstruktin e gjuhës, leksikun, format gramatikore e të tjera e të tjera. Sepse këta libra janë

bërë pér vendet, ku njerëzit besojnë te zoti. Ti i ke parë vetë marinarët e huaj me kryqe në qafë. Aty janë shpresa dhe shpëtimi i tyre.

Këshfu thotë Stavri dhe mua ato çaste më kujtohet se, kur ishim të vegjël, dilnim buzë detit dhe fantazonim me orë të tëra. Nisnim një velë nëpër hapësirat e mëdha duke kërkuar aventurën. Në fillim mendonim se do të zbulonim foka të reja. Më vjen pér të qeshur kur kujtoj se sa shumë u mërzitëm një ditë në orën e gjeografisë, kur mësuam se tokat e reja qenë zbuluar të gjitha. U mërzitëm shumë, po prapë e besuam se diçka kishte mbetur pér ne. Diçka prej heroï.

Unë ia tregoj këtë Stavrit dhe ai qesh. Shton edhe dy gjëra të tjera, pastaj kalon në një temë tjetër. Dhe rikthehet te mësimi.

— *I want to be a sailor!*

— *All right!* — thotë ai, duke tundur kokën.

— *I want to see a beautiful country, where people are happy!*

— *Fine! Go on!*

— *It's Arcady!*

— Ti ke pér ta mësuar anglishten shumë shpejt, — e përfundon ai mësimin dhe nxjerr një tabaka kú ka fiq të thatë, një dopio konjak dhe amarëta.

— Nuk dua, — i them, por ai ngul këmbë.

Atëherë marr dhe uroj. Gjithmonë kur uroj atë, jam i kujdeshëm se mos them pa dashje urimin «në dasmë». Ai është i pashpresë në këtë drejtim dhe unë kam frikë se mos fyhet.

Nejse.

Një ditë unë piva dy dopio konjak dhe vajta të prisja Mirën. Ajo më foli rëndë, por edhe unë se ç'i thashë diçka fyeze dhe ajo iku e zemëruar.

Të nesërmen më vinte turp ta takoja. Por ajo erdhi vetë e më takoi duke qeshur me të madhe me pozitën në të cilën isha ndodhur unë një natë më parë. Kjo e qeshur më vrau shumë, më shumë se dhjetë qortime bashkë.

Vendosa që të mos pija më, po ku të linte Stavri. Pas çdo mësimi vinte një dopio konjak. Pas konjakut vinin bisedat për gjerrat e përditshme. Unë atëherë i tregova peripecitë e jetës sime të paktë. I thashë se, kur isha në maturë, ëndërroja të bëhesha arkitekt. E drejta e studimit më doli për inxhinier minierash. Unë shkova vitin e parë për të mos ua prishur njerëzve të shtëpisë dhe të fisit që më bënин agitacion. Ngela që vitin e parë në vjeshtë. Në vjeshtë nuk u paraqita fare në provim dhe kështu përfundova në këtë punë duke pritur sa të shkoja ushtar.

— Tranzit! — më tha Stavri.

— Tranzit, — iu përgjigja unë dhe më pëlqeu kjo fjalë.

— Mos u mërzit, se çdo njeri tranzit është në këtë jetë! — qeshi ai dhe shtoi me zë të ulët: — Por mos ia thuaj njeriu, se të gjithë duan ta mbajnë sekret!

Dhe përsëri qeshi me një zë bubullues.

— Unë e dija që diçka të ka mbetur pishman, — më thotë ai më pas seriozisht.

— Kur njeriu ka diçka mangët, ia rrezatojnë sytë.

«Unë paskam sy radioaktivë!» mendova dhe më erdhi për të qeshur.

— Megjithatë është normale. Hajde, të shkuara! — dhe toku gotën e konjakut me gotën time.

— Ti po më thua sikur të kem qenë sëmurë.

— Mërzitja është sëmundja më e madhe të njeriu, — tha ai më seriozitet. — Kanceri nuk është asgjë para saj. Në të gjitha sëmundjet të dhemb këmba, dora, syri, a ku-shedi se çfarë, kur mërzitesh të dhemb shpirti.

Stavri di shumë gjëra.

Cudi. Njeh një njeri. Në fillim nuk ke asnë mendim për të. Më përpara, bile, as nuk e di se ka ekzistuar diku. Dalëngadalë ai hyn në jetën tënde. Ty të duket se nuk bën dot pa të, se ke një shekull të tërë që

e njeh dhe të duket e çuditshme që nuk e ke takuar më përpara.

Stavri të hyn në zemër, do apo nuk do ti. Ai ka shumë humor, di të thotë sentenca e të tregojë barceleta. Të kupton kur je i mërzitur dhe bën qështë e murdur ta kapërcesh këtë mërzitje. Shpesh, megjithëse është shumë më i madh se unë, ai më bën edhe biseda moshe. Ka një aftësi të çuditshme që të t'i kuptojë mendimet. «Nga sytë, — thotë ai, — sytë rrezatojnë.» Dhe ku ta gjesh një njeri që të kupton hallin! Kur vënë dy veta shpatullat për ta mbajtur një hall, natyrisht, ai bëhet më i lehtë. Kështu hyri Stavri në jetën time. Ai më fliste herë-herë për gjëra të ngjashme me ato që ndodhnin tek unë dhe më jepte të kuptoja së unë nuk isha i vetëm, nuk kisha pse mërzitesha për ndonjë gjë që s'shkonte, se të tilla gjëra ndodhin gjithmonë në jetë.

Ai më pyeti një ditë edhe se si i kisha punët me dashurinë.

Unë u mata t'i flisja për Mirën, por u pendova. Vendosa të mos i thosha asgjë. Seç belbëzova disa fraza të errëta. Më duket se në fund iu përgjigja me atë zhargonin e rrugës: mëraste!

Ai e kuptoq që e gënjeva, por nuk më ngacmoi më në këtë pikë.

Mirës nuk i thashë asgjë për afërsinë që krijova dalëngadalë me Stavrin. Ajo vetë

seç kishte vënë re, por unë nuk ia zgjata. Pastaj me të takohesha vetëm një herë në javë, kur vinte nga Tirana në shtëpi dhe nuk kishim kohë të merreshim me të tjerë, përvèç vetes.

Një ditë, si zakonisht, vajta për të mësuar te Stavri. Mora mësimin e ditës dhe për ilustrim ai më la në dorë një revistë. Ishte një revistë mode.

— Mos i shiko figurat, — më tha. — Për kthe vetëm diçiturat e fotografive. Dua të provoj se sa je në gjendje të lexosh materialet e gjalla të gjuhës angleze.

— Trëndafil në çdo stinë. Seks, furri! Minifundi është më i miri, — lexova unë.

— Shumë mirë, — tundi kokën Stavri.

— Trëndafili i fshehur, që zbulohet vetëm një herë në një vend të vetëm, është më i miri, — thoshte diçiturá tjetër. — Seksi i natës, kaltërsia e fshehur nënre! Maksi-fundi është edhe më i mirë!

— Shumë mirë! Vazhdo!

Unë ngritë sytë dhe pas hënë dy vajzë, në pamje provokuese, që qëndronin përballë njëra-tjetrës, sikur bënë duel. Poshtë dy diçitura e shkruar një tjetër.

— Lexoje edhe këtë, — më tha Stavri.

— Ti qenke pothuajse gati-gati për të lexuar libra të plotë! —
— Zgjidhni çfarë të dëshironi. Kjo va-

ret nga këmbët. Firma X jua plotëson të gjitha.

— Nga këmbët, — tha Stavri me kënaqësinë e një beqari të plakur dhe unë mendova se ai duhej ta kishte problem në atë moshë punën e dashurisë. Sepse më trembin këta beqarët e plakur!

Por ai nuk më la të vazhdoja në këtë mendim.

— Mirë, — më tha, — ja edhe gjuhën e rifreskove. Kam përshtypjen se ke përparruar. Merr ndonjë libër me tregime për lexime të pavarura. Zgjidh vëtë në bibliotekë cilin të duash.

— Xhek Londonin! — thashë unë menjëherë.

Ai shkoi te raftet dhe më solli librin.

— Ta kam falur, — më tha. — Edhe puna e tij ishte e lidhur me detin si jotja. Deti është kudo njësoj i bukur.

Unë kujtova se në përfytyrimet e mia të fëmijërisë Xhek Londoni nuk kishte zënë vend. Padrejtësisht, mendova ato caste.

Stavri më kishte bërë gati gotën e konjakut.

— Urime, — më tha ai. — A dëshiron ta vazhdojmë bisedën tonë në anglisht?

— Jo, — thashë unë ngaqë më vinte zor.

— Si të duash. Por puna nuk duhet lënë me kaq. Gjuha e huaj nuk duhet lënë

pa përdorur. Ndryshe... Ja, ti i kishe mësuar një herë të gjitha këto që përsëritëm bashkë, por, ngaqë nuk i kishe përdorur...

— Besoj se do të kem rast, — thashë unë.

— Bisedo me cilindo, pa druajtje, — nguli këmbë ai. — Dhe shiko, për të mbajtur gjallë një gjuhë, duhet të kesh kontakte dhe të njohësh mirë edhe psikologjinë e njerëzve që e flasin. Duhet të njohësh atë që francezët e quajnë espri.

Unë e dëgjoja dhe nuk e merrja vesh se ku e kishte hallin.

— Do të më ndihmojnë librat, — thashë sa për ta bërë konkrete bisedën.

— Librat janë njëra anë. Njerëzit! Bota! Radioja! Televizioni! Për të mësuar mirë një gjuhë, duhet të mësosh vjersha përmendësh. Ritmi i tyre është tepër strikt dhe nuk të lë të gabosh. Dëgjo këngë, përpiku të kapësh fjalët përmes teksteve. Ja, për shembull...

Ai vuri një kasetë në magnetofon dhe u dëgjua një këngë e shtrirë dhe melodioze. Unë ktheva me fund gotën e konjakut. Tingujt e këngës më kujtuan Mirën.

— E merr vesh tekstin? — më pyeti.

— Jo, — i thashë.

Ai e ktheu përsëri. Unë u përqendrova.

When I find myself in times of trouble,

— tha me zë, duke ndjekur ritmin e këngës,

dhe unë, si mekanikisht, përktheva: — Sa herë jam i shqetësuar...

— *Mother Mary comes to me*, — vazhdoi ai.

— Nënë Meri vjen tek unë.

— *Speaking words of wisdom*.

— Duke thënë fjalë mençurie.

— *Let it be!*

— Le të jetë! — përktheva unë fjalë për fjalë.

— Jo. Kjo është idiomë, — më tha ai duke mbushur gotën e konjakut. Unë vura dorën përsipër, që të mos më hidhte më, por ai ma largoi miqësisht, mbushi gotën e tij të parën, pastaj timen. Me këtë krijoj barazinë dhe vazhdoi: — Kjo shprehje përkthehet më mirë në shqip «Mos çaj kokën.» Dikur ka qenë «*To be or not to be*»¹), sot është «*Let it be*».

Mua m'u duk interesante kjo loja e përkthimit të fjalëve, po Stavri u ngrit dhe mbylli magnetofonin.

— Është një kompleks i njobur, — tha ai. — Po kjo nuk ka rëndësi. Të pëlqen ndopak muzika? — shtoi.

— Jo shumë, — u përgjigja.

Po të më kishte pyetur atëherë se çfarë më pëlqente, nuk do të dija se si t'i përgjigjesha. Në atë kohë vërtitesha si varkë me

1) Të rrrosh a të mos rrrosh («Hamleti»).

vela nëpër erë, pa mundur ta hidhja spírancën në asnje liman.

Po pyetjet e tij ishin më të thjeshta.

— Po vajzat, të pélqeijnë? — më pyeti ai duke më shkelur syrin me çapkënllek.

— Sipas rastit, — iu përgjigja unë.

Kur pi, unë bëhem i heshtur dhe nuk bëj budallallëqe.

— Unë i njoh disa shoqe të tuat të maturës, — më tha.

«Pa shih, plakushi, mendova, na paska rënë në dashuri.»

Dhe po prisja nga çasti në çast të më thoshte se kishte rënë në dashuri me X vajzë që unë e njihja mirë. Ndoshta prej kësaj edhe ai më trajtonte me kaq dashamirësi. Po jo, doli tjetër gjë. Unë isha simboli i rinise së tij të humbur. Kjo gjë prekte edhe zemrën e bërë eshkë, si lëkura e mollëzave, të një pesëdhjetëvjeçari.

— Po cilën njeh? — i thashë me zë të lartë.

— Njoh, për shembull, të bijën e doktor Leksit.

«Gjersa flet për babanë, nuk është punë dashurie.»

— Duhet të njohësh ndonjë vajzë të mirë dhe... Mos më shiko mua! Pema i lidh frutat në stinën e vet. Unë jam pemë e vonuar, — dhe m'u duk se ai u mallëngjye, bile u përlot.

— Nuk dija çfarë t'i thosha.

Stavri më hodhi dorën në sup miqësisht.

— Më fal, — tha ai dhe fshiu sytë, që i shkëlqenin kushedi nga çfarë trishtimi. — Më fal! Ndoshëta e te prova! Unë e besoj atë që thotë kënga «*Let it be*», por ja që e lëshoj veten ndonjëherë. Më fal. Po ti shpeshherë më kujton rininë time të largët. Më kujton një moshë... një moshë... — ai nuk po gjente dot fjalë, — gati-gati prehistorike për mua...

E ndjeva që u qetësua, sepse buzëqeshi.

— Nuk ka gjë, — vazhdoi ai. — Është njerëzore. Njeriu i ka të gjitha. Edhe gëzimin, edhe brengën, edhe trishtimin, edhe kënaqësinë. Megjithatë diçka do t'i mun gojë patjetër në çdo kohë.

— Po t'i kishim të gjitha, do të ishim velur, — i thashë unë.

Dhe për të mos e rënduar, u ngrita të ikja.

— Po ikën? — vuri re ai. — Lëre se e shkela! Mos ma vër re, po ti duku sa më shpesh. Është tepër e rëndë të jesh vetëm, në moshën time.

Atë çast vendosa t'i shkoja një ditë vizitë me Mirën, por menjëherë hoqa dorë prej këtij mendimi. Po të më shihte me të, do ta kishte edhe më të rëndë.

— Do të vij, — i thashë dhe në kokën time vendosa të shkoja vetëm.

Kur ia tregova Mirës, ajo u prek. Në fakt, po ta mendosh kështu, vëtmia është gjithmonë prekëse. Ajo të kujton plazhet e boshatisura ose bankinën boshe të portit kur fryn shumë erë.

Mira më pyeti se si ka ndodhur që ai ka ngelur vetëm. Unë ngrita supet.

— Çudi, pse ka mbetur beqar!? A mos ka qenë ndonjë ashik ky Stavri? — më tha Mira. — Mos ka bredhur lule më lule dhe, kur u kujtua për jetën, ishte shumë vonë!

— Nuk besoi — thashë dëhe më erdhë keq të mendoja kështu për Stavrin. T'i paraqitesh dikujt përmes hallit, është mënyra më e mirë për t'i fituar zemrën. Punë sentimenti!

Unë fillova të shkoja shpesh te Stavri, për të mos e lënë vetëm, gjer ditën që më morën ushtar.

* * *

Kur mbarova ushtrinë, pothuajse e kisha harruar Stavrin. As që më vinte mendja për të. Kisha nisur një punë tjetër. Punëtor gërmimi në muze. Atë punë bëj edhe tani. Anglishtja s'më hynte më në punë. Rrallë më binte në dorë ndonjë revistë historike.

Stavrin e takova një ditë vere të nxehjtë. Unë kisha punuar deri në orën dy e gjysmë

në pastrimin e një mozaiku pranë pallatit të sportit dhe, pa vajtur fare në shtëpi, ia mbatha për në plazh. Te stacioni i autobusëve ishte ai, duke fshirë djersën e qafës me shami. Kullonte i téri.

— Djalë i keq, — më tha duke më takuar. — Djalë i keq!

Dhe më përqafroi me mall.

— Pse i keq?

— Si më harrove! U zhduke.

— Kam qenë ushtar.

— Aaaa, — ia bëri ai. — Atëherë je krejtësisht i justifikuar. E mbarove ushtrinë?

— Po.

— Atëherë hajde të pimë ndonjë gjë me këtë rast, — dhe më tërroqi drejt klubit.

— Cfarë do të marrim? Fërnet?

— Është vapë, — thashë unë. — Ndonjë arançatë.

— Mirë atëherë. Fërnet me arançatë. Është tamam si pepsikola.

Nuk ia prisha.

— Qenke dobësuar, ti sikur vjen nga fronti. Edhe më i heshtur qenke bërë. Anglishtja ç'thotë? Ke ecur ndonjë cikë? Nejse, mos çaj kokë. Si kemi thënë: *Let it be!*

Unë e prita tërë këtë ligjératë me një *nënqeshje të lehtë*.

— Tani që erdhe, besoj se do të gjesh kohë të dukesh andej nga unë. Të pres. Na-

tyrisht, pasi të kesh kënaqur veten në argëtime, sepse te një plakush si unë vetëm mërzitje mund të ketë. Do të vish?

— Do të vij, — i premtova.

Kështu u ndamë.

Stavri të pret aq mirë, saqë është e pamundur të mos shkosh për herë të dytë. Dhe ai nuk të thotë asgjë të keqe. Ai vetëm të qeras, vë muzikë për të dëgjuar, psherëtin ndonjëherë, pastaj e kapërcen këtë gjendje dhe bëhet sërish optimist. Dhe të kërkon me këmbëngulje ditën se kur do ta takosh herën tjetër, të thotë diçka për korrektesën e gjermanëve dhe për vonesën tipike të ballkanasve dhe orientalëve në përgjithësi, të pyet diçka për zanatin, për zbulimet e reja arkeologjike, të tregon se si e zbuloi Shlimani Trojën, flet për «jetën» që fle nën dhë. për luftërat antike, për èndërrime, për përpjekje njerëzore, të gjitha të kthyera në baltë.

Nga të gjitha këto diçka të mbetet në mendje.

Një herë mban mend për shembull se një filozof paska thënë se njerëzit kanë ardhur duke e humbur interesimin e të jetuarit. Dikur besonin tek ideali shkencor, artistik; mijëra njerëz sakrifikonin deri në vetëmohim për hir të tyre, por gjithçka u kthye në baltë, në baltën që gërmoj unë.

Një herë tjetër të mbetet në mendje

enigma e disqeve fluturuese. Ai të pyet nëse e ke parë filmin «Vizitorë nga Kozmosi», ku tregohet se në objektet arkeologjike janë gjetur gjurmë të pranisë së tyre dhe t'i ngre supet. Atëherë ai të flet për këtë film, të jep edhe një revistë interesante ta lexosh.

Një herë tjetër të flet për orgjité romake, për shthurjen e çdo perandorie dhe zvenitjen e çdo mendimi e ideje filozofike që përpinqen të mbrojnë me fanatizëm breza të tërë:

Një herë tjetër ai të jep të pish aq shumë konjak, saqë nuk mban mend asgjë nga ato që bisedohen. Kjo gjendje përsëritet dy-tri herë dhe të gjitha këto mbeten në turbullirë, në errësirë. Pastaj papritur shkëlqen një histori interesante për Rikard Sorgen, agjentin më të madh të Luftës së Dytë Botërore, vdekja e të cilit ka mbetur një enigmë. Dhe vazhdojnë dy ditë të turbullta me një sfond të ndezur konjaku, si sfondi i vizatimeve që paraqitin katastrofa tërmetesh apo vullkanesh.

Shkurt, te Stavri unë mësova të pi.

Në fillim kjo ndodhje si pa e vënë re, pastaj e ndjeva që nuk bëja dot pa një gotë konjak. Një gotë sa për fillim. Stavri vetë më këshillonte herë pas here, përmes avujve të alkoolit, pastaj seç pëshpëriste për domosdoshmërinë e jetërsimit, *atçuzh-*

dienije rusisht, të thoshte ai, *eiljënejshën* anglisht, *alienasio* frëngjisht... *hashash* arabisht, qeshte ai.

Unë nuk i merrja vesh fare.

Një natë që vajta i dehur në shtëpi, babai më priti me këmbë të para. Donte të më linte përjashta, po, meqë isha në pikë të hallit, më pranoi. Unë e di se ç'hoqa të nesërmen. Vendosa të mos pija më Vendosa të mos shkoja as te Stavri. Më qëlloi të ishte dhe ditë e shtunë dhe dola te treni të prisja Mirën. Tani ajo ishte bërë edhe spikere në televizion. Jepte lajmet. Dy ditë i kalova me Mirën. Edhe dy ditë të tjera i kalova pa të. Po ditën e tretë këmbët më çuan vetë te Stavri. Isha mësuar që bisedat me të t'i bëja fare pa përgjegjësi. Kur bisedon me një shok, truri ka pushim, thoshte ai. Kjo gjendje e lëhtë më kënaqte.

Stavri më priti me një buzëqeshje qortuese.

— Hajde rini, — tha ai, — mos ki frikë, se nuk të qortoj. Le që s'kam pse të të qortoj. Rinia ka jetën e vët të gëzueshme.

Atë ditë ai më pyeti për dëshirat që kisha pasur në jetë. Unë i thashë se kisha dashur të bëhesha arkitekt.

— Dhe u bëre punëtor gërmimi. Metamorfozë interesante, — qeshi ai dhe ngriti gotën, — Gëzuar!

— Nuk pi.

— Si të duash.

Pastaj më foli për jetën e tij. Më tha se ajo kishte diçka të ngjashme me jetën time.

— Kur është i ri, njeriu është plotënëdra. Në të vërtetë ato nuk janë èndrra, por iluzione, — thoshte ai. — Pastaj rritet dhe bie ndesh me jetën. Ne e përkëdhelim shumë veten, kurse jeta nuk njeh hatër. Për të jemi të gjithë njësoj. Üni tretet dhe iluzionet kthehen fare natyrshëm në deziluzione. Kjo është një gjendje psikologjike që e jetojmë të gjithë. Prandaj edhe në këtë moshë njeriu është rebel. Pastaj gjithçka fashitet dhe njeriu detyrohet të bëjë atë që i thotë jeta. Kënaqësi është kjo?

Unë nuk iu përgjigja. Më dukej sikur ai ngacmonte plagën time. Kisha dëshirë ta kundërshtoja, të bërtitja, po nuk dija se si. M'u duk vetja i turbullt, edhe pse s'kisha pirë asnjë pikë konjak.

Pashë orën që kishte vajtur tetë e një çerek dhe ndeza televizorin. Mira po jepte lajmet. Rastësisht atë kohë po fliste për demonstrata të studentëve në Spanjë dhe në Korenë e Jugut.

— Nuk është rastësi që rinia proteston kudo në botë, — vazhdoi Stavri. — Kjo ndodh ngaqë pakënaqësitë personale shpalosen në plan kombëtar, në arenën e luftës klasore.

Kjo frazë e fundit e ekuilibroi një çikë gjendjen. Megjithatë unë nuk e mora vesh se ku donte të dilte Stavri. Ai nuk e zgjati më. E la me këtë finale, që tingëlloi «zyrtarisht korrekte», sepse ishte gati e njëjtë me shprehjen e fundit që lexoi Mira.

Unë numërova me mend ditët që duheshin derisa të vinte e shtuna, kur Mira do të kthehej përsëri. Deri atëherë më duhej të takoja edhe katër herë të tjera Stavrin.

Po Stavri është shumë finok dhe katër herët e tjera nuk më tha asgjë, përkundrazi u përpoq që unë të argëtohesha sa më shumë.

— Unë e ndiej që ty diçka të mundon, — më thoshte ai. — Po mos harro se, po nuk u hapëm te njëri-tjetri, ku do të hapemi? Ngushëllimin te miqtë do ta gjej-më.

Unë fillova të besoja se vërtet diçka më mundonte.

— Kam pasur edhe unë dëshira, — i thashë. — Desha të bëhesha hero. Nuk u bëra. Nuk u bëra bile as aventurier.

— Asgjë nuk bëhet pa pasion, — tha ai. — Bile edhe për të ngrënë duhet pasion.

— Megjithatë diçka duhet të jem edhe unë, apo jo?

— Po ti je, — buzëqeshi Stavri. — Ti je njeri shumë i këndshëm. Ti ke gjënë më

të mirë. Nuk çan kokë. Të kujtohet «*Let it be*». Është filozofi e gjithë botës në kohën e sotme. Ç'të bësh tjetër?

— Të jetosh! — i thashë unë.

Ai nënqeshi. Tani mendoj se ka nënqeshur me cinizëm.

— Sa më shumë jeton, aq më tepër plagë merr njeriu, — tha ai. — Të jetosh! Hë, jeto! Jeto, rini, jeto! Kujton se ke lindur të bëhesh hero? Kujton se jeta është vetëm pér ty? Urdhëro! Jeto!

Unë heshta. Fjalët e tij më pikëlluan. Një pakënaqësi e çastit më turbulloi edhe më keq. Desha ta kundërshtoja, por vetëm thashë:

— *Let it be!*

Dhe ai vazhdoi, e unë, pa kuptuar, kisha ndryshuar. Në përgjithësi më pëlqente të heshtja.

Mira e ndjeu këtë frysë që po hynte tek unë. Ajo tashmë kishte vajtur në vitin e katërt në fakultet dhe dinte të fliste bukur.

— Sesi ke ndryshuar, — më thoshte ajo, kur unë e prisja te treni ndonjëherë i parruar.

Po, në qoftë se për gjëra të vogla mos-kokëçarja është e këndshme, për gjërat e mëdha është, veç të tjerash, edhe me zarar. Është si dredhkëza, që në fillim gjen një mbështetje të lehtë te trungu i pemës, pas-

taj e rrëthon të tën, ngjitet në çdo degë dne s'njeh kufi. Kështu dalëngadalë u futa në një botë të rrëme kuriozitetesh, ndërsa gjërat e përditshme, që më duhej të jetoj, më dukeshin tepër të rëndomta, banale.

Herë-herë, kur më merrte malli për Mirën, ndizja televizorin dhe fare tangent tek unë hynin lajmet e ditës. Ato hynin me ngarkesën e mallit për Mirën, dhe, si të ishin re, shkarkonin vetëm shiun e mallit. Kur ulesha të haja bukë, babai më vinte gjithmonë përpara gazetën e ditës e, kur unë i hidhja një sy kalimthi dhe e palosja në cep të tryezës, ai më thoshte:

— Lexoje!

— E lexova, — nxitoja të përgjigjesha dhe ngrihesha.

Por atëherë fillonin leksionet për ëndrrat e moshatarëve të mi, për punët e tyre të mira, për shpërfilljen time për problemet e kohës... Të gjitha këto vinin tek unë në formë qortimesh dhe njeriu, ashtu siç ka brenda vetes mbrojtjen nga sëmundjet, ka edhe justifikimin për t'i hedhur poshtë. Edhe Mira kishte gjuhën e babait. Asaj nuk i pëlqenin frazat e turbullta që i thosha unë ndonjëherë, nuk i pëlqente që, siç thoshte ajo, unë dalëngadalë po humbisja interesin për jetën. Ajo më kujtoi njëherë atë dëshirën e madhe që kishim pasur kur ishim fëmijë për të jetuar gjëra interesante. Unë

i thosha se koha e atyre gjërave kishte kaluar dhe ishte donkishoteske t'u besojeën-dërrimeve naivë.

Pastaj s'ishte vështirë të gjeje një shkak për t'u grindur.

Dhe përse, për shkak të Stavrit. U grinda edhe me babanë. Më qortuan në punë për konceptet që mbartja. Në mbledhje të rinisë më kritikuan për ndikime të huaja.

— Nuk është puna për të ndjekur moden, — më thanë kur unë kundërshtova. — Ndikimi i huaj është dhe kjo shpërfillje, edhe të qëndruarit mënjanë, si jashtë kohe.

Megjithatë te Stavri vazhdoja të shkoja. Është e çuditshme, po ndodh ndonjëherë që, edhe pse nuk e ke qejf një njeri e vendos të mos e takosh më kurrë, prapë ai gjetet pranë teje. Në fillim ti mban njëfarë largësie, por ai di ta zhdukë atë, aq sa nuk ke se çfarë i bën. Ai, jo se të thotë ndonjë gjë të madhe, por flet gjithnjë duke qeshur, duke mbuluar kështu të gjitha hallet që mund të ketë një beqar plak.

Një ditë e mblodha veten dhe vendosata pyesja Stavrin hollësisht për jetën e tij.

Bisedën e nisa kështu:

— Si e ke menduar jetën kur ke qenë i ri? — e pyeta.

Ai ngriu në këmbë. Më hetoi mirë e mirë. La gjithçka kishte dhe m'u ul përballë. Pamja e tij ishte tepër dramatike.

Unë nuk e kuptoja përse fjala «jetë» e trembte.

— Dikur kam qenë edhe unë i ri, — nisi ai. — Dikur.

Fjalët e tij tingëllonin si fillimi i një përralle.

— Me ç'punë je marrë tërë jetën? — i theksova qëllimisht fjalën «jetë».

— Me ç'më ka sjellë rasti, — u përgjigj.

— Kur isha i vogël, të gjithë shpresonin se do të bëhesha muzikant i madh. Atëherë kur të tjerët nuk kishin bukë të hanin, prindët e mi paguanin një njeri vetëm përtë më mësuar pianon. Ishte një austriak, një njeri i vetëm, i mbetur këtu që nga koha e Luftës së Parë Botërore.

— Po përse nuk u bëre? — pyeta unë.

— Nuk kishe talent?

— Jo. — Ai tundi kokën në një mënyrë tepër të thellë e të menduar. — Jo. Ishte ajo që të kam thënë. Giithmonë ka dëcka brutale që i shkatërron iluzionet. Ne i humbëm të gjitha. Babai ia shiti pianon një këndi të kuq punëtorësh, sepse duhej të jetonim.

— Kur ndodhi kjo?

— Ka shumë vite, — tha ai.

Unë atëherë e pashë me një sy tietër. Nië njeri i deklasuar! Si s'e kisha shkuar në mend më parë. Kio gjë më tronditi. Pa shiko! Unë qenqëm lidhur me vetë djallin.

— Po pastaj? — e pyeta duke e përbajtur veten.

— Pastaj, — ai bëri një gjest përuljeje, — pastaj... unë u treta si qiriri që t'u ndriçoj sadopak mendjet njerëzve. Shpërndava tërë dijet e mia që kisha grumbulluar prej kohësh. I mbolla andej, i mbolla këndej!

«Mbolle dështimin tënd», mërmërita unë dhe shtova me zë të lartë:

— Po si ke mundur të përshtatesh?

— Unë nuk jam budalla.

Hodha sytë rrëth e qark. Në pasqyrë pashë veten. Rrethuar me mistere. Përballë meje një njeri, që kish filluar të më ngjantë si kufomë. Rreth e qark librat e tij të zverdhur si urna ku ruhet hiri i të vdekurve.

Ika.

Kur dola në rrugë, dhjetëra mendime më vërtiteshin në kokë. Papritur, mbi gjithçka ulériu një sirenë. Ishte sirena e alarmit ajror. U fikën menjëherë të gjitha dritat. Edhe dritat shumëngjyrëshe të vaporëve u fikën. Ngado filluan të vraponin njerëz.

— Fikni dritat! — dëgjohej një zë. — Fikni dritat!

Pranë meje kaloi një makinë. Ajo kishte vënë dy fasha të zeza te projektorët e parë dhe dukej si e verbër, me një vështrim tepër-tepër të saktë mbi sendet.

Unë u ngjesha pas murit të një ndërtese. Nisa të ecja fare në cep. Kalova me radhë

të gjitha rrugët. Kur mbërrita pranë stacionit të trenit, dëgjova një zhurmë në ajër. Ishte një avion. Ngaqë ishte natë, dukeshin vetëm dritat në ngjyrë të kuqe, të gjelbër, të verdhë që kishte në trupin e tij. Vrapova. Avionin e kisha sipër kokës kur hyra në portën e muzeut. Syri më zuri statuja pa kokë dhe pa duar. Përmes zhurmës shurdhuese të avionit, m'u dukën të gjitha si viktima të një bombardimi.

Hyra në pozicionin tim. Shokët kishin zënë vend me kohë.

— Shyqyr që erdhe, — më tha një vajzë restauratore. Atë e kemi sekretare rinnie. — Unë kujtoja se s'do të vije. Me këtë natyrë që ke ti... Veçse dije, po të mos kishe ardhur, unë do të të quaja njeri jashtë radhëve.

— Mos më fol mua ashtu, — i thashë me kërcënim, po në çast u kujtova që qe vajzë. Të ishte djalë, do t'ia kisha veshur një grusht me tërë atë inat që kisha.

Ajo e vuri re që e shkeli.

— Më fal, — tha. — Do më falësh?

— Ik së të kam falur! — thashë dhe qëndrova i heshtur në pozicionin tim.

Atë çast jetova tmerrin e të qenurit jashtë radhe. Unë e ndjeva se sa e tmerrshme është të humbasësh interesin, në fillim për gjëra të vogla, të parëndësishme, pastaj për gjithçka. Dhe mendova se për pak gjë,

për fare pak gjë, do të kisha bërë atë gabimin fatal që s'do t'ia falja vetes kurrë. «Mos vallë, po të më kishte gjetur alarmi te Stavri, unë do të kisha qëndruar atje!» Atë mbrëmje, gjithmonë e më shumë, ai po më dukej si Mefistofeli dhe e gjitha kjo më turbulloi E kuptovat që kisha hyrë atje ku s'duhej të hyja: në mbretërinë e harrimit. Kisha nxjerë nga dheu disa statuja, eshtra, vazo, pitosa e pranga, bile edhe statuja të mbuluar me harrim nga koha, ndërsa veten e kisha futur në pluhur e baltë.

I harruar!

Nuk ka gjë më të tmerrshme. Atë çast unë mendova se Stavri është një armik. Armik i jetës.

Kur nxora këtë përfundim, u trondita shumë. Por ishte i vërtetë. Më ka armiqësuar me babanë, me Mirën, më ka armiqësuar me èndrrën e ciltër e të bukur të fëmijërisë, më ka armiqësuar me moshën time. Kam humbur interesin për shumë gjëra.

Kështu mendova për disa ditë rrreshth dhe më në fund vendosa t'ia përplasja njëherë në fytyrë! Pa e zgiatur, u nisa. Ndjeva se më ishte tharë goja. Ndërsa brenda vetes ndjeva një gjallëri të menjëhershme.

Shtëpia e Stavrit është në hyrje të qytetit. Ngjita shkallët.

Te dera ndala.

«Kujdes, — i thashë vetes. — Me takt!»
Trokita.

«Tak, tak! Hape, Mefistofel! Jam unë...
Fausti!» Më erdhi për të qeshur.

Derën e hapi vetë Stavri.

— Po ç'u bëre, o derëbardhë! — Stavri
më dha dorën. — Më fal pak, se më duhet
të ngre pjatën që hëngra drekë, — tha ai.

Dhe hyri pas perdes që ndante kuzhinën
me aneksin;

U kthyte pas pak. Kishte bërë gati gotat-
e konjakut dhe shishen.

— Faleminderit, — kundërshtova. —
Unë nuk do të pi.

— Au, ke vendosur, — tha me të qeshur
Stavri.

Unë kisha ulur kokën dhe po mendoja
se duhej të thosha ndonjë fjalë. Njëqind
fjalë njëherësh më dyndeshin në kokë dhe
asnjerë nuk dilte përpara.

Stavri hyri përsëri pas perdes. Çudi,
sa po lëvizte sot. Le që ai kështu bënte, për-
herë, por unë s'po e duroja dot.

«Filloi akti i parë,» mendova unë, kur
pashë Stavrin të shfaqej përsëri, i buzë-
qeshur.

— Një gotë sa për dolli do ta pish, —
tha.

Heshtja u bë edhe më e nderë. Mua më
erdhi për të bërtitur. Desha të shkarkohe-
sha një herë e mirë. Më dukej vetja si një

qiell me re tē ngarkuara. Duhej patjetér tē shkarkohej shiu, sepse, ndryshe, kockat nuk do tē gjenin dot rehat.

«Tē kam besuar, more qen! Me sinqeritetin e një fëmije tē magjepsur tē kam besuar! Po ti je dështak! Pikërisht prej kësaj e ndjen veten keq para çdo njeriu që e nis jetën me zemër tē çiltër! Vetë ke humbur dhe tē vjen keq kur tē tjerët fitojnë. Vetë je i zhveshur nga èndërrimet dhe passionet, ndaj tē tremb e tē ngre dallgë tē tmerrshme zylie çdo èndërr e pasion i tē tjerëve. Ke humbur botën tënde dhe kërkonta rifitosh duke e humbur edhe ne...»

Stavri qëndronte i heshtur përballë meje. Njësoj sikur t'i kishte dëgjuar tē gjitha. E pra, unë nuk thashë asnjë fjalë. «Më mori vesh nga sytë», u kujtova dhe e besova se fjalët mund tē shpérndahen edhe përmes heshtjes.

Stavri qëndroi në këmbë i heshtur për pak çaste, pastaj shkoi përsëri pas perdes.

«Akti i dytë», mendova unë.

Ishte e kotë ta zgjatja më këtë teatër tē pështirë.

Stavri u vonua. Kur erdhi, kishte një tjetër çehre. Asnjë gjurmë nuk kishte mbetur nga tabloja që sapo kishte përfunduar. Aktor i përsosur.

— Do tē tē them një këngë popullore,
— tha. — Shpeshherë rinia i këndon pleqë-

risë por edhe pleqëria ka nxjerrë vargje për rininë. *Si s'mendon që ke me u plakë, s'ka me t'pa njeri me sy...*

— Jo! — hova përpjetë atë çast. — Kështu si ti ne nuk kemi për t'u plakur kurrë!

Deshal të vazhdoja më tej, por ishte e kotë.

— Ti je Mefistofel! Djall je! — i bërrita në sy. — Po ne, ne dimë të jetojmë vetë rininë tonë. Ne jemi të aftë të jetojmë!

— Jaaaa-shtë! — bërtiti ai.

Ndërkohë isha ngritur. Ulërima u përplas në muret e boshatisura të dhomës, pas taj me siguri do të jetë struktur midis kapakëve shumëngjyrësh të librave në rafte.

Ndoshta është futur brenda kapakëve të «Faustit».

Unë nuk e mbaja mend nëse ai e kishte këtë libër apo jo. Por kjo ka fare pak rëndësi.

ÇËSHTJE KLIME

1

Inxhinier Betimi hyri në zyrën e kuadrit me nxitim dhe doli po me nxitim, si të kishte frikë se mos i kthehej mendja.

— Ke këtu kërkesën time për largim,
— i tha shefes, që mbeti në këmbë e çuditur.

— Për largim?! Po ne... mezi të morëm!

— Ashtu është, po... çështje klime. Lagaështira nuk i bën mirë reumatizmit. Kam një reumatizëm të vjetër që ma mori shpirtin.

Dhe doli.

Shefja e kuadrit kujtoi se si një vit më parë, në minierën ku punonte Betimi, kishin vajtur gjashtë ose shtatë herë radhazi. Drejtori i minierës nuk lejonte që t'ia merrnin Betimin. «E kemi një nga specialistët më të zotë», thoshte. «Do t'i bëjmë një karakteristikë të keqe», e mbështeste duke qeshur shefi i kuadrit. Po më në fund

e kishin marrë. U desh ndërhyrje nga lart.

Shefja e kuadrit mendoi në të njëjtën kohë se edhe ajo duhej të vizitohej te mjeku. Kishte alergji nga gjethet e vyshkura. Sa herë vinte vjeshta, fillonte të tesh-tinte, enjtej i kruheshin 'sytë, me një fjalë nuk ndihet mirë.

«Ndoshta Betimi ka të drejtë, — mendoi, — kur nuk ndihesh mirë me shëndet, s'të bëhet as për punë, as për gjë. Ja, sapo kujtova gjethet dhe më vjen të teshtij.»

Ajo teshtiu fort.

2

Edhe inxhinier Betimi, ose Timoja siç i flisnin, duke zbritur shkallët, kujtoi ditën e parë kur nisi punë në Institut. Ai i kishte ngjitur këto shkallë me një ndjesi të veçantë. I qe dukur vetja si një fëmijë në ditën e një shtatori.

«Vërtet ka qenë shtator,» dhe kujtoi shiun që kishte nisur dhe kushedi kur do të pushonte. Nëpër shkallë kishte qenë qetësi. Edhe në laborator qetësi. «Ky është Luani», e kishte paraqitur Pirroja, që punonte atje dhe që kishin qenë shokë. Bile ai qe interesar shumë për têrheqjen e tij në institut. «E kemi sekretarin e Partisë të institutit.» «Ndërsa ky është Betimi.» «Ah, gëzohem,

— i ishte përgjigjur Luani dhe i kishte shtrënguar fort dorën. — Kaq i mirë je, o derëbardhë, që nuk të linin të ikje. — Dhe kishte buzëqeshur. — Po të mos kishte qenë edhe këmbëngulja e Pirros...» «Unë e njihja mirë Betimin, prandaj», kishtë ndërhyrë Pirroja, që e kishte tërhequr Betimin përtat njojur me të tjerët.

Në fund qenë kthyer te zyra e Pirros, një dhomë e mobiluar shumë mirë dhe fare e qetë. Jashtë binte shi dhe zhurma e tij vinte në dhomë, si një shushurimë e butë. Gjithçka në harmoni me kafifën e kuqe të errët të kolltukëve. «Siç e sheh, nuk më mungon asgjë, — kishte thënë Pirroja. — Të gjitha këto janë edhe të tuat.» Pastaj me telefon kishte dashur të ftonte drejtoren për një kafe, por s'e kishte gjetur. «S'ka gjë, kishte thënë Pirroja, këtë radhë e bëjmë ndryshe.» Dhe kishin shkuar në shtëpi, ku i kishte pritur Liljana. Dikur të tre kishin qenë në një klasë. «Me limonatë mund të urohet vetëm në vitet e shkollës», kishte bërë shaka dhe ishte justifikuar në të njëjtën kohë ajo. «Gëzuar!» «Ato vite nuk harrohen», kishte shtuar Pirroja. «Veçanërisht përt. ty dhe Liljanën», nënvizoi Betimi. Por ai e kundërshtoi. «Jo. Ne ramë në dashuri **vetëm** në tre muajt e fundit.» «E mbaj mend», kishte thënë më pas Betimi, — ti ishe vajza më e mirë e grupit. Të gjithë

fsheherazi ranë në dashuri me ty, po Pirroja doli më i zoti. Na e rrëmbeu borëbardhën.» Edhe Liljana kishte buzëqeshur. «Kishte diplomën gjithë dhjeta, prandaj», kishte bërë shaka. Atëherë dukej si shaka, po ndoshta ishte edhe qortim. «Kemi qenë 25 djem, — kishte vazhduar shakanë Betimi. — Unë vë bast se ti ke marrë letra nga shumë prej tyre.» «Më pëlqen që ke mbetur student», kishte thënë Pirroja. Atë kohë Betimi kishte marrë një revistë për ta shfletuar dhe kishte kërkuar një thikë. «Do ta therësh?» kishte bërë shaka Liljana. «Jo, do pres pak fletët e revistës.» Liljana kishte ngrirë, paçka se tjetri kishte thënë fare pa dramacitet dhe pa ndonjë qëllim. Ai me qetësi kishte filluar t'i priste faqet e revistës. «Është numri i fundit», sikur qe justifikuar Pirroja dhe ai atëherë e kishte besuar. Në darkë Pirroja kishte ngulur këmbë që, derisa të merrte shtëpinë, të qëndronte aty me ta, po Betimi nuk e kishte pranuar këtë gjë kurrsesi. «Do të më mbetet qejfi, — kishte thënë Pirroja. — Ne kemi qenë si vellezër.» Por ai s'kishte pranuar. «Provincial kokëfortë», kishte thënë Pirroja. «Jam njeri i lirë», kishte sqaruar Betimi dhe duke qeshur kishte shtuar: «Nuk kam ndër mend të kthehem me orar në shtëpi.» Nuk kishte qëndruar as për darkë, ngaqë kishte lajmëthirrje me nënën. Mbante mend

se, kur kishte dalë në rrugë, binte shi. Pikat e shndritshme vallëzonin rreth e qark drithave si flutura.

3

«Duhet t'i them nënës, — tha Betimi me vete. — Ajo do të gëzohet që do të kthehem përsëri.»

Bëri disa hapa në drejtim të rrugës së postës, pastaj u kthyte përsëri. Për pak u përplas me një gjimnaziste që hante një akullore, ndoshta akulloren e fundit të vitit, sepse vjeshta rreth e qark po i çelte rrugë dimrit.

«Më mirë të mos i them asgjë. Të pres njëherë përgjigjen,» vendosi.

Ai eci i menduar përmes gjetheve që kishte rrëzuar vjeshta. Qielli kishte filluar të merrte dalëngadalë ngjyrë plumbi. Pa orën. Duhej të takohej me Meritën. E dinte që ajo ishte kundër kërkësës së tij. Merita erdhi katër minuta vonesë. Kur u shfaq në krye të lulishtes, ai kujtoi bisedën që kishin bërë tri ditë më parë. «Ti e ke me tërë mend, e shoh», kishte thënë ajo. «Po, i ishte përgjigjur ai, më mërzit vetëm një gjë», «Çfarë?» Dhe ajo kishte pritur të përmendej emri i saj. «Nuk më vjen mirë ta humbas Pirron në një mënyrë të tillë. Nuk

dua.... «Atëherë është e thjeshtë, mos ik!»
Kështu kishte thënë...

Kur ajo u afrua, Betimi u përkul, mori një grusht me gjethë të verdha dhe i hodhi në ajër. Ajo u fut atje ku binin ato dhe qeshi. Pastaj u ulën në njërin nga stolat e parkut.

— Ti me siguri planet e tua për jetën i ke bërë pa mua, — tha Betimi.

Ajo nuk e priste këtë gjë. Ngriti sytë. I kishte të menduar.

— Në qoftë se ndonjëherë kam menduar për jetën time... — nisi të fliste ajo, duke kërkuar mendimin, — po deshe ta dish... unë këtë gjë e kam bërë... pa të përjashtuar ty...

— Vërtet? — I lumtur, ai i hodhi krahun mbi supe.

Ajo pohoi me kokë.

— Ndoshta fillimisht nuk ka qenë portreti yt. Më vonë gjithçka hyri në fokus dhe dole ti.

Atij i erdhi mirë. E përqafoi.

— Në qoftë se jam kundër ikjes sate, këtë nuk e bëj vetëm për vete, — tha ajo, — por edhe për ty. Bile unë mund të përmend fjalët e tua. Mban mend si më ke thënë? Në jetë duhet pasion për të jetuar! Pasion do të thotë luftë! Mediokrët nuk luftojnë.

Ai heshti. Merita e ndjeu se e futi në mendime. Nuk deshi ta shqetësonte. Rreth e

qark binin gjethet. «Në ç'orë vallë vijnë fshesaxhinctë dhe i mbledhin?» pyeti veten kot.

4

Merita ishte njohur me të vjeshtën e kaluar. I kishte pëlqyer ai tip i singertë dhe pastaj kishte hyrë kjo kërkesë e besdissime për t'u larguar nga Tirana, e cila për Meritën ishte e pakuptimtë.

— Ke provuar ndonjëherë, — i tha një ditë, krejt papritur Betimi, ndërsa ngjitesh janë nga kodrat e Ligenit, — ti i bën vërejtje një shoku dhe ai të pyet me vështrim se ku synon të arrish pas kësaj. — Ajo atëherë u bë shumë serioze.

— Nuk të kuptoj, — i tha, — ti diçka ke.

Ai bëri një gjest me dorë të largonte diçka.

— Flas ngatërruar, e di. Sonte jam ngatërruar me Pirron. Kam bërë sherr! Kupton? E çfarë i thashë? I thashë se duhet t'i përvishet punës. Ai është shoku im. Për fat të keq, është shefi im.

Merita s'po merrte vesh se çfarë kishte ndodhur tamam.

— Po ndoshta të duhet të jesh më i matur, — tha ajo, — mos harro sa shumë u

përpoq ai të të sillnin në Tiranë. Pikërisht kjo gjë Betimin e kishte tërbuar më shumë. «Edhe ti, ti?!» i ishte hakërruar. «Të njëjtën gjë më tha edhe një tjetër. Po pse, a duhet ta ndërroj Tiranën me sinqeritetin?» Edhe pse u hakërrua kështu, edhe pse toni që shumë i egër dhe nënkuptonte gati-gati prishjen për kaq pak gjë, ajo përsëri e pëlqeu Timon në ato çaste. Në fund të fundit e tërë kjo sjellje kishte diçka burrërorë. «Më mëso edhe mua të jetoj kështu», kishte thënë ajo e ngazëlluar. «Si?!» ishte çuditur ai. «Kështu si ti, me pasion!» Ai e kishte përqafuar fort. Nata ishte e butë. Shumë e butë. Mbi ta shkëlqente vetëm hëna. Yje nuk kishte.

5

Shefja e kuadrit kërkoi drejtorin, por ai ende s'ishte kthyer nga ministria, ndaj shkoi në zyrën e Partisë.

I tregoi për kërkësen e Betirmit. Luani u çudit. Vetëm se qëndroi në këmbë i menduar.

— Deri këtu paska arritur puna? — tha.

Shefja ngriti supet. Ai mori në dorë kërkësen dhe, me sa duket, diçka vendosi me vete.

— Do ta ndjek unë këtë punë, — tha.

— Nuk éshtë thjesht çështje klime. Ndoshta ka diçka më shumë. Bile, jo ndoshta, po me siguri!

Shefja iku dhe ai mbeti vetëm. Vështrimi i mbeti mbërthyer mbi mbulesën e kuqe të tryezës. Ishte shumë e kûqe.

Ai e kishte pritur që diçka të ndodhët. E kishte vënë re që më parë. Për herë të parë ai e vuri re këtë gjë në mbledhjen e këshillit teknik në janar. Po, ishte pikërisht në janar, sepse diskutonin për të vajtur në Dajt, ku kishte rënë bora e parë. Luani kishte kërkuar të dinte se çfarë u bë me studimin e zonës D-4.

— Éshtë zvarritur kot, — kishte thënë Betimi.

— Kot? — kishte ngritur kokën Pirroja.

— Po, — kishte thënë me këmbëngulje Betimi.

— Nga kush? Ti do të thuash nga unë? — kishte pyetur jo pa qëllim Pirroja. — Unë jam udhëheqës i punës në D-4.

— Po, pikërisht nga ti, — kishte thënë përsëri Timoja, të tjerët kishin parë njëri-tjetrin në sy. Nuk e priste askush që ata të dy të shkëmbenin fjalë. — Studimi bëhet vetëm një herë dhe do kohën e vet të pjekjes, — qe hedhur Pirroja. — Unë mendoj se e keqja qëndron në metodën që éshtë zgjedhur, — tha Betimi. — Ti... — kishte

nisur të thoshte diçka Pirroja, po nuk e kishte vazhduar. Të gjithë e kishin ndier se diçka kishte mbetur pezull, po Luani e mbajti mend. Atij i pëlqeu ndërhyrja e Betimit, por e ndjeu që Pirroja nuk do ta harronte këtë shkelje në sinor të shokut. Pastaj ishte hapur përsëri biseda e dëborës dhe kjo bisedë butë e butë, ashtu si flokëzat e bardha, mbuloi gjithçka. Ditë më vonë, kur shkonin në ekskursion në Durrës një, të shtunë, në tren, ai vuri re se sa keq i erdhi Pirros kur u lavdërua shoku i tij. Po përsëri treni bënte shumë zhurmë dhe kjo zhurmë i fshehu të gjitha brenda vetes. Luanit i vinte inat që nuk ishte treguar më i vëmendshëm edhe atëherë kur Betimit i kishin hequr një ditë pune. Kush ia hoqi? Përgjegjësi, Pirroja. Ia hoqi sepse erdhi në punë me pesë minuta vonesë një të hënë.

— Erdha shumë vonë mbrëmë nga shtëpia dhe nuk më doli gjumi, — kishte thënë Betimi.

— Sidoqoftë disiplina është disiplinë, — ia kishte kthyer Pirroja. — Aq më tepër ngaqë jemi shokë dhe do të mendojnë se të mbaj me hatër.

— Shokë?! — kishte nënqeshur Betimi.

— Mund të shkosh, — s'kishte zgjatur bisedë Pirroja.

— Jo, do të punoj, — kishte ngulur

këmbë Betimi. — Hiqe ditën po deshe, aq më bën! Luani i kishte folur Pirros, por ai e kishte parë vëngër dhe i qe përgjigjur.

— Kështu shturren njerëzit. Përkëdhelja u takon fëmijëve dhe Timoja nuk është fëmijë.

6

Luani mendoi se duhej të bisedonte patjetër me Pirron. E gjeti në zyrë duke lexuar një libër.

— Ç'i thua ti kësaj? — e pyeti Luani dhe i la kërkesën e largimit mbi tryezë. Pirroja i hodhi një sy, pastaj e la mënjanë.

— Timoja gjithmonë ka pasur një reumatizëm të rëndë, — tha.

— Vërtet? Thua kjo kërkesë të jetë bërë për shkak të klimës? — pyeti Luani dhe i dha të kuptonte se ai nuk e besonte.

Pirroja heshti dhe ngriti supet.

— Përse nuk na e tha një vit më parë këtë gjë, para se të vinte? — pyeti përsëri Luani.

— Timoja është njeri i sakrificës, — belbëzoi Pirroja. Ndoshta ka menduar se do ta kapërcente...

— Përralla!

Pirroja e ndjeu veten ngushtë. Mori ka-

nën e ujit dhe shkoi të ujiste luleshqipo-njën.

— Unë mendoj se më mirë se cilido këtë gjë e di ti, — tha Luani.

— Përse duhet ta di unë?

— Sepse kam përshtypjen që këtë klimë ia ke prishur ti.

— Nuk është e vërtetë.

— Unë them ta bisedojmë shtruar.

— Me mua?

— Edhe me ty!

Pirroja heshti.

— Mua më çudit kjo kërkesë, — tha. — Më gjeti të papërgatitur fare. Unë kam nevojë të mendoj. Bisedojmë nesër.

— Si të duash. Qoftë edhe nesër. — Luani doli.

Pirroja mbeti vetëm. Ngaqë s'kishte ç'të bënte, tërhoqi fort luleshqiponjën dhe e nxori aty ku e kapte dielli.

7

«Kjo është ta kërkosh belanë vetë», — mendonte Pirroja gjatë atyre ditëve. Studentë kishin qenë shokë të mirë. Ai, Lljana dhe Timoja. Kur mbaruan shkollën, Pirron e emëruan në institut e Timon në minierën e qytezës ku banonte.

Sapo mori vesh se në laborator kërkohet

një njeri i zoti, ai propozoi Betimin. «Ju them me siguri se është pikërisht ai që nă duhet.» Timoja e kishte pritur me kënaqësi këtë ftesë. «Kam vetëm një hall, kishte thënë, do të më duhet të lë nënën vetëm për ca kohë.» Muajt e parë qenë plot dashuri shokësh. Po s'vonoi dhe ndodhi grindja e parë. Pirroja i kishte thënë të bënte në emrin e tij një artikull për revistën «Shkenca dhe jeta». Timoja nuk kishte pranuar. Pirroja kishte mbajtur qëndrim, madje i kishte thënë: «Ka njerëz që kuptojnë se të mirat që u bën, ua ke borxh.» Timos i kishte ardhur shumë keq, por s'e kishte bërë vëten. Veçse qe tërhequr. Nuk i shkonte më mbrëmjeve në shtëpi për të parë televizor. Me Betimin takohej paraditeve në punë. Pirroja e ndiente se kishte filluar të kishte një mendim tjetër për shokun. Këtë ia shprehу dhe së shoqes. «I është hapur oreksi, Jepi tjetrit gishtin, të të marrë dorën», kishte thënë. Liljana qe çuditur. «Nuk mund ta besoj, — kishte thënë. — Ndoshta nuk e ka pasur me qëllim të keq.» Po Pirroja kishte kündërshtuar: «Unë nuk diskutoj qëllimin. Atij nuk i takon të sillet kaq krenar.» Po Liljana përsëri e kishte mbrojtur: «Më ha mendja se ai gjykon më dashuri prej shoku.» Atëherë Pirroja qe inatosur. «Kjo fjala shok po shpërdorohet pak si tepër në kohën e sotme, — kishte thënë. — Unë

nuk i jap të drejtë asnje shoku që të më gjykojë sipas qejfit. Le të bëjë njëherë ai aq sa kam bërë unë në jetë», dhe i kishte përmendur grindjen për vonesën e mëngjesit, dhe më në fund, kur Betimi kishte parashtruar në këshillin shkencor të institutit kërkesën që të punonte edhe ai për zonën D-4, Pirroja s'qe përbajtur. «E tregoi më në fund së kërkon të më vëré në pozitë të keqe», i tha tërë mllef së shqes në drekë. Liljanë kishte heshtur.

8

Pirroja hyri në klub për të marrë një paketë. Moza po hante një pastë.

— Fillove duhanin, shef? — pyeti ajo.

— Ç'tu, bësh punëve! — tha Pirroja, dhe s'donte ta zgjaste më.

— Por ajo vazhdoi:

— A është e vërtetë që Betimi ka këruar të ikë përsëri në minierë?

Pyetja e saj e befasoi.

— Nuk e di, — tha. — Po ti nga i merr vesh këto gjëra?

— Kot nuk më thonë AT e institutit, — qeshi ajo.

Pirros i rëndoi pyetja e saj. Tha dicka kot nëpër dhëmbë dhë doli. Kishte dhëmbje koke.

Pirroja nuk e ndiente veten mirë.
 «Çështje klime», mendoi. «Bukur e pas-
 ka kurdisur.»

Rreth e qark vjeshta rrëzonte gjethe.
 Por ai nuk e kishte mendjen. Eci ngadalë
 rrugës për në shtëpi.

Në shtëpi gjeti Liljanën. Ajo po heku-
 roste.

U värtit nëpër dhomë. Mori luleshqipo-
 njën dhe e nxori atje ku nuk e kapte dielli.
 Pastaj hapi dritaren dhe nxori atje fikusin.
 E shoqja po e ndiqte me vështrim.

— Timoja bëri kërkesë me shkrim për
 t'u larguar, — tha ai. — Çështje klime.

— Klime?! — pyeti ajo.

— Tirana nuk u bën mirë të gjithëve,
 — tha Pirroja si pa i dhënë rëndësi.

— Cudi, me sa dëshirë erdhi në Tiranë.

— E di. Kështu ndodh. Kaq e kishte. Ta-
 ni i ranë bateritë dhe e sheh se nuk bën
 dot. Më mirë si puna ime, përditë e nga
 një çikë, sesa një herë e me ciklon.

— Mos ia kë prishur ti klimën Timos?
 Ai është djalë i singertë dhe i ndershëm.

— Po unë? C'jam unë? — u nxeh
 Pirroja. — Maskara jam?

— S'e thashë atë.

Ai i shkoi ballë për ballë. Ishte nervoz
 dhe sytë i kishte të skuqur.

— Po, — iu përgjigj Pirroja, — ai është karrierist. Ti s'ke pse i del në krah!

— Unë i dal në krah, sepse e kemi njohur.

— Ashtu kujtoja edhe unë. Por ai ka ndryshuar.

— Dëgjo, Pirro, edhe ti, bile ti ke ndryshuar, — tha Liljana duke hequr hekurin nga priza.

— Si the? — bërtiti Pirroja. — Unë kam ndryshuar?

— Po. — Ishte një «po» e prerë dhe e thatë.

— Fol, — bërtiti ai, — fol! Shprehu! Dua të të dëgjoj!

Liljana nuk u tulat nga zemërimi i tij, por i shkoi përballë.

— Edhe unë kam dëshirë të flas, — tha. — Kam disa ditë që e mendoj zënken tuaj. Dikur kam njohur shumë shokë.

— E di. Njëzet e ca letra dashurie! — e ndërpren ai.

— Dhe unë besova vetëm njëren prej tyre, — nuk e dha veten ajo. — Atë ma shkruante Pirroja. Pirroja ishte një shoku im i kursit, djalë i rregullt, i edukuar, studionte sistematikisht dhe dallohej në mësime. Dukej qartë se ai ishte «njeri i idealeve të larta», siç quhet. Kurrsesi nuk mund të mendohej që ai do të bëhej një njeri mediokër.

— Vazhdo më tej, — i tha gjithë mllaf Pirroja. — Siç e sheh, unë jam shumë i dùruar, dhe paskam dëshirë të të dëgjoj.

— Ky ishte Pirroja me të cilin unë u martova.

— Mos ke bërë gabim? Asnjëherë nuk është vonë për të gjykuar gabimet e rinisë së hershme, — tha ai. ,

— Kaluan vite, — vazhdoi Liljana sikur të mos i kishte dëgjuar fare fjalët e tij. — Dhe ky Pirroja i justifikoi të gjitha gabimet naive të një studenteje. Ai filloi punë në institut, u bë studiues i zoti. Pastaj u kënaq dhe...

— Mjaft, — e humbi durimin Pirroja.

— Dhe erdhë një ditë një njeri tjetër, — vazhdoi Liljana.

— Favoriti yt, — e ndërpreeu ai.

— Një shoku ynë i përbashkët. Një djalë i ndershëm, i dashruar pas punës. Ai nuk bëri gjë. Vetëm punoi mirë dhe me këtë zbuloi dobësitë e punës së shokut.

— Ti na qenke bërë hetuese.

— Unë njoh të vërtetën, atë që nuk ke guximin ta shohësh drejt e në sy.

— Hetueset femra nuk vlejnë. Gjykojnë me simpatira.

— Po të ishte kështu, do të mbaja anën tënde.

— Sipas teje, unë qenksam i paaftë. Femrat dashurojnë vetëm të aftët. Marrëzisht.

Kështu? Edhe mua më deshe sa isha i aftë, tani...

— Pirro, si s'ke turp?!

— Do të kishe bërë më mirë të mos e kishe hapur gojën, — tha dhe doli duke pérplasur derën me forcë. Në rrugë ndezi një cigare.

Pastaj u mbështet pas kangjellave të oborrit të një shtëpie dhe qëndroi pér pak caste. Frynte erë.

10

Para një javë ata ishin takuar në sallën e «Arbërisë». Ftesën e kishte bërë Betimi. Kishin qëndruar të ulur pér njëfarë kohe, pa thënë asnjë fjalë. Orkestra luante melodi të vjetra. «Tangoja e argjendtë». «Përse më thirre?» e kishte prishur heshtjen Pirroja. «Dësha të të pyes se mos ke ndonjë ankesë ndaj meje», kishte thënë Betimi. Pirroja kishte heshtur: «Të pyes me tërë mend», kishte ngulur këmbë Timoja. «Kam pasur një herë një ankesë se ke ardhur vonë në punë», kishte thënë me ironi Pirroja. Betimi s'e kishte kuptuar dhe i që përgjigjur thjesht: «Për këtë ke pasur të drëjtë. Potjetër?» «Asgjë», kishte thënë Pirroja. Potjetri nuk është kishte besuar. «Mos më gënjë», kishte thënë. «Edhe unë kështu dua

që të jetë, por kam përshtypjen se fsheh diçka të ligë. Ti seç ke një ftohtësi ndaj mëje kohët e fundit. Më thuaj, të kam bërë gjë? Të kam rënë më qafë?» Pirroja e kishte lënë të mbaronte tërë atë tiradë. «Para disa ditësh ti kërkove të më merrje nga dora D-4, — kishte thënë dhe kishte vazhduar: — Kjo nuk është rastësi. Ti përpinqesh të krijosh te të tjerët përshtypjen se je shumë i aftë, pa u shqetësuar se po shkel mbi shokun.» Betimi kishte kërcyer përpjetë. «Pra qenka e vërtetë kjo që dyshoj unë?!» «Para se të vije ti, unë isha tjetërkush», kishte ndërhyrë atëherë Pirroja. «Ti nuk e di se si e kam ngritur nga hiçi atë institut, ti nuk e di sa ja përpjekur që punët të shkojnë mirë e të vish e t'i gjesh gati ti.» Po Betimi kishte kundërshtuar: «Natyrisht ti këtë gjë nuk e ke bërë pikërisht pér mua.» «Nuk ka rëndësi pérse e bëra. Rëndësi ka fakti që unë isha njeri i nderuar. Dhe punët shkoni pér mrekulli!» kishte thënë Pirroja. «Unë do të thosha se mrekullia nuk është kjo», kishte kundërshtuar përsëri Timoja. «Është fare lehtë të kundërshtosh, — kishte thënë Pirroja. — Ti mund t'i përbysësh të gjitha, po nuk e mohon dot punën time pér institutin. Bile edhe pér ty!» Atëherë Betimi kishte drejtuar gishtin në gjoksin e vetes: «Pér mua?» «Po, — kishte thënë prerë Pirroja. — Po të mos qe këmbëngulja

ime, ti do tē ishe akoma atje ku ke qenë.» Kjo e kishte tērbuar Betimin. «Nuk kam qenë keq», kishte thënë. «Pastaj, po tē mos dija tē ecja vetë, me këmbët e mia, s'do tē mund t'i bëja dot téré ata kilometra nga miniera në institut. Mendoj se këmbënguljen tēnde po e justifikoj me punë e jo me servilizëm.» Dhe pastaj qe bërë një çast heshtje dhe qenë kujtar tē pinin nga një gllénjkë birrë. Nuk e kishin trokitur gotën dhe as nuk kishin thënë gëzuar. «Ti ke ndryshuar shumë, — kishte thënë Pirroja. — Unë, në qoftë se ngula këmbë, e bëra këtë pér Timon e viteve studenteske. Pér djalin kokulur dhe tē druajtur, që skuqe sa herë flitej pér tē.» Betimi kishte ngritur zérin: «E në c'drejtim paskam ndryshuar?» Dhe kishte pritur. «Nuk thonë kot se provinca tē ngjall ndjenja karrieriste», kishte thënë Pirroja. Atéherë Betimi kishte kërcyer përpjetë. Nuk e kishte pritur. «Unë karrierist?! Ç'flet kështu? Je në vete?!» Po Pirroja kishte vazhduar: «Ka disa lloje karrierizmi. Yti éshtë më i rrezikshmi.» Ti nuk di çfarë flet», kishte thënë Betimi. «Më lër tē vazhdoj», kishte thënë Pirroja. «A nuk ishe ti që sapo erdhe, hodhe parullën se Pirroja duhet tē punojë më tepér? Në emër tē shokut, natyrisht. A nuk ishe ti që more përsipër tē bëje punët e prapambetura pér tē nxjerrë nga balta institutin?

A nuk ishe ti ai që do të më marrësh D-4, sepse unë të skuq faqen para shokëve të tu të minierës? A nuk ishe ti që dole si shpëtimtar i situatave, specialist i rrallë? Hë, ç'thua?» Pirroja me zor kishte marrë frysme midis frazave. «Unë këto i kam bërë përpunën», kishte thënë Betimi. «Edhe përveten», ia kishte prerë Pirroja me zë të ulët. «Bile më tepër përveten.» Betimit i kishte ardhur rëndë për Pirron. «Duhet të të vijë turp që shkon ndër mend gjëra të tillat!» «Unë vetëm po u vë diciturën veprimeve të tua», kishte këmbëngulur Pirroja. Të të vijë turp ty që i bën të gjitha këto!» Timoja kishte ngrirë në vend. «Vërtet mendon se unë jam karrierist?» kishte pyetur pak më vonë. Pirroja vetëm kishte tundur kokën dhe kishte ngritur supet si përtë thënë se s'mund të mendonte ndryshe. Betimit i kishte rënduar kjo gjë. «E ke gabim, — kishte thënë. — Po nejse, Ti më gjykoni për njeri të keq. Unë di të të them se karaste që, kur gjykojmë një njeri, shpalosim veten. Sot përtty po mësoj shumë gjëra. Dhe më vjen keq përtë gjitha këto.» Pirroja kishte vazhduar më tej: «Unë e di që ti ke mësuar të mbrohesh mjaft mirë. Ndoshta praktika teatrale që po bën...» Por Betimi e kishte ndërprerë rreptë: «Përse jam karrierist? Ngaqë fle ti?» Po Pirroja e kishte çuar bisedën më tej: «Dëshiron çë-

lësat e laboratorit? Jam gati të t'i jap», kishte ironizuar. Edhe Betimi nuk ia kishte lënë mangët. «Ti më mirë jep shpirtin, — i kishte thënë. — Sa për çelësat, rri i qetë. Turp!», kishte folur pas pak me neveri Betimi. «Sot vërtet po më neveritesh. Si ka mundësi të bjerë njeriu kaq poshtë?» Dhe ishte ngritur në këmbë. Kishte nxjerrë paratë nga xhepi për të paguar birrat dhe i kishte lënë mbi tryezë. Pastaj, pas dy hapave, ishte kthyer sérish. «Dëgjo, — kishte thënë — që të mos kujtosh se ma ke bërë ti nderin dhe mos të të ngelet pishman se ia bëre varrin vetes me duart e tua, unë po iki nga instituti. Do të shkoj në minierë. Merre vesh se çfarë karrieristi jam.»

Kishte dalë nga sella.

Jashtë kishte rënë mbrëmja.

11

Merita iku dhe Betimi mbeti vetëm.

Vjeshta rrëth e qark praronte. Dielli ishte në të perënduar dhe u bë fresk.

«Ndoshta Merita ka të drejtë», mendoi Betimi, ndërsa solli ndër mend bisedën me të. «Përse duhet të largohesh?» kishte thënë ajo. «Kjo që bën ti, quhet tërheqje. Tërheqje dhe dezertim.»

Ai bëri disa hapa në lulishte dhe doli në rrugë. Rruga ishte plot me njerëz. Studentët

ecnin grupe-grupe, me libra në duar. Te Monumenti i Skënderbeut kishte si zakonisht njerëz. Ndjeu se e bezdiste fërshëllima e bilbilit të politit. «Sikur nuk e dinë që duhet të ecin në vija të bardha» mendoi Betimi dhe nuk zbriti nga trotuari. Hyri në një ëmbëltore. Porositi fërnet.

— Dopio! — tha.

Pastaj erdhi përsëri vërdallë, duke menduar se ndoshta mirë ishte të ikte një orë e më parë. Merita i kishte thënë se Piroja kishte bërë sherr edhe me Liljanën. «Për shkakun tim?» kishte pyetur ai. «Jo, — kishte kundërshtuar Merita, — për shkakun e tyre. Ndoshta edhe ata kanë gjëra të ndërtuara gabim midis tyre dhe prisin një shkak.»

Ai hyri në Bibliotekën Kombëtare, por u pendua dhe doli sérish. Po binte mbrëmja. Shëtitorja ishte e qetë. Kishte vetëm njerëz dhe vetëm ndonjë autobus urban. Eci kot.

«Ata ishin mirë —, mendoi, — erdha unë dhe u prisha qetësinë.»

Dhe e ndjeu veten fajtor. Po në çast ndryshoi mendim.

«Po unë nuk kam faj, — tha. — Nuk kam faj. Paçka se për të jam karrierist dhe njeri i lig.»

Ndihej vërtet në hall të madh tek mendonte se si papritur mund të biesh në rre-

thanat e një njeriu të lig, fare kot, pa pasur asgjë të ligë në vete.

Pastaj shkoi në dhomën e vet. Ndezi disa cigare radhazi. U çudit pas dy orësh, kur pa taketuken të mbushur me aq shumë bishta. Gojën e kishte të hidhur. Mori taketuken dhe e shkundi. Pastaj qëndroi për pak çaste para pasqyrës. Nuk shihte veten. Nuk shihte asgjë. Po mendohej. Penduli i sahatit i qëndronte varur mbi kokë. U ul në divan dhe mori një libër. E hapi. Nuk përqëndrohej dot.

U ngrit dhe hapi dritaren. Bënte freskët. Era fëshférinte përmes gjetheve.

«Po unë ç'bëra kështu?! — i tha vetes. Përse vendosa të iki?»

I erdhi turp që kishte dorëzuar kërkesën për t'u larguar.

«Nuk duhej ta kisha bërë. Përse duhet të iki unë? Unë kam forcë, kam energji, kam dëshirë për të punuar. Le të më quajnë mendjemadh, — kishte thënë, — ka edhe një modesti të rreme, që u takon dembelëve.»

Vendimi për të qëndruar, e bëri më energjik. U ngrit dhe veshi xhaketën. Doli në rrugë. Ndjeu nevojë të bisedonte edhe një herë me Pirron. Kësaj radhe nuk do të bisedonte si i barabartë. Do t'i kërkonte llogari. «Përse mëndon keq për mua? Kush ta jep ty këtë të drejtë?»

Ngjiti shkallët e apartamentit të tij, I ra ziles.

Portën e hapi Liljana.

— Mirëmbrëma!

— Mirëmbrëma, — tha ajo me zë të shuar dhe ai kujtoi atë që kishte thënë Merita.

— Nuk është?

— Jo, — bëri ajo me kokë.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!

Zbriti shkallët i menduar. «Ku mund të ketë vajtur?» Pati përshtypjen se do të ishte duke punuar. «Në fund të fundit, edhe ai është njeri me sedër.»

I hipi autobusit urban dhe shkoi në Institut.

— Aty është, — tha roja.

Ngjiti shkallët. Hapi ngadalë derën. Pirroja e ndjeu.

— Erdha të të them se nuk do të iki, — tha Betimi. — Do të qëndroj.

— Ashtu?! — tha Pirroja. Nuk donte t'i hapte rrugë. — Po klima?

— Ti s'je Hefesti, që mund të dërgosh rrufetë kur të duash, — ia ktheu Betimi. — Sa për klimën, unë them, ta largojmë këtë klimë të keqe. Në qoftë se nuk je dakord, aq më keq për ty.

— Aq më keq? — tha tjetri jo pa ironi.

— Po. Sepse unë nuk tërhiqem, çfarëdo

epiteti të më vësh. Je ti ai që duhet të têr-hiqesh dhe jo unë.

Pirroja uli kokën. Betimi e ndjeu se edhe tek ai ishte ringjallur diçka e mirë.

Doli pa e përplasur derën. Zbriti shkallët. Poshtë ngriti edhe një herë kokën dhe pa driten e ndezur të laboratorit. Pastaj vazhdoi rrugën.

Ishte vjeshtë. Së shpejti do të fillonte shiu.

Shkrythi kockat dhe vazhdoi rrugën.

FILMI QË NUK U SHFAQ NË FESTIVAL

Ishte dita e katërt e festivalit! Dhe ishte filmi i tretë! Për atë ditë!

Ti, Brigitë, do të thuash se unë nuk e njoh mirë frëngjishten dhe i kam vënë kot këto pikëçuditëse në fund të fjalive. Ke të drejtë. Po të nisesh nga rregullat gramatikore, ato nuk duhesin vënë, po, po të mendosh se çfarë ndjesie kisha unë ato çaste, këto pikëçuditëse janë në vend të pshërëtimave, të lodhjes e të mërzisë, ndaj janë tepër të domosdoshme. Në jetë na ndodh shpesh që, më shumë sesa rregullat gramatikore, të mirësjelljes e të kortezisë, të respektojmë pikërisht disa rregulla që na dikton ndjenja, apo jo?

Isha vërtet tmerrësishët i lodhur atë ditë. Po më mbylleshin sytë. Në ekran vallëzonin një çift afrikanësh, por unë nuk i dalloja qartë. Shihja vetëm një lëvizje ngjyrash, drithërimet e dritëhijet dhe dëgjoja një ritëm daulleje që më ngulej në kokë. Nuk mund të qëndroja më brenda. Do të ishte më keq sikur të më zinte gjumi



ulur në karrige. Një ditë më parë unë qësha me një regjisior indian që, kur iu këput koka, brofi në këmbë i trembur. Por ato caste ia kuptova lodhjen dhe më erdhi keq për të.

«Pushim!» thashë.

Për të qenë më i qetë me detyrën, sajova përveten edhe justifikimin. Filmi që do të shfaqej më pas, po të niseshe nga titulli, premtonte të ishte edhe më i lodhshëm. Quhej Narcisi dhe Psikeja. «Filozofi, ngatërrresë, elipse, konvencione, ngjyra, dinamikë, një përzierje pak nga të gjitha. Nuk e di!» Kështu do të thoshe ti më vonë përtë.

Dola nga salla duke fërkuar sytë.

«Ndoshta këtë lodhje e kam ngaqë është mesditë», mendova dhe pashë orën. Donte edhe një orë e gjysmë të fillonte filmi tjetër, tamam atëherë e kuptova se kjo gjendje nuk ishte thjesht një lodhje çasti. Kisha parë shumë filma radhazi, isha ngopur e ngopur, aq sa nuk thithja dot më.

Hipa në autobus. Qëndrova në këmbë në fund të tij, me vështrim të papërqendruar nga rruga. Ndihesha i ngazëlyer, si atëherë kur sheh të zbulohet, pasi largohet dalëngadalë mjegulla, një peizazh mahnitës. Si pa e kuptuar, duke filluar nga një ditë më parë të gjithë filmat kishin nisur të më duke-shin bajtë. Tani më vjen keq që ka ndo-

dhur kështu, sepse midis tyre ka pasur edhe filma shumë të mirë, që më kanë kaluar pa i shijuar. Nuk më bënte më përshtypje as harmonia e xhirimeve me kashé, për të cilën diskutuan gjatë një mbrëmje në hollin e Grand Hotelit, ngjyrat e trajtuar dramaturgjikisht më dukeshin artificiale, si tualeti i nuseve të hënën në mëngjes, loja e aktorëve më dukej si një stërmundim. Më shumë se çdo gjë, kisha nisur të vëreja dhe të gjeja trukun.

Zbrita nga autobusi dhe u ndala buzë liqenit. Unë nuk e dija që edhe ti ishe diku aty pranë, midis shelgjeve që kishin mbirë në dheun e paktë, midis gurëve të mëdhenj, që vareshin drejt mbi ujërat e kaltra që drithëronin valë. Lashë rrobat mbi një gur dhe u zhysta në ujin e ëmbël. Pikërisht atë ditë m'u kujtua se, edhe kur isha zhytur për herë të parë në Ligenin e Pogradecit, uji më që dukur i pështirë, pa shijen e kripës, me të cilën jemi mësuar ne bregdetasit.

«Po ndoshta, mendova, kjo vjen ngaqë sot s'më hyn gjë në sy!»

Hyrje e gjatë, apo jo?

Po, në qoftë se unë nuk do të shpjegoj ndjesinë që pata atë ditë, më duket se do t'u lë dicka mangët ditëve tonë të mëvonshme. Ajo rëndon mbi takimet, bisedat, mbi të gjitha castet, ashtu si rëndon qielli mbi ujërat e liqenit dhe u jep ngjyrën. Ndoshta,

po të mos ishte kjo ndjesi, unë edhe ty do të të kisha parë ndryshe, kur ktheva sytë nga bregu dhe të vura re ulur pranë rrobave të mia, me sandalet hequr dhe këmbët të futura në ujë. Se, po ta mendosh me qetësi, a ka gjë më romantike dhe sedërpërkedhëllëse për një djalë, sesa të shohë një vajzë, nën një shelg lotues, që pret ulur pranë rrobave të tij? Ja, pra, edhe kjo nuk më bëri përshtypje. Duke çarë me not për të ardhur te ti, e gjithë kjo, pritja jote, shelgjet që varesin mbi supe, qelli krejt i kalltër, ylberet që formonin stërkalat e bardha të ujit të atij ligeni alpin, motoskafët që ecnin me shpejtësi, njerëzit rrëth e qark, më dukeshin një skenë e zakonshme filmi, e parë qindra herë.

«Mirë që të gjeta ty, — më the kur dola në breg. — Sot ka qenë një ditë shumë e mërzitshme!»

Unë u ula pranë teje dhe ti nise të më flisje për veten tënde.

Quheshe Brigitë Dantes, 26 vjeçë (një vit më e vogël se unë). Gazetare. Mund ta quaj veten me fat, më the. Në festival kishe ardhur edhe me shërbim, edhe për pushime. Kishe takuar shumë njérëz, po prej tyre mërziteshe shpejt. «Vërtet mërzitem», ngulje këmbë ti. Unë të dëgjoja i heshtur. Doja të të shihja se çfarë ngjyre i kishe sytë, po xhamat e errët të syzeve nuk më linin.

Sytë unë t'i kam parë vetëm një herë. Një mbrëmje, në një konferencë shtypi, kur ti hoqet syzet dhe, e lodhur, fërkove sytë me gishta. I kishe ngjyrëgështenjë.

Ti vazhdove të më flisje për veten.

Vazhdimisht kishe qenë në lëvizje. Në fillim, kjo gjë të kishte kënaqur. Më pas? Më pas të qe bërë një «modus vivendi». Jetojë vetëm me nënën. Dikur ajo kishte qenë komuniste. Marsel Kashenin e kish pasur mik. Po Zhorzh Marsheja nuk i pëlqente, ndaj qe larguar nga politika.

«Marsheja është vërtet i padurueshëm!»
të thashë unë.

«E njeh?» më pyete ti.

«Socializmi i Marshesë i ka të gjitha ngjyrat; përveç së kuqes», citova unë Enver Hoxhën, dhe ty të pëlqeu ky mendim. Embajtë shënim në atë blokun e vogël, ku dy ditë më parë unë të kisha shkruar emrin tim «të rigatërruar».

«Do t'ia tregoj mamašë këtë shprehje.
O lala, sa do kënaqet!»

Mbylle blokun.

«Po ti, — më pyete, — çfarë bindje politike ke?»

«Marksist-leninist», t'u përgjigja dhe më erdhi për të qeshur, se nuk e kisha menduar kurrë që do të deklamoja ndonjëherë bindjen time kështu majë guri, në një vend kaq të largët, me një njeri kaq të largët.

«Unë kam qenë trockiste, — më the ti.
— Ohu, njëherë e një kohë. Katër muaj më parë u mërzita dhe tani nuk di se çfarë të zgjedh....»

Mua më erdhi për të qeshur, po nga ana tjetër u bëra serioz. M'u duke një pjesë e pandashme e mërzisë sime të asaj dite.

Po ty të thashë fjalë të tjera. E mban mend?

«Kam përshtypjen, — të thashë, — se ti merresh me politikë sa për modë. Ose për aventurë...»

«Ke të drejtë, — më ndërpreve ti, — zakonisht argëtimet ne i bëjmë sipas një grupimi. Duhet të bësh pjesë diku, po nuk deshe të vuash nga vëtmia...»

Dhe buzëqeshe. Ti mendove se the diçka interesante, qëndrove si e ngrirë, me supet ngritur dhe duart hapur, duke pritur çfarë do të thosha unë. Por unë heshta dhe ndjeva brenda vetes se si ndjesia që po jetoja një grumbull trukesh kinematografike, u jepte gjesteve të tua trajtat e një spektakli.

«Po edhe kështu mund të jetë, — mendova, — ka njerëz që e ndërtojnë jetën si një spektakël. Qëndrojnë përballë saj dhe soditin veten sikur të jenë të huaj. Kështu kënaqen.»

Unë vura re se ty të mërziti heshtja

ime dhe u ngrite më këmbë. U vesha dhe të ndoqa pas.

Mendimi se edhe unë po bëhesha pjesë e një spektakli, nisi të më shqetësonë.

«Mos po më bëhet obsesion?» mendova, ndërsa u ula në restorant për të ngrënë drekë. «Ç'është kështu? Unë nuk kam as moshën dhe as tipin!»

Por, ndërsa përpinqesha ta largoja këtë mendim, pa shiko se ç'mund të ndodhë! Ti me siguri e ke njohur atë italianen llafazane, Ana Maria Rosin, sepse ajo u përpoq t'i takonte të gjithë pjesëmarrësit e festivalit. Hynte në biseda pa druajtje, ligjéronte pa pushim, duke shifur mend se ishte mikeshë e Bertoluçit, apo të mbushte mendjen se edukata e filmit duhej të futej në shkolla dhe kjo do të përbënte bazën e një reforme të vërtetë arsimore e të tjera. Me siguri edhe ti do të jesh mërzitur nga ajo ndonjë ditë, siç u mërzitëm unë dhe shoku im, duke dëgjuar një orë e njëzet minuta ligjératën e saj pa fund. Ishte pikërisht kjo Ana Maria që erdhi vërdallë, duke u matur të ulej a të mos ulej në tryezë me mua. Me sa dukej, nuk më gjeti të denjë dhe unë shpëtova. Ajo u drejtua te tryesa përballë, ku qe një holandez me një mjekër të yndyrshme, të thinjur e sytë të shpëlarë e të pangjyrë. Për çudinë time, holandezi jo vetëm që nuk u mërzit, por me shumë dëshirë tërroqi ka-

rrigen dhe e ftoi të ulej me një gjest prej kavalieri. Ana Maria, me t'u ulur, nisi avazin e vet. Unë kisha përballë holandezin, që tundte kokën duke miratuar herë pas here «si, si». Kështu vazhdoi tërë drekën. Kur mbaruam së ngrëni, unë dhe holandezi u gjendëm njëherësh në holl.

«Jam kureshtar të di se për çfarë bisedonit me aq pasion me Ana Marien», e pyeta unë.

Ai bëri një gjest me dorë, nënqeshi, sytë e shpëlarë i zbardhëlljen dhe tha: «Unë nuk di asnjë fjalë italisht!»

Dhe qeshi i kënaqur me veten.

Ende më tingëllon në vesh e qeshura e tij. Ajo jehoi në humbëtirën e shkretë të hollit të hotel «Belvederes» duke nisur nga notat e ulëta, drejt notave të larta, si një ushtrim shkalle në orën e muzikës. Unë ende nuk e marr vesh se përsë njerëzit duhet të bëjnë sikur merren vesh me njëri-tjetrin, sikur komunikojnë, ndërsa e ndiejnë veten të huaj e të largët.

Natyrisht unë nuk dua të banalizoj këtë gjë, duke besuar përgjigjen tënde.

E mban mend?

Ishte një mbrëmje e ngrohtë vere, me qiellin plot me yje.

«Sot është «Nata e yjeve që bien», — më the ti duke ngritur kokën nga qielli. — Bien yjet!»

Unë nuk pashë atë natë asnë yll që binte, po sytë m'u përzhiten nga pamja e pishtarëve të ndezur në të katër anët, rrëth e qark kështjellës së vjetër, ku bashkia e qytetit organizonte një darkë për ne. Dridhjet e flakëve të pishtarëve e bënин të lëkundshme pamjen e mureve të vjetra të kështjellës, mbuluar me një rrjetë të dendur lulledredhkëzash, me gjethet në formën e zemrës; dhe hijet e njerëzve i dhjetëfishonte duke u ndryshuar proporcionet.

Ti qëndrove gjatë përpara një pikture të vendosur në mur, aq gjatë, sa i re në sy të zotit të kështjellës. Ai t'u afrua me shpejtësi. Përpara teje qëndroi duke marrë qëndrim gatit prej kavalieri me takat e çizimeve të bashkuara. Të kujtohet? Kishte veshur një kostum gjuetie prej meshini.

«Më pëlqen shumë kjo pikturë», the ti.

«E kam bërë vetë», u krenua ai dhe tundi lehtë kokën në shenjë falënderimi.

«E mrekullueshme, — the ti përsëri. — Ka një zgjidhje origjinale, harmonia e ngjyrave të krijon qetesi.»

Ai të përqafoi fort, i kënaqur, me lëvizje të prera si të një shqytari.

«Dy shishe verë më shumë se të tjerët», shtoi duke buzëqeshur.

Pastaj iku duke trokitur çizmet dhe ne mbetëm vetëm. U bëra kureshtar të shihja

pikturën. Ishte një grumbull vijash e objektesh, një mish-mash me ngjyra tepër të spikatura, që mua nuk m'u duk se kishin ndonjë vlerë. Ç'të kishte pëlqyer vallë atje? Për këtë të pyeta ty. Ti, me të njëjtin sinqueritet që kishe thënë se të pëlqente, vure buzën në gaz, më shtyve lehtë miqësisht në sup dhe the:

«Budalla, unë nuk jam aq e pasur, sa të ha të gjitha darkat e të pi çdo shishe verë me paratë e mia!»

Rreth e qark dritat e pishtarëve e bënin të lëkundshme pamjen e mureve të vjetra të kështjellës e të lulledredhkëzave me gjethë në formën e zemrës, njësoj sikur i shihje në fund të një pellgu. Edhe ti m'u duke pjesë e pandashme e asaj nate, duke bërë hije të stërmëdha në mure, hije të ndryshueshme, ku herë dukej koka e madhe, herë pjesa e shpatullave dhe herë stërgjatesh gjymtyrët.

Unë nuk piva asnjë pikë nga vera që të dha i zoti i kështjellës më shumë se të tjerët. Por, ndërsa shihja kamerierët, të veshur edhe ata me kostume gjuetie, që të trajtonin si perëndeshën e pyjeve, mendova gjatë për ty. Natyrisht, ti e ndjeve këtë. Veçanërisht femrat kanë një shqisë të gjashtë për të ndier çdo gjë që mendohet e flitet për to.

«Pse u bëre i heshtur», më pyete.

«Kot, — u përgjigja unë. — Po pres të shoh ndonjë yll që bie.»

«Me siguri do të bien, — më the ti. — Atëherë ti duhet të shprehësh me zë të lartë ndonjë dëshirë dhe ajo do të të plotësohet patjetër.»

Por unë nuk qëndrova me ty atë mbrëmje. Midis fytyrave të ngazëllyera të festivalistëve kërkova ndonjë fytyrë tjetër të mërzitur. E gjeta. Ishte Alonsoja, ai kiliani me mustaqe të holla, të zeza, që kishte ardhur në festival me kursimet e katër vjetëve të fundit.»

Toka një gotë bashkë me të.

«Jam kureshtar të di se çfarë dëshirash do të kenë këta njerëz», më tha ai.

«Ndoshta s'kanë asnë dëshirë», ia ktheva unë.

«Mund të kesh të drejtë. Dëshira e tyre është të jetojnë çastin. Ja, gjëzojnë, ngazëllehen, bëjnë zhurmë, presin me ankth, pastaj do të ikin dhe gjithçka do ta harrojnë fare lehtë. Do të mbeten vetëm tryezat me gotat e boshatisura e pjatat e palara. Njerëzit do të flenë dhe nesër do të nisin një ditë të re, sikur kjo e sotmja të mos qe fare.»

Të njëjtën gjë mendoja dhe unë. E dëgjoja i heshtur. Drita e hënës binte mbi valë, e bardhë, si pluhur i argjendtë.

«Të pëlqen ky qytet?» — më pyeti ai.

«I bukur është. Po ti pse je i mërzitur?»

«A nuk të duket se ndodhemi në mes të një mashtimi të madh? — tha ai dhe nga sforcimi mblođhi buzët, e dhëmbët e rregullt i zbardhën si gjysmëhëna në mugëtirën e fytyrës së tij. — Në fillim këta njerëz mashtrojnë veten dhe, pasi e besojnë këtë, nisin të na mashtrojnë edhe ne. Prandaj hajde të pimë. Të harrojmë!»

Ai ktheu gotën e verës me fund.

«Mos pi më», i thashë unë.

«Është e freskët, — më kundërshtoi ai — E gëzuar!»

Befas u bë errësirë. Unë nuk e kisha vënë re se ishin fikur pishtarët një nga një. Errësira i platiti edhe zhurmat.

«Tani do të presim yjet, — më sqaroi Alonsoja. — Ndoshta ato do të bien në mëngjes.»

Unë ngrita kokën lart dhe pashë mizërinë e yjeve. Xixëllima e tyre e largët më kujtoi një nga vjershat e mia të kohës së gjimnazit, kur i krahasoja me petale lule-delesh që i kishin hedhur shkujdesur të dashuruarit tek pyesnin «më do, s'më do».

U dëgjua një gjëmim dhe papritur qelli u mbush me yje që binin. Ishin fishekzjarrë. Një brohorimë shpërtheu rrëth e qark. Nën ndriçimin shumëngjyrësh të tyre njerëzit

ū gjallëruan, filluan tē thërritnin, tē qeshnin,
tē thoshin dëshira me zë tē lartë:

«Dua çmimin e parë në festival...»

«... tē mos ketë luftë bërthamore...»

«... një shtëpi, në Majami biç...»

«një fëmijë. Një djalë...»

«... udhëtim në Hënë...»

Unë dhe Alonsoja qëndruam tē heshtur.
Pikërisht atëherë erdhe ti. E zhurmshme.

«Ty po tē kérkoja, — më the, — ia
shprehe yjeve dëshirën tënde?»

«Jo!» Ngrita supet dhe më erdhi për tē
qeshur me merakun tënd për këtë.

Ti më shkunde nga supet.

«Thuaj ndonjë dëshirë, — këmbëngule.
— Ky nuk është çast i gënjeshtërt? Thuaj!»

Yjet prej fishekzjarrësh po binin dalë-
ngadalë, duke u shuar njëri pas tjetrit.

«Nuk ke asnë dëshirë? Asnjë?!»

U bë errësirë. Unë heshta. Edhe ti hesh-
te. E ndjeva që u trishtove. Nuk di në
psherëtive ti apo u dëgjua dallgëzimi i
lisenit në breg.

«A nuk tē thashë që ka mashtrim? —
u ngrit në këmbë Alonsoja. — Edhe yjet
s'qenë yje, po fishekzjarrë.»

Dhe iku nëpër errësirë.

Unë nuk e di përse ishte i mërzitur atë
natë Alonsoja. Ndoshta nga ndonjë zhgë-
njim. E ke vënë re? Ndonjëherë ta prish
humorin një vështrim, edhe një re e vogël

që të rëndon dhembjen e reumatizmit. Po ndoshta mërzia e tij kishte të bënte me diçka më të madhe. Ai kishte vite larg at-dheut, në kërkim të punës si kineast. Ngaqë askush nuk e financonte, ai punonte herë në një restorant, herë në një hotel dhe së fundi në një lavanteri. Ndonëse kishte ikur prej grushtit të shtetit, Alonsoja nuk ia falte vetes ikjen. «Në fillim ishte shpresa, — më ka thënë ai një ditë, — pastaj ishte malli, dhe më fund një psherëtimë e gjatë e pafund.» Mundet prej kësaj ai bëri edhe skandalin në ballon e galerisë «Borxhi.»

Të kujtohet?

Ne ishim ulur në një cep dhe bisedonim për filmin shqiptar që do të shfaqej të nesërmën.

«Çfarë teme ka?» më pyete ti.

«Për dashurinë!»

«Për dashurinë?! Akoma ekzistoka dashuria diku?! — bëre sikur u çudite ti dhe shtove: — Për mendimin tim, dashuria është një nocion tepër i vjetruar, që i takon fillimit të shekullit...»

Pikërisht në këtë kohë Alonsoja bërtiti fort:

«Qetësi!»

Orkestra pushoi. Alonsoja ngriti gish-tin tregues përpjetë. Nga mënyra si qëndronte, e kuptova që kishte pirë.

«Qetësi», bërtiti ai përsëri. Po të gjitha zhurmat qenë platin. «Ai mjekroshi, — nisi të fliste duke shoqëruar fjalët me gjeste, — ka ikur nga atdheu. Pra... është arratisur... Ka lënë atdheun e tij... E për kë? Për këtë!»

Ai tregoi me të dyja duart, me një gjest nënvleftësimi, damën me të cilën po kërcente deri atëherë. Të kujtohet? Ishte ajo biondja milionere që financonte filmat e atij regjisoret rumun që ishte arratisur në Perëndim dhe intervistat i fillonte me fjalët: «Unë, ashtu si Sollzhenicini...»

Mjekroshi u ngrit të zihej me grushte me Alonso, po ndërhynë njerëzit dhe i ndanë.

«— S'ke turp, — bërtiste Alonso, ndërsa e kishin mbërthyer e po e nxirrin jashtë nga salla. — Merr nëpër këmbë nderin e atdheut dhe të dhimbset nderi i një gruaje...»

Pas pak nga salla iku edhe Sollzhenicini i kampingut me të shoqen. Orkestra nisi të luante një melodi ritmike, për të krijuar përshtypjen se asgjë nuk kishte ngjarë. M'u duk si një spërkatje me deodorant.

Përballë nesh, një nga polakët që mbante stemën e «Solidarnostit» me fushë të bardhë me shkronja të kuqe, imitim i gjakut, kishte ulur kokën dhe diçka gërvishjtë me thonj mbi tryezë, pa e pasur mendjen te

salla. Ai kishte flokë të bardhë, si lule-lakër.

Mua ato çaste m'u kujtua se si qante një emigrant kui zbriti nga avioni një ditë në Rinas. U ul në gjunjë e s'ngrihej dot. Puthte barin e dheun e shkelur.

Ty nuk të bëri përshtypje asgjë. Më ftove të kërcenim dhe, kur unë të thashë se nuk më pëlqente të kërceja rrok, ti, atëherë, më ftove të dilnim në verandë.

«Po ti, — më pyete kur dolëm në ajër të pastër, — a ke ndonjë të dashur?»

Mua më erdhi për të qeshur me pyetjen tënde të drejtpërdrejtë.

«Ka gjëra që s'të pëlqeijnë t'i thuash me zë të lartë, — formulova unë një frazë, duke iu përshtatur tonalitetit me të cilin më bëre pyetjen. — Të duket sikur ato i shpreh vetëm mërmërima brenda gjoksit. Një nga këto është dashuria!»

Ty të pëlqeu kjo frazë. U bëre e heshtur dhe nise të mërmëritje një këngë. Një re, me trajtat e hartës së Anglisë, e zuri hënë dalëngadalë. Vinte aroma e luleve të përzhitura gjatë ditës nga dielli i gushtit.

«Kam njobur shumë njerëz, — më the pas pak me një zë gati-gati të shuar. — Të gjithë kanë qenë më të mëdhenj se unë. Ndonëse intelektualisht me ta kam komunikuar fare mirë, përsëri diçka ka munguar. Nuk e di se ç'kam, por unë kam zbuluar

se në ditët e mia më mungon diçka. Nuk e di se çfarë, ndoshta mosha...»

Dhe heshte. Me qetësi ule kokën mbi gjunjë dhe qëndrove pa folur dhe pa lëvizur. Unë prita gjatë që ti të ngrije kokën. Prita të thoshe ndonjë fjalë, po ti, sikur të të kishte zënë gjumi, nuk lëvize. Reja e zbuloi përsëri hënën dhe nisi të largohej duke marrë formën e një shamie. Mbi ty ra drita e bardhë. Ato çaste veranda u ndriçua, si një skenë butaforike, dhe hëna qëndronte varur si një projektor që e kishin ndezur gabimisht.

U ngrita në këmbë. Ti përsëri nuk lëvize.

«Natën e mirë», të thashë.

Ti ngrite kokën.

«Po ikën?»

«Nesër do të ngrihem herët. Na duhet të shohim gjashtë filma të tjerë.»

«Natën e mirë!»

Nuk e di se ç'mendove ti atë natë, por unë qëndrova gjatë në dritaren e dhomës sime në hotel, duke soditur xixëllimin e drivate të qytetit dhe reflektimin e tyre në liqen. Ndeza tri cigare njérën pas tjetrës dhe ashtu, mes heshtjes rrathëve të kalter të tymit, shkundjes së hirit dhe shijes së nikotinës së verdhë, më erdhi keq përvetminë tënde.

Që nga ajo mbrëmje ne të dy pothuajse

vetëm heshtëm. Flisnim pak dhe për gjëra fare të parëndësishme. Takimet me ty ishin si shkretëtira të shurdhra në mes të marramendjes e berihasë rrëth e qark, sikur futeshe në një studio incizimi.

Kur i kujtoj tani në këto ditë shiu ato kohë që kalova në festival, më vijnë ndër mend dy pamje. Nga njëra anë fishek-zjarrë, zhurmë, lëvizje gati në sfokaturë e tramvajit, konferencë e shtypit me pyetje e përgjigje që të kujtonin raundet e boksit, lloj-lloj peizazhesh të hedhura në celuloid me ngjyra pikante, vizita në galeri e në vende piktoreske me turmën laramane të artistëve, diskutime, gumëzhitje, përcartje, sfida, lavdërim, shkëmbime adresash dhe midis të gjitha këtyreve, heshtja jote, si heshtja e zhurmës së rrotave të trenit në-për stacione.

Ti e mban mend se si i ramë një natë mes për mes qytetit krejt të heshtur. Binte shi. Si ky shiu i sotëm, i shtruar e i qetë. Ne mund të kishim qëndruar në ndonjë strehë, por ti, e shtyrë nga një nervozizëm i brendshëm, dole e para në rrugë e unë të ndoqa pas. Të kisha dhënë fjalën se do të të shoqëroja në hotelin tënd, që ndodhej në periferi. Flokët m'u bënë qull e nisën të më rridhnin rrëke, këmisha m'u ngjit pas trupit, pantallonat më kullonin mbi këpucë. Po ti vazhdoje të ecje, dhe unë të ndoqa

pas pa thënë asnë fjalë, përveç «natën e mirë» kur u ndamë.

Unë e kuptoja trishtimin tënd. Ai kishte diçka nga trishtimi i njeriut që ndodhet i vetëm në një tryezë të shtruar për dy veta.

Ose, mundet, ti mendoje se heshtja të jepte një vel misteri. Në të vërtetë ajo të bënte me teatrale dhe groteske. Ti nuk besoje te dashuria, kështu më pate thënë, ndaj edhe unë nuk mund ta besoja se ky trishtim i gjatë, si shi vjeshte, kishte të bënte me dashurinë. Ndoshta ishte thjesht një tekë, një trill romantik në prozën e mërzitshme të ditëve të tua të vetmuara.

Unë kështu e quajta edhe ardhjen tënde pas meje.

Nuk e merr dot me mend sa u befasova kur sportelisti i hotelit «Helios», diku në një skutë të largët të Romës, më tha se më kishte kërkuar një zonjushë e huaj. Të them të drejtën, nuk më shkoi mendja se do të ishe ti.

«Priti sa priti, pastaj u mërzit dhe iku. Më la këtë pusullë», më tha sportelisti.

Unë lexova në pusullë emrin tënd dhe mora vesh se mël prisje para kishës së Santa Minervës. «Atje ndodhet një elefant i bardhë», më shkruaje ti.

Pashë orën. Kishte kaluar një orë plot. Unë përfytyrova mërzitjen tënde, vërtitjen

rreth e qark elefantit, sytë që lëviznin pa pushim, pastaj sikur dëgjova sharjen tënde nëpër dhëmbë dhe ikjen tënde krenare, përmes drurëve. Por unë nuk kisha asnje faj. Letra më ra në dorë me vonesë. Ti më pate thënë se do të niseshe për në Paris, ndaj gjatë tërë ditës kisha qenë duke sdotur kapelën sikstine, pikturat e skulpturat e muzeut të Vatikanit.

Të nesërmen në mëngjes, pak përpara, se të nisesh për në aeroport, ti më more në telefon.

«Të prita dje», më the.

«Pusullën e mora shumë vonë, — u justifikova unë, — isha tërë ditën te muzeu i Vatikanit.»

«Po tani?»

«Po nisem për në Shqipëri!»

«Nuk mund të qëndrosh edhe pak?»

«Avionët kanë orare fikse. Fiumicinoja është larg.»

Pastaj u bë një heshtje. Heshtje shumë e gjatë. Kur kaluan disa çaste, unë të thërrita në emër.

«Po», m'u përgjigje ti.

«Lamtumirë», të thashë.

«Lamtumirë», më the.

Dhe mbylle telefonin në anën tjetër. Prita për pak kohë, pastaj e lëshova receptorin edhe unë.

Rrugës për në aeroport përsëri mendova

për ty. Edhe ti gjithashtu ke menduar përmua, sepse menjëherë kishe blerë një kartolinë dhe e kishe nisur urgjent në adresën time në Shqipëri.

Kur avioni u ngrit nga pista dhe i erdhi vërdallë Romës, kur Koloseu e Shën Pjetri filluan të bëheshin gjithmonë e më të vegjël, unë e ndjeva se si gjithçka u tret në pafundësinë e hapësirës.

U trete edhe ti.

Filloi të më pushtonte një mall për qytetin tim dhe njerëzit e mi.

Një vlagë e ngrohtë më bëri të ndieja sikur kisha vite larg Atdheut. Pastaj përnjë çast m'u duk sikur kisha qenë në Durrës një ditë më parë.

Po, po.

Unë vërtet kisha qenë në Durrës një ditë më parë. U kujtova se kisha parë ëndërr sikur kisha dalë buzë detit me shokët e mi. Laheshim në det dhe thosha: «Kështu po, me kribë ka lezet!» Dhe lëpija buzët.

Kur solla ndër mend ëndrrën, vura re dicëka që më bëri të ndihesha i vërtetë dhe i gjallëruar. Të gjitha ëndrrat që kisha parë atje larg, në tokën e huaj, kishin ndodhur në Shqipëri. Në një rrugë të Tiranës, në Durrës, në dhomën time të punës, në një rrugë të Korçës... Kisha takuar shokë të fëmijërisë apo thjesht kalimtarë, dhjetëra njerëz të afërm e të dashur.

Ajo që shihja diten, tërë peizazhet e shumta e piktoreske, njohjet e panumërtë, bisedat në gjuhë të ndryshme, kureshtjet që të bënин përshtypje në çast, edhe ti, netve mbeteshit diku të harruara.

Tani të gjithë atë atmosferë e kujtoj si një histori që mbaroi sa po u ndezën dritat dhe ekrani mbeti i bardhë, si pjesë e një filmi që nuk më takon mua.

Ishte një film që nuk u shfaq në festival.